



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË
E TË MOSHUARVE TIRANË**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE
NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË”**

DHJETOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-45
	1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit	3-3
	2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-40
	3. Konkluzioni i Përgjithshëm i Auditimit	40-45
II.	HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit)	45-46
	Titulli & Marrësi	46-46
	Objektivat dhe qëllimi.	46-46
	Identifikimi i çështjes.	46-47
	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	47-47
	Përgjegjësitë e audituesve	47-48
	Kriteret e vlerësimit	48-50
	Standardet e auditimit.	50-52
	Metodat e auditimit	52-52
	Dokumentimi i rezultateve të auditimit.	52-52
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	52-144
	1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	52-52
	2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	53-53
	2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit:	53-68
	2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	68-77
	2.3 Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	77-98
	2.4 Auditimi i llogarive vjetore	98-108
	2.5 Prokurimet e fondeve publike	108-129
	2.6 Të ndryshme të dalta gjatë auditimit	129-139
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	139-158
V	ANEKSE	159-163



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, më poshtë e emërtuar “SHMT”, për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, me objekt “Auditimin përputhshmërie”.

Auditimi kishte në fokus gjashtë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 438/1, datë 02.06.2023, i ndryshuar, dhe në të u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, zbatimin e kontratave, mbajtjen e evidencës kontabël dhe menaxhimin e aktiveve.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikrat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

1.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 51 pika 1, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 23, pika 3; nenit 46, pika 2 të këtij ligji për shpenzime personale, që ju jepen përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar. Neni 51 pika 3 ka ngarkuar Ministrin përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë	Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër	E Larte	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masat e duhura për plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin më të mirë të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke hartuar dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>Udhëzim të Përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, në zbatim të 46, pika 3, të këtij ligji, për tarifën e shërbimeve publike të financuara nga buxheti i shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23.</p> <p>Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 23 pika 4 ka përcaktuar se personat që përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike kundrejt pagesës së një tarife të cilat sipas nenit 46 pika 3 kërkon nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministrit të Financave.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në shkëlqje të afateve ligjore të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë plotësisht pagesat e tarifave e shërbimit dhe përfitimin e shpenzimeve personale për personat rezidentë në shtëpitë e të moshuarve, në mospërputhje me nenin 23 pika 3 dhe neni 23 pika 4 dhe neni 46 pika 3 germa “a” të këtij ligji.</p> <p>Në mungesë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 dhe nenit 46 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, institucioni/et kanë zbatuar aktet nënligjore në fuqi duke llogaritur, ndaluar dhe derdhur çdo muaj në thesar të ardhurat e mbledhura nga të moshuarit rezident 40% të pensionit mujor sipas dispozitave të VKM nr. 840, datë 3.12.2014 “Për përcaktimin e masës së</p>		<p>propozuar akte ligjore e nënligjore për zbatimin të nenit 23.3 dhe nenit 23.4 dhe nenit 46 pika 2 dhe të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.</p>
---	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p><i>kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, e cila për disa të moshuar ka rezultuar edhe me pak se minimumi i shpenzime personale 6,000 lekë në muaj që disa prej tyre përfitojnë sipas kritereve të VKM 518/2018.</i></p>			
2	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 23, të Ligjit nr. 121/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe pikës 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” ka nxjerrë Udhëzimin nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, i cili në pikën 1 ka përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë në ditë për person, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve. Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, si akt nënligjor për metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe nivelin e tyre, nuk është bërë me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministrit të Financave, në kundërshtim më</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Larte	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të nivelit të kuotës ushqimore referuar Udhëzimit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe miratimin e Manualit mbi propozimet e grupit të punës lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>kërkesat e nenit 26 pika 2 të Ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.</p>			<p><i>publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, për miratimin e normative ushqimore dhe ushqyerjes së grup moshës së tretë sipas kërkesave të nenit 23.4, neni 46.2 dhe neni 51.3 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</i></p>
3	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka nxjerrë akte nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 pika 6, neni 46 pika 3 germa “a”, dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në mungesë të nxjerrjes së akteve nënligjore institucionet kanë zbatuar standardet e miratuara me VKM nr.821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<i>shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”.</i>			
4	<p>Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për të moshuarit është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, në mospërputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, paragrafi 71. Grupi i auditimit llogariti efektet e mosindeksimit të kostos së ushqyerjes se moshuarve dhe në bazë të përllogaritjeve rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë efektet e mosindeksimit të kostos së ushqyerjes se moshuarve për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 106,005 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 137,812 lekë dhe për vitin 2022 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 560,356 lekë. Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 69,897 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 1,476,222 lekë, për vitin 2022 rezultoi kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 1,941,773 lekë.</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër)</p>	E Lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të parashikimit të fondeve buxhetore edhe si efekt i indeksimit vjetor të kuotave të shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve në përputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, duke siguruar jetese të qete dhe me dinjitet në të përditshmen e tyre.</p>
5	<p>Nga auditimit rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në tre raste për të moshuarit e vendosur në institucionin rezidenciale publike, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit</p>	E Lartë	<p>Shërbimi Social Shtetëror të marrë masat e nevojshme duke ofruar sistem të unifikuar rregullash për t’u zbatuar në aplikimin e tarifave</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p><i>rezulton më pak se kuota 6,000 lekë/muaj, që ata do të përfitonin sipas kritereve të VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Kreu V, paragrafi 68, germa “a” në rast se të moshuarit nuk do të gëzonin pension pleqërie. Ndërsa në katër raste pjesa e mbetur e pensionit mujor rezultoi në kufijtë e kuotës 6,000 lekë në muaj ose pothuajse e barabartë me të njëjtën shumë që ata do të përfitonin në rast se nuk do të gëzonin pension pleqërie.</i></p> <p><i>Nga auditimi rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, në 16 raste për të moshuarit e vendosur në këtë institucion rezidenciale publik, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor rezulton më pak se 6,000 lekë/muaj që përfitojnë 16 të moshuar të tjerë si kuotë për shpenzimet personale, sipas kritereve të VKM nr. 518, datë 04.09.2018, duke cenuar parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, përcaktuar në nenin 4 germa e të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>Nga auditimi rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, për të moshuarit e vendosur në këtë qendër rezidenciale në katër raste institucioni ka llogaritur, mbajtur dhe derdhur në buxhet tarifën 40% mbi pensionin social që ata kanë përfituar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi ata nuk zotërojnë asnjë lloj pensioni</i></p>	<p><i>Përfundimtar të Auditimit Shkodër)</i></p>	<p><i>që paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror në qendrat e shërbimit rezidencial për të moshuar, deri në miratimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesave të nenit 51.1 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.</i></p>
---	---	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, nuk kanë të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që sigurohen nga pensioni social. Ndalese dhe derdhja në buxhet e tarifës 40 % të shumës mujore e pensionit social, bie ndesh me pikën 2 të VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, pasi kjo dispozitë nuk parashikon ndalese dhe derdhje në buxhet të të ardhurave të përfituara nga pensioni social që të moshuarit përfitojnë për të përballuar nivelin minimal të jetesës. sipas nenit 5/1 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”.</p>			
6	<p>Në dërgimin e plan buxhetit të vitit 2020, vitit 2021 dhe vitit 2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror në miratimin e PBA 2020 -2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 e projektit <i>nuk kanë vlerësuar kostot e investimeve për shpenzime kapitale</i>, duke ndikuar në cilësinë e jetesës së të moshuarve të njëjësive shpenzuesen në këtë institucionet rezidenciale:</p> <p>- <i>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë</i> për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total në shumën 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1,728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m² me kosto 10,000 leke/m² llogaritur me kosto investimi 3,020 mijë lekë; blerje “frigoriferë” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë leke,</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 63-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 53-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	E Lartë	<p>Shërbimin Social Shtetëror në bashkëpunim me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, para dërgimit të projekt buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesave për zërin “Investime” në llogarinë 231, në përmbushje të Standardit 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”, me qëllim rritjen e cilësisë së cilësinë së jetesës së të moshuarve në këto institucione rezidenciale.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”.</p> <p>-Shtëpia e të Moshuarve Shkodër për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara, kërkuar në total 1,080 mijë lekë, për blerje sobe gatimi industriale me gaz 1 copë, lavatriçe industriale me tharëse 1 copë, tharëse industriale 1 copë dhe televizorë 10 copë, në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”.</p>			
7	<p>Nga auditimi rezultoi se institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e transferimit të institucioneve rezidenciale për të moshuar në njësitë e qeverisjes vendore brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 121/2016. Për pasojë Shtëpia të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër vazhdojnë të funksionojë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 52, pika 1 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	E Lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin dhe përgjegjësinë e organit publik të ngarkuar me ligj për hartimin e dokumenteve dhe politikave të reformimit e modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe si institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të marrë masat e nevojshme që të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale tu transferohet</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

				njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve.
8	<p>Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në dosjet e punonjësve mungonte “Përshkrimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, veprim në kundërshtim me Kontratën e Punës Individuale sipas të cilës punëmarrës ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6) dhe Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).</p> <p>Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër rezultoi se në dosjet e punonjësve mungon “Përshkrimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, në kundërshtim me Kontratën e Punës Individuale sipas të cilës punëmarrësit ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6), dhe Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër nr. 1568, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).</p> <p>Në dosjet e personelit mungon “Libreza Shëndetësore”, e rinovuar, e punonjësve të institucionit për vitin 2023, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, neni 17, germa “ç”, sipas të cilit kërkohet mbikëqyrje shëndetësore e personave që shërbejnë në institucione të përkujdesjes sociale, duke paraqitur në institucion “Librezë shëndetësore” e cila duhet të</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	E Lartë	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	depozitohet në institucion dhe duhet të rinovohet pas përfundimit të afatit (1 vit) të përcaktuar në këtë dokument shëndetësor. Me përjashtim të rezultateve të vitit 2022, në dosjen e personelit mungon vlerësimi individual i rezultateve në punë, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër nr. 1565, datë 07.07.2016, neni 17.			
9	Dosjet e personelit të institucionit, në <i>Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër</i> nuk përmbanin trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit për pozicionin e punës punonjës social, psikolog, pasi për faktorë jashtë institucionit nuk është realizuar procesi i certifikimit sipas dispozitave të nenit 42 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” me pasojë në procesin e rekrutimit, i cili ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror.	<i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i>	E Lartë	Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, i cilin përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
10	Lidhur me procedurën e prokurimit “ <i>Blerje mish dhe nënproduktet të tij për vitin 2022</i> ” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se referuar kontratës nr. 147 prot., datë 29.09.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, si dhe bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para	<i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 113-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i>	E Lartë	Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi produktet e mishit dhe nënprodukteve të tij duhet të shpërmdaheshin afërsisht për 12 herë (3 muaj*4 javë), por në fakt shpërndarja është kryer për të gjithë sasinë 3 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në muaj dhe jo një herë në javë.</p> <p>Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 <i>“Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”</i>, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: <i>“...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore”</i>. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit, përpara marrjes në dorëzim të tij, të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqërues të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si certifikatë veterinare dhe raport analize, në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim mallra pa u siguruar nëse ato janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinare, standardet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, raport analizat, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjetin me të cilën produktet</p>			<p>në zyrën e protokollit.</p> <p>Komisioni i marrjes në dorëzim pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër në çdo rast përpara marrjes në dorëzim të mallit të verifikojë plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura në ftesën për ofertë duke e pasqyruar në një procesverbal të posaçëm dhe furnizimi të bëhet në çdo rast në përputhje me grafikun e lëvrimin.</p>
---	--	--	--



<p>shpërndahen, certifikatën për të verifikuar cilësinë e I-rë të mallit, si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprime në kundërshtim me kërkesat specifike të ftesës për ofertë, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>”. Gjithashtu, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 të kontratës nr. 147 prot., datë 29.09.2022 “<i>Blerje mish dhe nënproduktet të tij</i>”.</p> <p>-Lidhur me procedurën e prokurimit “<i>Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij</i>” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatua se me anë të kërkesës datë 20.09.2022, grupi i punës i është drejtuar sektorit të financës me qëllim vijimin e procedurave të prokurimit për blerjen e bulmetit sipas sasive të specifikuara në kërkesë nga ku është konstatuar <i>mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt</i>.</p> <p>Referuar kontratës nr. 250 prot., datë 03.10.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, pikës 1, neni 10, si dhe bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, <i>konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi produktet e bulmetit dhe nënprodukteve të tij duhet të shpërndaheshin afërsisht për 30 herë (90 ditë/3), por në fakt shpërndarja është kryer për të</i></p>			
--	--	--	--



<p>gjithë sasinë 3 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në 30 ditë dhe jo një herë në 3 ditë. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: “...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqërues të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: certifikatë cilësie, certifikatë analize fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe raport analize, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar mbi të dhëna mbi certifikatat e cilësisë, certifikatë analize fiziko-kimike, mikrobiologjike, standardet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30,</p>			
---	--	--	--



<p>datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 të kontratës nr. 250 prot., datë 03.10.2022 “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij”.</p> <p>-Lidhur me procedurën e prokurimit “Blerje ushqime koloniale” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatua mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt. Produktet e prokuruar janë marrë në dorëzim të gjitha njëkohësisht më datë 04.10.2022 nga grupi i marrjes në dorëzim. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim, si dhe verifikimin që i është kryer mallit përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: “...të furnizuara sipas standardeve dhe cilësisë së kërkuar”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqërues të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: raport analize fiziko-kimike, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, sipas së cilës “Raport analiza fiziko-kimike duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar”, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar të dhëna mbi certifikatat e cilësisë, certifikatë</p>			
--	--	--	--



<p>analize fiziko-kimike, standartet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>-Lidhur me procedurën e prokurimit “Blerje gruri për vitin 2022” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatuase me anë të kërkesës grupi i punës i është drejtuar sektorit të financës me qëllim vijimin e procedurave të prokurimit për blerjen e mishit dhe nënproduktet e tij sipas sasive të specifikuara në kërkesë nga ku është konstatuar mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt. Furnizimi mallit konstatohet se është kryer në një ditë të vetme, përkatësisht data 21.02.2022. Procedura e 2-të është kryer në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “M.C.” sh.p.k, me ofertë 630,000 lekë (pa Tvsh) dhe 756,000 lekë (me TVSH), i cili ka lidhur kontratën nr. 77 prot., datë 25.02.2022 me afat deri në datën 31.12.2022. Referuar kontratës nr. 77 prot., datë 25.02.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, pikës 1, neni 10 “Autoriteti kontraktor duhet të njoftojë furnizuesin 1 ditë para datës së furnizimit të mallit duke paraqitur një listë për artikujt që kërkon”, si dhe bazuar në procesverbalin e</p>			
---	--	--	--



<p>marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi buka duhet të shpërndahej afërsisht për 308 herë (308 ditë), por në fakt shpërndarja është kryer për të gjithë sasinë 10 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në 30 ditë dhe jo çdo ditë.</p> <p>Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 <i>“Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”</i>, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: <i>“...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore”</i>. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqërues të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: fletë analizë dhe certifikatë cilësie, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, malli pranohet pa u konstatuar mbi të dhëna mbi cilësinë, standardet e ambalazhimit, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e</p>			
---	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>prodhimit, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të Ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 kontrata nr. 77 prot., datë 25.02.2022. “Blerje bukë gruri”. Nga auditimi në të gjitha praktikatat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në të dyja institucionet është konstatuar se në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas ftesës për ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit, në kundërshtim me pikën 17, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.</p>			
11	<p>Lidhur me procedurën e prokurimit “Shërbim Ashensori” viti 2020-2022, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, u konstatua se Shtëpia e të moshuarve Tiranë ka në pronësi të saj një ashensor i cili shërben për ngjitjen në godinë nga të moshuarit dhe stafi. Lidhur me këtë ashensor për tre vitet 2020-2022 është kryer procedura e prokurimit me objekt “Shërbim Ashensori”, i cili ka patur për qëllim shërbim mirëmbajtje ashensori, vajtje dhe kontroll periodik, shërbim dhe riparim kur ka defekt. Operatori i shpallur fitues “G.” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e shërbimit me nr. 23 prot., datë 24.01.2020 përfaqësuar nga</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	E Lartë	<p>Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, të mos shpall OE fitues pa u siguruar se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK, si dhe përfaqësuesit e operatorit</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>administratori i shoqërisë z. G.H, i cili në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka patur tagër administratori, pasi referuar informacionit të përcjellë nga gjendja e regjistrimit të shoqërisë “G.” sh.p.k. afati i emërimit i ka përfunduar në datën 03.07.2019. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata nr. 32 prot., datë 25.01.2022, në të cilën operatori është përfaqësuar nga z. G.H, i cili sërish ka vepruar në kundërshtim me tagrin ligjor, pasi administrator i shoqërisë në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë z. E.H. Në të tre procedurat konstatohet se si kriter kualifikues është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, i cili figuron i njëjtë për të tre procedurat nuk konstatohet i depozituar vërtetimi i OSHEE për procedurën e vitit 2020 dhe 2021, në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimi nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</p>			<p>ekonomik të veprojnë në përputhje me tagrin ligjor.</p>
12	<p>Nga auditimi në të gjitha praktikatat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në të dyja institucionet është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në procedurën e prokurimit të blerjeve së medikamenteve në të dyja institucionet nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentare për llogaritjen e sasisë së medikamenteve, sipas së cilës mjeku, harton planin për plotësimin e nevojave mjekësorë për përfituesit, veprim në kundërshtim me pikën 6, detyrave të mjekut, rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016,	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>		<p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, të marrin masa për:</p> <ul style="list-style-type: none">- Hartimin e një plani të posaçëm vjetor me qëllim plotësimin e nevojave mjekësorë për përfituesit dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor.- Komisionet e marrjes në dorëzim në çdo rast të mbajnë procesverbal në momentin e



<p><i>Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë:</i></p> <p>Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, me kërkesën e datës 06.01.2022 drejtuar drejtorit të Institucionit, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 12.01.2022, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 520,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 27 prot., datë 21.01.2022, me afat deri në përmbushjen e vlerës së kontratës. Për vitin 2022, për blerjen e mallit është kryer procedura në formë shkresore dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “D. M.” sh.p.k., me ofertën më të ulët 99,825.22 lekë (pa Tvsh).</p> <p>Në procedurën e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe verifikimin paraprak të tyre, në të dyja institucionet janë konstatuar problematika, përkatësisht:</p> <p><i>Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë:</i> Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 2/2020, 2/2021 dhe 2/2022 nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit</p>		<p>marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe të pasqyrojnë qartë datën e skadencës dhe praninë e pullës.</p> <ul style="list-style-type: none">- Komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit.- Në çdo rast, që nuk është i arsyetuar nga mjeku i Institucionit arsyeja se përse kërkohet medikamenti me emër tregtar, procedurat e prokurimit të kryhen me emër principi aktiv.
--	--	---



<p>nga data e dorëzimit në institucion dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me flete dalje.</p> <p><i>Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër:</i> Lidhur me procedurën e blerjeve të medikamenteve për vitin 2020, ngritur me Urdhër nr. 4/3-2020, konstatohet se më datë 01.06.2020 komisioni ka marrë në dorëzim medikamentet 40 prej medikamenteve, të cilat përbëjnë 57 % të sasisë së medikamenteve të bëra hyrje më datën 01.06.2020 (datë në të cilën medikamentet janë bërë hyrje në magazinën e SHMSH), janë me datë skadence më pak se 2 (dy) vjet. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr.21 prot., datë 28.01.2021, konstatohet se më datë 02.09.2021 janë marrë në dorëzim medikamentet, pasi është bërë kontrolli në sasi dhe cilësi të tyre. Në procesverbalin e mbajtur nuk konstatohet që komisioni i marrjes në dorëzim të jetë shprehur mbi skadencën e mallit dhe plotësimin e kriterit të vendosur në ftesën për ofertë. Gjithashtu, komisioni i ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022, konstatohet se më datë 02.09.2022 ka marrë në dorëzim medikamentet, pasi bëri kontrollin në sasi dhe cilësi të tyre dhe nuk është shprehur lidhur me afatin e skadencës së tyre.</p> <p>Në të dyja institucionet janë konstatuar problematika me procedurën e blerjes së medikamenteve, të cilat janë kërkuar me emër tregtar dhe jo</p>			
---	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>me emër të principit aktiv të barit, duke ndikuar në këtë mënyrë në trajtimin e barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbimin si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, veprim në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 10, të Ligjit nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p><i>Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë</i> në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se respektivisht 25 barna në përqindje 20.5 % për vitet 2020, 2021, 2022 janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit.</p> <p><i>Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër</i> në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se për vitet 2020, 2021, 2022, respektivisht 22 barna, 25 barna dhe 14 barna, në përqindje 26.5 %, 28.4 % dhe 14 % janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit. Veprime në kundërshtim me pikën 4, neni 36, Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.</p>			
13	<p>Nga auditimi në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër është konstatuar se në ftesën për ofertë për vitin 2020 dhe 2021 është vendosur fondi limit i procedurës së prokurimit, i cili si rrjedhojë është bërë publik për operatorët duke ndikuar në ofertën reale bazuar në të dhënat teknike sasiore që prokurohen, veprim në kundërshtim me shkronjën “b”, pika 3, udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Gjatë auditimit në</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Mesme	<p>Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurë të blerjeve të vogla në ftesën për ofertë të mos vendosë fondin limit të procedurës.</p> <p>Për medikamentet e rimbursueshme të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se për vitin 2020 janë prokuruar dhe janë marrë në dorëzim gjithsej 83 (tetëdhjetetë) medikamente të ndryshme, për vitin 2021 gjithsej 88 (tetëdhjetetë) dhe për vitin 2022 gjithsej 48 (dyzetetë). Është konstatuar se një pjesë e medikamenteve të prokuruar dhe të marra në dorëzim, referuar listës II të barnave në farmacitë e rrjetit të hapur për vitin 2020 miratuar me VKM nr. 101, datë 27.02.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 218, datë 20.4.2018, të këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe masës së mbulimit të çmimit të tyre” dhe vitit 2021 dhe 2022 miratuar me VKM nr. 489, datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre” janë barna të rimbursueshme. Përkatësisht në numër dhe përqindje barnat e rimbursueshme të prokuruar kanë qenë: për vitin 2020, 29 barna nga 83 në përqindje 35 %; për vitin 2021, 29 barna nga 88 në përqindje 33 % dhe për vitin 2022, 17 barna nga 48 në përqindje 35.4%. Edhe pse medikamentet sipërcituar janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme (pjesërisht apo të plotë), pjesë e paketës së përfitimit nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, mjekja e institucionit si dhe personeli ndihmës sipas rastit për të tre vitet në kërkesat iniciuese kanë kërkuar blerjen e tyre duke përjashtuar në këtë mënyrë mundësinë e pajisjes me to me anë të rimbursimit. Veprime në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 10 të Ligjit nr.10383, datë</p>			<p>ndiqet procedura për përfitimin e rimbursimit, si dhe të gjitha fletëdaljet të plotësohen saktë me të gjithë informacionin e kërkuar</p>
--	--	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Nga auditimi në SHMSH është konstatuar se dalja nga magazina dokumentohet me fletëdalje me destinacion për përdorim për mjekën dhe kujdestaren e Institucionit. Në të gjitha fletëdaljet konstatohet se data nuk plotësohet e saktë, por vendoset periudha mujore duke mos përcaktuar saktësisht datën e daljes së mallit, gjithashtu për vitin 2020 për të gjitha fletëdaljet konstatohet se nuk kanë numër rendor, veprime në kundërshtim me pikën 36, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p>			
14	<p>Në të tre procedurat e zhvilluara pranë Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë për blerje medikamentesh, konstatohet se përlllogaritja e fondit limit nuk është pasqyruar në proces verbalet përkatëse të mbajtura nga grupet e ngritura për këtë qëllim. Grupi i punës është shprehur në procesverbalin e mbajtur: ”Grupi i punës për testimin e tregut është mbështetur tek libri i medikamenteve me çmimet përkatëse për secilin medikament”, duke mos pasqyruar vlerën për secilin prej tyre dhe përlllogaritjen totale, veprim në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimin nr. 05/2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Nga auditimi në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë u konstatua se si kriter kualifikues në këtë procedurë është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, konstatohet mungesa e dorëzimit të dokumentacionit sipërcituar, në kundërshtim me</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë).</p>	E Mesme	<p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në çdo rast përlllogaritja e fondit limit të pasqyrohet me procesverbal të veçantë se si është përlllogaritur ai.- Të mos shpallë fitues operatorë ekonomik bë mungesë të plotësisht të dokumentacionit ligjorë të kërkuar nga AK.- Në çdo rast të kryhet inventarizimi i medikamenteve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>pikën 7, Udhëzimit nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.</p> <p>Gjatë auditimit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, për periudhën objekt auditimi 2020-2022, konstatohet se edhe pse janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhrat e titullarit nr. 146/1 prot., datë 11.09.2020, për vitin 2021 shkresa nr. 128 prot., datë 15.11.2021 dhe për vitin 2022 shkresa nr. 109., datë 25.10.2022, nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare që nëpunësi zbatues i institucionit të ketë ndërmarrë procedura për kryerjen e inventarizimit të medikamenteve, duke ndikuar në mungesën e vërtetimit të saktësisë, cilësisë së gjendjes fizike të medikamenteve në një kohë, veprime në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p>		
15	<p>Nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Nga institucioni disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion subjekti për periudhën objekt auditimit, por rezulton se nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 33/2010 “Për</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	<p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Sipërfaqja totale e tokës, që ka Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.</p>		<p>institucionit në ASHK</p> <p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.</p>
16	<p>Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 320,283 lekë, vlerë për të cilën nuk u dhanë sqarime nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	<p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëjë sistemimin dhe pasqyrimin e saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<i>neto/fondet neto</i> ”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, i ndryshuar.			
17	<p>Nga analiza e pasqyrës “<i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto</i>” konstatohet se llogaria 218 “<i>Inventar ekonomik</i>”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve, për vitin 2021 në vlerën 43,947 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën prej 5,497 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve, veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36.</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë).</i></p>		<p>Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “<i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto</i>” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin (2023).</p> <p>Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “<i>Inventar ekonomik</i>” në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.</p>
18	<p>Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër nga auditimi u konstatua se Urdhëri/at e NA “<i>Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit</i>” nuk kanë përcaktuar një datë të përfundimit të procesit të inventarizimit.</p> <p>Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion për NA, lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër)</i></p>	E Mesme	<p>Titullari i institucionit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjësën e Sektorit të Administratës në cilësinë e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>përdorim, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 85, germa “a” dhe germa “c”.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbal nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar në arkivë, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa “c”, 105.</p> <p>Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit për anëtarët e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 82.</p> <p>NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit, por në përbërje të tij rezultojnë të njëjtët anëtarë me komisionin e inventarizimit të vitit paraardhës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 84.</p> <p>Komisioni Asgjësimit ka mbajtur Proces Verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet</p>		<p>Nëpunësit Zbatues, në vazhdimësi të marrë masa që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të kërkojë dhe zbatojë me përpikmëri procedurën e parashikuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke eliminuar problematiken e hasur gjatë këtij auditimi të konstatimit të mungesës së urdhrimit për ngritje komisioni, mungese e deklaratës së shmangies se konfliktit të interesit, mungesës së mbajtjes se proces verbalit, të shmangies së të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite resht, mungesë firmosje nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesës se relacionit për titullarin, etj..</p>
---	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 109; 110.</p>			
19	<p>Nga auditimi në Shtëpisë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se Komisioni Inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal për fiksimin e numrit rendor të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, i cili duhet mbajtur më përgjegjës in e materialit dhe komisionit. Në asnjë nga fletët e inventarit për asnjë nga vitet objekt auditimi, përgjegjës it e materialeve as nuk janë identifikuar si dhe nuk kanë firmosur në fletët e inventarizimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 83.</p> <p>Titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës për nxjerrjen jashtë përdorimit i përbërë nga tre anëtarë dhe jo me 5 anëtarë, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100.</p> <p>Nga auditimi i Regjistrit të Aktiveve, grupi i auditimit konstatoi se kishte mangësi në të dhënat specifike që duhet të këtë një regjistër aktivesh, si për shembull vendosja e përgjegjës it të materialit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 30.</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Mesme	<p>Nëpunësi zbatues për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve duke përcaktuar edhe personat përgjegjës të materialeve. Grupi i inventarizimit duhet të kryej inventarizimin e aktiveve të cilat janë në ngarkim të personave përgjegjës, në prani të tyre si dhe të hartojë proces-verbalin përkatës. Titullari i institucionit të marrë masa që grupi punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të përbëhet nga 5 anëtarë.</p>
20	<p>Nga auditimi Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë u konstatua se: Komisioni Inventarizimit nuk</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit</i></p>	E Mesme	<p>Nëpunësi zbatues të marrë masa ku në zbatim të urdhrat</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>ka kryer inventar për gjendjen në sasi dhe vlerë të farmacisë si dhe kuzhinës, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 “Mallra ushqimore” dhe llogarisë 327 “Inventar i imët”, i cili duhet të firmosur nga përgjegjësi material (magazinieri dhe infermierja), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 83.</p>	<p><i>Përfundimtar të Auditimit Tiranë).</i></p>		<p>të Titullarit, në rolin e përgjegjësit për monitorimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit të kryej çdo fund viti, inventarin edhe të gjendjes sasiore dhe cilësore të artikujve të institucionit si dhe kuzhinës.</p>
21	<p>Grupi i audituesve të KLSH-s, në procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së kontratave të lidhura me AK për “blerje ushqimesh”, lidhur me zbatimin e kontratave për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, referuar kontratës nr. 131, datë 08.07.2020; kontratës nr.177, datë 01.07.2020, kontratës nr. nr.273, dt. 01.01.2020; kontratës nr.5, dt. 05.01.2021; kontratës nr.21, datë 21.01.2021; kontratës nr.30, dt. 21.01.2022, kontratës nr.52, dt. 11.03.2022 dhe kontratës nr.22, datë 18.01.2022 dhe për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër referuar kontratës nr. 265, datë 01.2.2020; kontratës nr.264, datë 01.12.2020, kontratës nr.210, dt. 02.10.2020; kontratës nr.211, dt.02.10.2020; kontratës nr.17, datë 08.01.2021; kontratës nr.18, dt. 08.01.2021, kontratës nr.16, dt. 08.01.2021, kontratës nr.14, dt. 08.01.2021; kontratës nr.15, dt.08.01.2021; kontratës nr.250, datë 03.02.2022; kontratës nr.36, dt. 26.01.2022, kontratës nr.34, dt. 26.01.2022, kontratës nr.247, dt. 26.09.2022, kontratës nr.32, dt. 26.01.2022 dhe kontratës nr.33, datë 26.01.2022 nga auditimi dokumentacionit të dosjes/ve të zbatimit të kontratave rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Komisioni i Pranimit të Mallit ngritur me urdhër të posaçëm të	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>		<p>Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatës/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kriterëve të kualifikimit të OE. Këto dokumente duhet të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>NA, nuk ka përcaktuar si pjesë e komisionit magazinierin e institucionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.</p> <p>- Proces Verbali/et, e pranimit të mallit perimeve dhe zarzavateve nuk kanë evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së parë, nuk kanë fletë analizë në rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar. Proces Verbali/et, pranimit të produktit mish/ të përpunuar i mishit (sallam, proshuta, etj.) nuk përmbanin të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinare, e cila do të vërtetonte sigurinë e produktit dhe vërteton se produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të DST.</p> <p>- Proces Verbali/et, pranimit të bulmetrave për furnizimin me djathë nuk kanë të evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit;</p> <p>- Për furnizimin me vezë nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005</p>			<p>evidentohen në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së zbatimit të kontratës. Proces verbali të hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave të bëhet pjesë e dosjes.</p>
---	--	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët;</p> <p>- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;</p> <p>Sa më sipër, rezulton se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të nuk është respektuar standardi i pranimi të mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuara në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni</p> <p>Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 4.</p>			
22	<p>Grupi i auditimit konstatoi se në asnjë nga kontratat e lidhura për furnizimin me ushqim të të moshuarve nga OE “M.C.” dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër nuk është respektuar pika 2/a e nenit 6 të kontratës ku e cila ka të bëjë me “Grafikun e lëvrimit të mallit”, ku OE duhet të furnizojë me ushqim 1 deri në 2 herë në</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 113-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Lartë	<p>Nëpunës zbatues i Shtëpia e të Moshuarve Shkodër si përgjegjës për ndjekjen e kontratës, të marrim masa të menjëhershme, ku në zbatim të pikën</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>jave sipas kërkesave të OE, me ushqimet e ndryshme në bazë të grafikut të lëvrimit, por referuar fletë hyrjeve të magazinës, të gjitha furnizimet janë bërë një herë në muaj, duke rrisur kështu cilësinë e ushqimeve prej kohës së gjatë të mbajtur në magazinë.</p>			<p>2/b të nenit 6 të të gjitha kontratave të lidhura me OE "M.C", ky i fundit të kryej furnizimet e ushqimeve sipas grafikut të lëvrimit, për të siguruar cilësinë e tyre si dhe të paraqesin në proces verbalet pjesore për të lënë gjurmë për sasinë, cilësinë dhe shpeshësinë e furnizimit.</p>
23	<p>Në institucionet publike rezidenciale për të moshuar ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për të moshuarit.</p> <p>Në <i>Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë</i> rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar më pak se kuota e miratuar 360 lekë/ për person në ditë, për vitin 2020 në total 218,808 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur, për vitin 2021 në total 85,179 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur për auditim dhe për vitin 2022 në total 138,027 lekë/muaj për 7 muajt e përzgjedhur për auditim.</p> <p>Në institucionin publik rezidencial <i>Shtëpia e të Moshuarve Shkodër</i> rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës në muajin shkurt dhe nëntor përzgjedhur për auditim për vitin 2020 kanë konsumuar në total 13,257 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore, për 4 muajt e përzgjedhur për vitin 2021 kanë konsumuar 23,976 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore dhe për 5 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022 kanë konsumuar 36,335 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>	E Lartë	<p>Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen zbatimin e kuotës ushqimore ditore në fuqi të çdo përfituesi</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTËTIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>Mos zbatimi i nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë për person nga Shtëpia e Moshuarve Tiranë dhe Shkodër është në papajtueshmëri me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.</p>			
24	<p>Nga auditimi i praktikave dokumentare të hartimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit, për muajt e përzgjedhur në <i>Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër</i> grupi i auditimit konstatoi se në shumicën e fletëdaljeve (70% e tyre) ishin me korrigjime të shumta të vlerave, sasive apo totalit përfundimtar, nuk janë administruar kopjet e fletë daljeve në blloqet e administruara nga magazina, rrethana mbi të cilat grupi i auditimit nuk mund krijojë siguri të arsyeshme për të dalë një rezultat të saktë, veprime ne kundërshtim me nenin 6 dhe nenin 9.3 të Ligjit nr. 10296 “Për për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit NR. 15, Paragrafi 58.</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Mesme	<p>Nëpunësi Zbatues në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër ne cilësinë e personit përgjegjës që kontrollon të gjitha veprimet që bëhen në magazinë, në lidhje me hyrjet dhe daljet nga magazina të marri të masa të menjëhershme që flete daljet e magazinës të plotësohet konformë ligjit dhe elementeve të dokumentacionit duke mos lejuar shënime dhe korrigjime mbi dokument</p>
25	<p>Lidhur me mjediset e banimit në institucionet rezidenciale, referuar VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” si dhe në zbatim të tij Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të</p>	<p><i>(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</i></p>	E Lartë	<p>Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të marrin masa për të plotësuar nevojat minimale të kujdesit personal për të moshuarit rezident si dhe të sigurojnë vendosjen e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p><i>përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, nga grupi i auditimit u krye verifikimi i zbatimit të Standardit nr.10 i cili ka përcaktuar standardin minimal të akomodimit në qendër për dhoma gjumi me një sipërfaqe të përdorshme prej 12 m² për dhomat me dy shtretër dhe 18 m² për dhomat me tre vende. Dhomat duhet të jenë të rregullta, të lejojnë lëvizjen, manovrimin dhe rrotullimin e karrigeve me rrota dhe të pajisjeve të tjera për ecjen. Standardi nr. 10 ka përcaktuar vendosjen e tualeteve për çdo dhomë me dy vende, ose 1 tualet në çdo dy dhoma me një vend, që lejojnë hyrjen dhe lëvizjen me karrige me rrota; sinjale për thirrjet e urgjencës, shërbimet higjienike për çdo shtrat; vendosja e sistemeve të ngrohjes gjatë dimrit dhe të freskimit gjatë verës”....</i></p> <p>Nga verifikimi i zbatimit të Standardit nr.10 për: <i>-Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik, grupi i auditimit konkludoi se nuk është respektuar asnjë nga tre standardet e mësipërme, si standarde të cilat ruajnë higjienën dhe janë standarde minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Dhomat e të moshuarve në total janë 23 dhoma nga të cilat 5 dhoma treshe, 12 dhoma dyshe dhe 6 dhoma njëshe ishin treshe ose dyshe. Grupi i auditimi konstatoi se nuk respektohet standardi në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale, por një banjë shfrytëzohej nga minimumi 3 vetë deri në 5 vetë. Gjithashtu, nga 23 dhoma, për të siguruar freskimin e ambientit vetëm tre dhoma ishin të pajisura</i></p>		<p>sinjaleve për thirrje urgjence në të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat në mënyrë që shërbimi ndaj tyre të jetë sa më efikas, eficient dhe i sigurtë.</p>
--	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>me kondicionerë ndërsa 20 dhomat e tjera jo. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.</p> <p>-Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, referuar standardeve të sipërpërmendura, referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik, grupi i auditimit konkludoi se nga institucioni nuk është respektuar asnjë nga tre standardet e miratuara, standarde të cilat ruajnë higjienën si dhe janë kushte minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Në këtë institucion për të moshuarit në total janë dhoma 41 dhoma nga të cilat 14 dhoma njëshe, 25 dhoma dyshe dhe 2 dhoma katërshe. Grupi i auditimit konstatoi se nga institucioni nuk është respektuar Standardi nr. 10 në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale, pasi një tualet shfrytëzohej nga minimumi 5 vetë deri në 20 vetë. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.</p>			
25	<p>Grupi i auditimit konstatoi se referuar pesë loteve të Marrëveshjes Kuadër fituar nga OE “M.C.” (ku të gjitha kushtet janë të paracaktuara), Titullari i Institucioni në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues nuk ka respektuar lidhjen e kontratës më afat 24 muaj, nëpërmjet minikontratave, por i ka lidhur ato për një periudhë më të shkurtër pa pasur asnjë arsye në lidhje me konsumimin e tyre në një kohë më të shkurtër, duke lidhur kështu kontrata të tjera po me të njëjtët operator për periudhën e mbetur, duke rezultuar në mbivendosje kontratash.</p> <p>Loti 5 Furnizim me “Veze”</p>	<p>(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).</p>		<p>Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje prokurimet e kryera nga Institucioni për mbivendosjen e kontratave për shërbimin “Furnizim me ushqim” në vlerën totale 1,891,176 lekë, me qëllim menaxhimin me efektivitet,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

<p>kontrata e lidhur për lidhur për 23 muaj (1 muaj mangët) Loti 2 Furnizim me “<i>Bulmet dhe nënprodukte e tij</i>” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët) Loti 3 Furnizim me “<i>Mish dhe nënprodukte e tij</i>” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët) Loti 7 Furnizim me “<i>Fruta Perime</i>” lidhur për 20 muaj (4 muaj mangët) Loti 4 Furnizim me “<i>Ushqime Koloniale</i>” lidhur për 23 (1 muaj mangët)</p> <p>Nga auditimi u konstatua se titullari i institucionit për të mbuluar muajt e kontratave të ezauruara përpara afatit, ka prokuruar blerjen e produkteve ushqimore për periudhën që këto produkte ushqimore kanë qenë të mbuluara nga po i njëjti OE, për te cilin Shtëpia e të Moshuarve Shkodër ka lidhur Marrëveshjen Kuadër 24 mujore të kryer nga ish-Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në vlerën totale 1,891,176 lekë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duke shkaktuar mbivendosje të kontratave si dhe efekt negativ financiar ne buxhetin e shtetit për kontratat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">○Kontrata nr.250 prot., datë 03.10.2022 me OE “M.C.” per furnizim me bulmet dhe nënprodukte e tij, në vlerën total prej 949,440 lekë.○Me urdhër shpenzimin nr.177 datë 28.12.2022 miratuar nga titullari dhe NZ i institucionit është kryer likuidimi i faturës në vlerën 15,312 lekë për OE “M.C.” per furnizim me veze.○Kontrata nr. 247 prot., datë 26.09.2022 me vlerë 464,064 lekë, lidhur me OE “M.C.” sh.p.k, furnizim me mish dhe nënprodukte e tij <p>Me urdhër shpenzimin nr.135 datë 07.10.2022 miratuar nga titullari dhe NZ në vlerën 462,360 lekë, nga OE “N.” shpk furnizim me Fruta Perime.</p>		<p>ekonomicitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare për Buxhetit të Shtetit</p> <p>Titullari i institucionit në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa të menjëhershme për të respektuar të gjitha kushtet e parashkruara në Marrëveshjen Kuadër, ku një prej tyre është edhe afati i zbatimit të kontratës, për të shmangur mbivendosjet e kontratave, apo prokurimet e pajustificuara dhe argumentuara të zhvilluara nga AK për të shmangur shpenzimet pa efikasitet, eficiencë dhe efektivitet për Buxhetin e Shtetit</p>
--	--	--



1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, të ushtruar në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 438/1, datë 02.06.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Sa i përket auditimit të përputhshmërisë, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, duke u evidentuar mangësi në përcaktimin e kritereve të vendosura në procedurat e prokurimit, në monitorimin dhe zbatimin e kontratave, të cilat për nga rëndësia kanë rezultuar të jenë materiale, por jo të përhapura, duke mbështetur dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar¹).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”², Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Shtëpisë së Moshuarve Tiranë & Shkodër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin e mëposhtëm, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të shërbyer si bazë për opinionin tonë (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Opinioni e dhënë e mbështesim në faktin se subjektet e audituar Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, përgjithësisht kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampionëve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror nuk kanë amenduar ndryshimin e kuotës ushqimore nga 360 lekë/ditë në 430 lekë/ditë Udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

- Udhëzimi nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në

¹-Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (vendim nr, 245, datë 29.12.2022. fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinioneve e pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinionin të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

²-ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë



institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, nuk është bërë me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ne shkelje të afateve ligjore të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit Nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”, nuk ka nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë plotësisht pagesat e tarifave e shërbimit dhe përfitimin e shpenzimeve personale për të moshuarit, nuk ka indeksuar shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve, nuk ka nxjerrë akte nënligjore për miratimin e standardeve, mekanizmat e përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit, mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë, nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e transferimit të institucioneve rezidenciale për të moshuar në njësitë e qeverisjes vendore, në papajtueshmëri me kërkesat e nenit 52, pika 1 të Ligjit nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror në miratimin e PBA 2020 -2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 nuk kanë vlerësuar kostot e projektit të investimeve për shpenzime kapitale.

- Në *Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë* të moshuarit dhe personeli mbështetës janë trajtuar nën normën e konsumit ushqimor 360 lekë për person në ditë, me një efekt 218,808 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur për vitin 2020, me një efekt 85,179 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2021 dhe me një efekt 138,027 lekë/muaj për 7 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022.

- Në institucionin publik rezidencial *Shtëpia e të Moshuarve Shkodër* rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar 23,976 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore për 4 muajt e përzgjedhur për vitin 2021 dhe 36,335 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore për 5 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022.

- Pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese 40% të pensionit të pleqërisë, në të ardhurat e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, pjesa e mbetur e pensionit mujor ka rezultuar më pak se 6,000 lekë/muaj ose me pak se kuota 6,000 leke/muaj që ata do të përfitonin sipas kriterëve VKM nr. 840, datë 3.12.2014 në rast se të moshuarit nuk do të gëzonin pension pleqërie.

- Për të moshuarit e vendosur në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, institucioni ka llogaritur, mbajtur dhe derdhur në buxhet tarifën 40% mbi pensionin social, në kundërshtim me pikën 2 të VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “*Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror*”.

- Nga auditimi i praktikave dokumentare të hartimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit, për muajt e përzgjedhur në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër grupi i auditimit konstatoi se në shumicën prej fletëdaljeve (70% e tyre) ishin me korrigjime të shumta të vlerave, sasive apo totalit përfundimtar, rrethanë nga ku grupi i auditimit, nuk mund krijojë siguri të arsyeshme për të dalë një rezultat të saktë.

- Në Shtëpinë/të e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër rezultoi se sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlefën 0 lekë.

- Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, nga analiza e pasqyrës “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto*” konstatohet se Llogaria 214 “*Instalime Teknike makineri, pajisje*”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 320,283 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve

- Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër rezultoi se Urdhri/at e NA “*Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit*” nuk kanë datë të përfundimit të procesit të inventarizimit, mungon relacion për NA. *Komisioni i Vlerësimit* ka mbajtur proces



verbal pa prezencën e personit që ka në ngarkim mallin, *Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit*. Në përbërje të Komisionit e Inventarizimit, rezultojnë të njëjtët anëtarë si në vitet paraardhës. Komisioni inventarizimit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë nuk ka kryer inventar mbi gjendjen në sasi dhe vlerë të artikujve farmaceutikë si dhe të mallrave dhe aktiveve në kuzhinë, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 “Mallra ushqimore” dhe llogarisë 327 “Inventar i imët”. Komisioni inventarizimit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në proces verbalin e inventarit fizik nuk ka evidentuar numrin rendor të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve. Fletët e inventarizimit nuk janë identifikuar dhe nuk janë firmosur nga anëtarët e komisionit. Urdhëri titullarit për grupin e punës për nxjerrjet jashtë përdorimit përbëhet nga 3 dhe jo me 5 anëtarë. Regjistri Aktiveve ka mangësi në të dhënat specifike të cilat duhet të këtë një regjistrë aktivësh

- Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër rezultoi se në asnjë nga kontratat e lidhura për furnizimin me ushqim të Moshuarve nga OE “M.C.” dhe institucioni nuk ka respektuar pikën 2/a e nenit 6 të kontratës ku e cila ka të bëjë me “*Grafikun e lëvrimin të mallit*”, ku OE duhet të furnizojë me ushqim 1 deri në 2 here në javë sipas kërkesave të OE, me ushqimet e ndryshme në baze të grafikut të lëvrimin, por referuar fletë hyrjeve të magazinës, të gjitha furnizimet janë bere një herë në muaj, duke riskuar kështu cilësinë e ushqimeve prej kohës së gjatë të mbajtur në magazinë.

- Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër referuar pesë loteve të Marrëveshjes Kuadër fituar nga OE “M.C.” (ku të gjitha kushtet janë të paracaktuara), Titullari i Institucioni në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues nuk ka respektuar lidhjen e kontratës *më afat 24 muaj*, nëpërmjet minikontratave, por i ka lidhur ato për një periudhë më të shkurtër pa pasur asnjë arsye në lidhje me konsumimin e tyre në një kohë më të shkurtër, duke lidhur kështu kontrata të tjera po me të njëjtët operator për periudhën e mbetur, duke rezultuar në mbivendosje kontratash në: Loti 5 Furnizim me “Veze” kontrata e lidhur për 23 muaj (1 muaj mangët); Loti 2 Furnizim me “Bulmet dhe nënprodukte e tij” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët); Loti 3 Furnizim me “Mish dhe nënprodukte e tij” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët); Loti 7 Furnizim me “Fruta Perime” lidhur për 20 muaj (4 muaj mangët); Loti 4 Furnizim me “Ushqime Kolonjale” lidhur për 23 (1 muaj mangët)

- Lidhur me zbatimin e kontratave për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë blerje ushqimesh rezultoi se komisioni pranimit të mallit ngritur Urdhër të posaçëm të NA, nuk ka përcaktuar si pjesë të komisionit magazinierin e institucionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43. Proces Verbal/et e pranimit të mallit “fruta dhe perime” nuk kanë evidentuar cilësinë e mallrat e furnizuara, nuk kanë fletë analizë në rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhënat mbi treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit dhe nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar. Proces Verbal/et pranimit të produktit mish/ të përpunuar i mishit (sallam, proshuta, etj.) nuk përmbajnë të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinare për sigurinë e produktit për të vërtetuar se produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprime në kundërshtim me kërkesat specifike të DST.

- Proces Verbal/et, pranimit të bulmetrave (qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët) Proces verbali për pranimin e artikullit djath nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit; Për furnizimin me veze nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe



Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët. Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Nga likuidimet e kryera nga sa sektori i financës, referuar urdhër shpenzimeve për të gjithë OE të cilët kanë furnizuar me Ushqim Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, rezultoi se mungonin situacionet (proces verbalet) mujore të furnizimeve me ushqim në sasi dhe vlerë e të firmosur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallit si dhe OE si dhe proces-verbali i marrjes në dorëzime, i cili shërben si dokument vërtetues në kundërshtim me pikën 54 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “*Menaxhimi i Aktiveve të NJSP*”

- Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

- Hartimi i menisë së ushqyerjes së moshuarve Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, nuk ka përcaktuar një normë ushqyerje sipas kartelave mjekësore të secilit nga të moshuarve duke i ndarë në grupe. Mjeku institucionit nuk ka përcaktuar menu specifike në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik

- Titullari i Institucionit për të mbuluar muajt e kontratave të ezauruara përpara afatit, ka prokuruar blerjen e produkteve ushqimore për periudhën që këto produkte ushqimore kanë qenë të mbuluara nga po i njëjti OE për të cilin Shtëpia e të Moshuarve Shkodër ka lidhur kontratën referuar Marrëveshjes Kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara) 24 mujore të kryer nga ish-Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në vlerën totale 1,891,176 lekë, duke shkaktuar mbivendosje të kontratave si dhe *efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit*.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Shtëpisë së Moshuarve Tiranë & Shkodër, janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër dhe Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të SHMT & SHMSH, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetore të saj, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues të personave me liri të kufizuar. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit me nr. 438/1, datë 02.06.2023, i ndryshuar me nr. 438/2, datë 25.07.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 20.04.2022 deri në 10.07.2022 në subjektin SHMT, për periudhën nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022, u krye auditimi “i Përputhshmërisë në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë”, (SHMT) nga:

Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.E. K.i, Përgjegjës Grupi
- 2.E. K., Auditues i Lartë
- 3.E. T., Auditues.

1) Titulli:

Projekt raporti i auditimit të përputhshmërisë në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë.

2) Marrësi:

Ky Projektraport i adresohet Shtëpisë së Moshuarve Tiranë znj. A. P.

3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i këtij auditimi ka për qëllim kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim të një vlerësimi të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm që siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat. Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura për periudhën 2020-2022).

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj..

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,



- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Shtëpia e të Moshuarve Tiranë.

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime. Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

4) Identifikimi i çështjes:

Në Shqipëri sistemi i përkujdesit social për të moshuarit përbëhet nga institucione rezidenciale publike dhe jo publike. Shtëpitë e të moshuarve janë publike dhe financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe menaxhohen në nivel qendror.

Misioni i tyre është ofrimi i përkujdesit social mbi bazën e standardeve të miratuara për të moshuarit, duke përmirësuar cilësinë e jetës, nxitur integrimin social në jetën shoqërore dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në përputhje me parimet e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Konventës për të drejtat e Njeriut dhe Kartës Sociale Evropiane. Shtëpitë e të moshuarve Tiranë dhe Shkodër janë institucione rezidenciale kombëtare në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Ofrimi i shërbimeve rezidenciale bazohet në vlerësimin multidisiplinar të nevojave të tyre, duke siguruar punën në ekip të personelit për sigurinë dhe mbrojtjen e të moshuarve, duke zbatuar procedurat. Institucionet rezidenciale publike ofrojnë shërbim 24 orë për të moshuar, në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara në legjislacionin për sistemin e mbrojtjes shoqërore dhe udhëzimeve përkatëse që burojnë nga Ligji nr.121 datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.658 dt.17.10.2005 “Për standardet e Shërbimeve Shoqërore”; VKM nr. 821 dt 06.12.2006 “Për Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”; VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për Përfitimin e Tyre dhe Masën e Shumës për Shpenzime Personale për Përfituesit e Shërbimit të Organizuar”, Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Për periudhën objekt auditimi, Shtëpitë e të Moshuarve kanë funksionuar me strukturën e miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”, ndryshuar me Urdhër nr. 101, datë 13.07.2015, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe kuadrin rregullator Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër nr. 1565, datë 07.07.2016, dhe Rregulloren e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016.

Strategjia e institucionit në arritjen e objektivave bazohet në respektimin dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore, përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve nëpërmjet kualifikimit të stafit, menaxhimit efektiv, fuqizimit të burimeve materiale dhe financiare, dhënien e shërbimeve të personalizuara, duke vlerësuar nevojat e veçanta sociale, shëndetësore, emocionale, kulturore dhe materiale të përfituesve.



-Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat e miratuara etj.. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 438/1 prot, datë 02.06.2023, i ndryshuar.

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Drejtimi i Shtëpisë së Moshuarve Tiranë dhe Shkodër është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

6) Përgjegjësitë e audituesve. Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Projekt Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, projekt raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Projekt Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Projekt Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidencat e auditimit të marra janë të mjaftueshme për nxjerrjen e një konkluzioni apo opinionit mbi pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj..
- b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, etj..
- d) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj..)
- e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj..;



Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohej material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.

Objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe gjatë kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- ✓ Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- ✓ Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;
- ✓ Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”
- ✓ Udhëzimi nr. 7/2 datë 07.07.2018 “Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”
- ✓ Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”,
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit 2018”
- ✓ Ligj nr. 99, datë 3.12.2018 Për buxhetin e vitit 2019”
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.1 datë 17.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”
- ✓ Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”
- ✓ Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
- ✓ Udhëzimi nr. 8, datë 22.02.2019 të Ministrisë së Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2020-2022”.
- ✓ Udhëzimi nr. 21, datë 10.07.2019 të Ministrisë së Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2020-2022”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

- ✓ Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- ✓ Ligji nr.88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 20.01.2020
- ✓ Udhëzimi Plotësues shtesë nr.26 datë 08.07.2020
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”,
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- ✓ Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligji nr. 8869, dt.. 22.05.2003 .
- ✓ Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

8)Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”,
- ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Standardet për auditimin e përputhshmërisë”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA); Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj..
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

9)Metodat e auditimit, Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.



Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 2320** dhe **ISSAI 2450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0,7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu për institucionin SHMT, niveli i materialitetit për vitin 2020 rezultoi 581,896 lekë dhe për vitin 2021 rezultoi 552,868 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 568,004 lekë.

Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu për institucionin SHMSH, niveli i materialitetit për vitin 2020 rezultoi 662,340 lekë dhe për vitin 2021 rezultoi 643,480 lekë dhe për vitin 2022 rezultoi 632,340 lekë.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël, ku nga verifikimi rezultoi se Njësia shpenzuese përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019, 2020 dhe 2021, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për aktivet gjendje në magazine, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.



Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj..*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

10) Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe trajtimit të observacioneve të sjella nga subjekti i audituar, u përgatit ky Projektraport i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Shtëpia e të moshuarve Tiranë është një institucion rezidencial kombëtar në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Ofrimi i shërbimeve rezidenciale bazohet në vlerësimin multidisiplinar të nevojave të tyre, duke siguruar punën në ekip të personelit për sigurinë dhe mbrojtjen e të moshuarve, duke zbatuar procedurat.

Shtëpia e të moshuarve është institucion rezidencial publik, i cili ofron shërbim 24 orë për të moshuar. Ato funksionojnë në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara në legjislacionin për sistemin e mbrojtjes shoqërore dhe udhëzimeve përkatëse si Ligji nr.121 datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.658 dt.17.10.2005 “Për standardet e Shërbimeve Shoqërore”; VKM nr. 821 dt 06.12.2006 “Për Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”; VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për Përfitimin e Tyre dhe Masën e Shumës për Shpenzime Personale për Përfituesit e Shërbimit të Organizuar”.

Aktiviteti i institucionit dhe puna e personelit bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj moshës së tretë. Në realizimin e këtij misioni institucioni ofron shërbimin në zbatim të parimeve të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Konventës për të drejtat e njeriut dhe Kartës Sociale Evropiane duke synuar respektimin dhe garantimin e vlerave dhe personalitetit individual; gjithëpërfshirja; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar shërbime; partneriteti; transparencë dhe paanshmëri; pavarësi, integrim shoqëror dhe pjesëmarrje në komunitet; mosdiskriminim.

Institucioni ka objektiv krijimin e një mjedisi të ngrohtë, sa më pranë kushteve familjare ku të moshuarit në nevojë të ndihen të respektuar dhe të vlerësuar në dinjitetin dhe të drejtat e tyre;



nxitja e pjesëmarrjes së përfituesve në vendimarrje dhe organizimin e një jetese në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tyre; ofrimi i shërbimeve cilësore në përputhje me standardet e miratuara dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së përfituesve; integrimi social i të moshuarve në jetën e komunitetit; bashkëpunim me sektorin joqeveritar dhe donatorët për përmirësimin e shërbimeve dhe kushteve të jetesës së përfituesve; nxitja e autonomisë, vetëveprimit dhe pjesëmarrjes së përfituesve në jetën e institucionit dhe aktivitetet social-kulturorë.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Drejtimi I: Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit:

- a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit;
- b) Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar;
- c) Realizimi i planit të buxhetit.

A. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit;

- Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2020-2022**, ne mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2019 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022” Shtëpia e të Moshuarve Tiranë ka parashikuar shpenzimet buxhetore për PBA 2020-2022 dhe dërguar relacion në Shërbimin Social Shtetëror me shkresën nr. 149 prot, datë 26.06.2019 firmosur nga NA dhe NZ së bashku dhe formularët e projekt investimeve 2020-2022, hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Titullarit nr. 148, datë 19.06.2019 për parashikimin e shpenzimeve të PBA 2020-2022,

- Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2021-2023**, mbështet në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 28, datë 10.07.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”. Projekt buxheti 2021-2023 u hartua nga grupi i punës ngritur për këtë qëllim me Urdhër të Titullarit nr. 116 datë 15.06.2020. Institucioni me shkresën nr. 127 prot, datë 29.06.2020 ka dërguar në SHSSH relacion dhe pasqyrat e PBA 2021-2023, firmosur nga NA dhe NZ.

- Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2022-2024**, ne mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” si dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”; Projekt buxheti për vitin 2022-2024 u hartua nga grupi i punës ngritur për këtë qëllim me Urdhër të Titullarit nr. 82, datë 28.06.2021. Institucioni me shkresën nr. 88 prot, datë 05.07.2021 ka dërguar në relacion dhe pasqyrat e PBA 2021-2023 në SHSSH, firmosur nga NA dhe NZ.

Në mënyrë të përmbledhur planifikimi buxhetor në PBA 2020-2022; PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas PBA në SHM Tiranë (në mijë lekë)

	PBA 2020-2022	PBA 2021-2023	PBA 2022-2024
TE ARDHURA	N/A	N/A	3,132
SHPENZIME			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Paga	13,225	12,903	12,893
Sigurime shoqërore & shëndetësore	2,235	2,155	2,153
Shpenzime për mallra dhe shërbime	16,147	14,998	16,460
Transferta të buxhetet familjare dhe individë	0	0	0
Shp. Operative (A)	31,607	30,056	31,506
Investime	5,078	5,078	5,078
Shpenzime kapitale (B)	5,078	5,078	5,078
Totali (A+B)	36,685	35,134	36,584

(Burimi: SHM Tiranë)

1. Parashikimi i “Shpenzimeve për personelin” përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershme dhe të përkohshëm, shtesat mujore mbi page si orët për turnet e dyta dhe të treta. Për punonjësit me kategori paga e grupit është llogaritur 14.000 lekë, vjetërsi 2% dhe shtesë për funksion për çdo kategori sipas kriterëve të VKM Nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”. Për pagat e punonjësve mbështetës, fondi i pagave llogaritet mbi pagën e grupit sipas klasës, 1% vjetërsi dhe vështirësi turn i dytë dhe të tretë, sipas VKM Nr. 717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore, i ndryshuar. Përveç shpenzimeve për page, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësve të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto të punonjësve të nevojshëm me kohë të plotë dhe kontrate me punonjës me kohë të pjesshme.

- Parashikimi i shpenzimeve “Për mallra dhe shërbime” është zë i rëndësishëm në funksionimin e këtij institucioni dhe përfshin: -Zëri “Materiale dhe shërbime të përgjithshme” në të cilin parashikohen shpenzime për kancelari, materiale pastrimi, dezinfektim, blerje dokumentacioni, furnizime me materiale të tjera të përgjithshme; -Zëri “Materiale dhe Shërbime Sociale” përbëhet nga shpenzime për medikamente dhe materiale mjekësore, si dhe furnizime dhe ushqim për të moshuarit (menca) Shërbime speciale janë parashikuar blerje për veshje për të moshuar dhe uniforma për personelin; -Zëri “Shërbime nga të tretë” paraqet shpenzimet për shërbimet që realizohen nga të tretën si energji elektrike për shpenzime për ujë, posta, shërbim për ngrohje, shërbim pastrim gjelbërim, shpenzime mirëmbajtje, etj; - Zëri “Shpenzime transporti” paraqet shpenzime për karburant dhe pjese këmbimi; - Zëri “Shpenzime udhëtimi”, paraqet shpenzime për udhëtime të brendshme; -Zëri “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” shpenzime mirëmbajtje objekti dhe pajisje; -Zëri “Shpenzime për kuota që rrjedhin nga detyrimet” paraqet kërkesën lidhur me shpenzimet e pagimit të kuotës së të moshuarve rezident që nuk kanë të ardhura nga pensioni ose të ardhura të tjera; - Shpenzime “Te tjera operative” janë parashikuar shpenzime për shpenzime varimi, etj

- Parashikimi i shpenzimeve kapitale, parashikon shpenzimet që do të kryhen për krijimin ose blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1.728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m² me kosto 10.000 leke/m² llogaritur me kosto investimi 3,020 mijë lekë; blerje “frigorigjerë” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë leke

Institucioni rezidencial, gjatë hartimit të projekt buxhetit sipas PBA 2020-2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 ka paraqitur ndryshim të kërkesës buxhetore në PBA 2021-2023 dukë pakësuar shpenzime për paga në shumën 322 mijë lekë, për pasojë ulje të shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 80 mijë lekë, për shkak të rënies së efekteve të pandemisë. Në PBA 2021-2023 shpenzimet “Për mallra dhe shërbime” kanë ulje në shumën në shumën 1,149 lekë ndërsa në PBA 2022-2024 kërkesa rritet për 1,462 mijë lekë shpenzime. Burimi i vetëm i fondeve për realizimin e shpenzimeve është buxheti i shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2020

Në mbështetje të Ligjit organik nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”, UMF nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, shkresave të MSHMS nr. 247/2 prot, datë 28.01.2020 dhe nr. 185 prot, datë 29.01.2020, Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar plan buxhetin, numrin e punonjësve të miratuar dhe numrin e punonjësve me kontrate për vitin 2020 me shkresat nr. 185/1 prot, datë 10.02.2020, protokolluar në institucion me nr. 50, datë 12.02.2020, shkresa nr. 80/81 prot, datë 03.08.2020, protokolluar në institucion me nr. 176, datë 03.08.2020, shkresa me nr. 83/1 prot, datë 04.11.2020, protokolluar me nr. 225 , datë 10.11.2020

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”

Buxheti vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2020-2022	Çelja e buxhetit 2020	Shtesë/Pakësim	Totali	Plan Miratua /Plani Fillestar	Plan Miratua /Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	31,950	25,255	4,205	29,460	4,205	-2,490
Paga	13,542	9,945	3,280	13,225	3,280	-317
Sigurime	2,261	1,810	425	2,235	425	-26
Shërbime	16,147	13,500	500	14,000	500	-2,147
Transferata						0
Shp. Operative (A)	31,950	25,255	4,205	29,460	4,205	-2,490
Investime (231)	5,078	0	0	0	0	-5,078
Shp. Kapitale (B)	5,078	0	0	0	0	-5,078

(Burimi: SHM Tiranë

Punoi: KLSH)

SHSH ka dërguar plan buxhetin e vitit 2020 me shkresën nr. 185/1 prot, date 10.02.2020 në limit vjetore dhe mujor në shumën vjetore 25,255 mijë lekë dhe numrin e punonjësve me kontrate gjithsej për 15 punonjës.

Plani fillestar është shtuar për shpenzimet per paga dhe sigurime shoqërore me shkresën e SHSSH nr. 80/72 prot, datë 08.07.2020 në total 500 mije lekë, përkatësisht 400 mijë lekë për paga dhe 100 mijë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; shtuar me shkresën e SHSSH nr. 80/81 prot, datë 03.08.2020 në total 1,680 mije lekë në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, dt 02.07.2020 për paga në shumën 1,380 mijë lekë dhe për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 300 mijë lekë, shtesë me shkresën e SHSSH nr. 80/104 prot, datë 04.11.2020 në shumën 1,525 mije lekë për shpenzime për paga 1,500 mijë lekë dhe për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 25 mijë lekë, shtesë me shkresën e SHMT nr. 80/113 prot, datë 23.11.2020 në shumën 500 mijë lekë për shpenzime operative miratuar nga MSHMS me shkresë nr. 5087, datë 13.11.2020.

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2020 në shumën 29,460 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

Viti 2021

Në mbështetje të Ligjit organik nr. 9936, datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”, UMF nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, shkresës të MSHMS nr. 320/1 prot, datë 20.01.2021, Shërbimi Social Shtetëror me shkresë nr. 125/1 prot, datë

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

27.01.2021 ka dërguar planin e buxhetit vjetor të shpenzimeve korente në limite mujore për vitin 2021 me vlere 25,830 mijë lekë.

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues mbështetet në Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”.

Buxheti vitit 2021 krahasuar me kërkesat e PBA 2021-2023 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2021-2023	Çelja e buxhetit 2021	Shtesë/ Pakësim	Totali	Plan Miratuar /Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	31,607	25,830	2,050	27,880	-3,727
Paga	13,225	10,530	1500	12,030	-1,195
Sigurime	2,235	1,800	250	2,050	-185
Shërbime	16,147	13,500	300	13,800	-2,347
Transferta	0	0	0	0	0
Shp. Operative (A)	31,607	25,830	2,050	27,880	-3,727
Investime (231)	5,078	0	0	0	-5,078
Shp. Kapitale (B)	5,078	0	0	0	-5,078

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Plani fillestar ka ndryshuar sipas shkresës së MSHMS nr. 957/1 prot, datë 02.03.2021 protokolluar në SHSSH me nr. 333/8, dt 03.03.2021, dërguar dhe protokolluar në SHMT me nr. 333/14 prot, datë 08.03.2021 duke shtuar shpenzimet operative në total 2,050 mijë lek për shpenzime për paga në shumën 1,500 mije lekë, shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 250 mijë lekë dhe shpenzime të tjera 300 mijë lekë. Krahasuar me PBA 2021-2023 buxheti shtetit ka akorduar 3,727 mijë lekë më pak se kërkesa buxhetore.

Buxheti i akorduar nga SHSSH per vitin 2021 në shumën 27,880 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë

Viti 2022

Në mbështetje të Ligjit organik nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, UMF nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, shkresës të MSHMS nr. 5256/4 prot, datë 11.01.2022, Shërbimi Social Shtetëror me shkresë nr. 64/1prot, dt 19.01.2022, protokolluar në institucion me nr. 27, datë 20.01.2022, ka dërguar planin e buxhetit vjetor të shpenzimeve korente në limite mujore për vitin 2022 .

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, i ndryshuar.

Buxheti vitit 2022 krahasuar me kërkesat e PBA 2022-2024 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2022-2024	Çelja e buxhetit 2022	Shtesë/ Pakësim	Totali	Plan Miratuar /Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	28,630	28,630	-130	28,500	-130
Paga	12,100	12,100	335	12,435	335
Sigurime	2,030	2,030	50	2,080	50
Shërbime	14,500	14,500	-850	13,650	-850
Transferta	0		335	335	335
Shp. Operative (A)	28,630	28,630	-130	28,500	-130
Investime (231)	5,078	0	0	0	-5,078
Shp. Kapitale (B)	5,078	0	0	0	-5,078

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar plan buxhetin e vitit 2022 me shkresën nr. 64/1 prot, datë 19.01.2022, protokolluar me nr. 27 prot, datë 20.01.2022 duke dërguar planin vjetor të shpenzimeve korente, të detajuara në limite mujore në total 28,630 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Buxheti fillestar ka pësuar ndryshime gjate vitit buxhetor, me njoftim nga Shërbimi Social Shtetëror bazuar me:-shkresën nr. 69/30 prot, datë 19.04.2022, duke pakësuar fondet në shumën 1,450 mijë lekë në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 115/2021”; - shkresën nr. 69/84 prot, datë 27.09.2022, ka dërguar transferim fondesh, mbështetur në shkresën e MFE nr. 3618/1, dt 21.09.2022 duke shtuar në total fondet në shumën 105 mijë lekë përkatësisht për paga në shumën 95 mijë lekë dhe për sigurime shoqërore në shumën 10 mijë lekë; -shkresën nr. 2431 prot, datë 18.11.2022 ka dërguar transferim fondesh mbështetur në shkresën e MSHMS nr. 4294/1 prot, dt 11.11.2022 “transferim fondesh për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative” duke shtuar fondet ne total në shumën 290 mijë lekë përkatësisht për paga në shumën 90 mijë lekë dhe për sigurime shpenzime të tjera në shumën 200 mijë lekë; - shkresën nr. 2342/1 prot, datë 22.11.2022 ka dërguar transferim fondesh mbështetur në shkresën e MSHMS nr. 4028/4 prot, datë 10.11.2022 “Alokim fondesh në zbatim të VKM-ve nr. 621 dhe 627, datë 28.09.2022”, duke shtuar fondet në total në shumën 190 mijë lekë për shpenzime për paga në shumën 150 mijë lekë dhe sigurime shoqërore në shumën 40 mijë lekë; - shkresën nr. 2691/1 prot, datë 22.12.2022 ka dërguar akordim fondesh mbështetur në shkresën e MSHMS nr. 4642/3 prot, datë 15.12.2022 “Transferim fondesh për shpenzime operative”, duke shtuar fondet për shpenzime operative në total në shumën 400 mijë lekë; - shkresën nr. 928/1 prot, datë 30.01.2023 ka dërguar alokim fondesh për zbatimin e VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”, mbështetur në shkresën e MFE nr. 24043/33 prot, datë 11.01.2023, miratuar nga MSHMS me shkresë nr. 396 prot, datë 24.01.2028, duke transferuar fondet për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës, duke shtuar fondet për shpenzime operative në shumën 335 mijë lekë.

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2022 në shumën 28,500 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

Në plan buxhetin të vitit 2020, vitit 2021 dhe vitit 2022 MSHMS dhe Shërbimi Social Shtetëror nuk kanë vlerësuar kërkesën e institucionit rezidencial Shtëpia e të Moshuarve Tiranë për shpenzime kapitale për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1,728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m² me kosto 10.000 leke/m² llogaritur me kosto investimi 3,020 mije lekë;blerje “frigoriferë” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë lekë.

C. REALIZIMI I PLANIT TË BUXHETIT.

Viti 2020

Realizimi i buxhetit të SHM Tiranë për vitin 2020, krahasuar me kërkesat e vitit 2020, përcjellë nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2020-2022, alokimi fillestar të buxhetit dhe plan buxhetit të vitit 2020, i ndryshuar, paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Realizimi i buxhetit të vitit 2020 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2020-2022	Çelja e buxhetit	Buxheti me alokimet	Realizimi buxhetit	Realizimi (%)
Shpenzime (A)+(B)	37,028	25,255	29,460	29,095	98.76%
Paga	13,542	9,945	13,225	12,930	97.77%
Sigurime	2,261	1,810	2,235	2,173	97.21%
Shërbime	16,147	13,500	14,000	13,992	99.94%
Transferata	0	0	0	0	
Shp. Operative (A)	31,950	25,255	29,460	29,095	98.76%

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

Investime (231)	5,078	0	0	0	0.00%
Shpenzime kapitale (B)	5,078	0	0	0	0

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Në total për vitin 2020 sipas PBA 2020-2023 për shpenzimet operative nga SHMT janë kërkuar 31,950 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 25,255 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 29,460 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën 29,095 mijë lekë ose me një përqindje realizimi prej 98.76%. Struktura për paga dhe sigurime shoqërore u realizuan në vlerë 15,103 mijë lekë dhe përbëjnë 51.91% të shpenzimeve operative dhe shpenzimet për materiale dhe shërbime u realizuan në vlerë 13,992 mijë lekë dhe përbëjnë 48.09% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor 2020.

Viti 2021

Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2021 krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqiten sipas tabelës si më poshtë vijon:

Realizimi i buxhetit të vitit 2021 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2021-2023	Çelja e buxhetit	Buxheti me alokimet	Realizimi buxhetit	Realizimi (%)
Shpenzime (A)+(B)	36,685	25,830	27,880	27,643	99.15%
Paga	13,225	10,530	12,030	11,823	98.28%
Sigurime	2,235	1,800	2,050	2,025	98.78%
Shërbime	16,147	13,500	13,800	13,795	99.96%
Transfertë	0	0	0		
Shp. Operative (A)	31,607	25,830	27,880	27,643	99.15%
Investime (231)	5,078	0	0	0	0.00%
Shpenzime kapitale (B)	5,078	0	0	0	0

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Për vitin 2021 sipas PBA 2020-2023 institucioni rezidencial ka kërkuar buxhet për **31,607** mijë lekë. MSHMS dhe SHSSH fillimisht kanë alokuar 25,830 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 27,880 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve të kryera nga institucioni rezultoi në vlerën 27,643 mijë lekë ose realizuar 99.15% e buxhetit të alokuar nga SHSSH.

Struktura për paga dhe sigurime shoqërore realizuar në vlerë 13,848 mijë lekë përbën 50.10% të shpenzimeve operative dhe shpenzimet për materiale dhe shërbime përbëjnë realizuar në vlerë 13,795 mijë lekë përbën 49.90% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor 2021.

Viti 2022

Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2022, krahasuar me kërkesat e institucionit, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2022-2024, alokimit buxhetit fillestar me ndryshime paraqitet sipas tabelës si më poshtë vijon:

Realizimi i buxhetit të vitit 2022 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2022-2024	Çelja e buxhetit	Buxheti me alokimet	Realizimi buxhetit	Realizimi (%)
Shpenzime (A)+(B)	33,708	28,630	28,500	28,430	99.76%
Paga	12,100	12,100	12,435	12,366	99.45%
Sigurime	2,030	2,030	2,080	2,080	100.00%
Shërbime	14,500	14,500	13,650	13,649	99.99%
Transferta	0	0	335	335	100.00%
Shp. Operative (A)	28,630	28,630	28,500	28,430	99.76%
Investime (231)	5,078	0	0	0	0
Shpenzime kapitale (B)	5,078	0	0	0	0

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Për vitin 2022 sipas PBA 2022-2024 institucioni rezidencial ka kërkuar 33,708 mijë lekë. MSHMS dhe SHSSH fillimisht kanë alokuar 28,630 mijë lekë dhe me buxhetin e rishikuar janë alokuar fonde në vlerë 28,500 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve të kryera nga institucioni rezultoi në vlerën 28,430 mijë lekë ose realizuar 99.76% e buxhetit të alokuar nga SHSSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Struktura për paga dhe sigurime shoqërore realizuar në vlerë 14,446 mijë lekë përbën 50.81% të shpenzimeve operative dhe shpenzimet për materiale dhe shërbime janë realizuar në vlerë 13,649 mijë lekë përbejnë 48.01% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor 2022.

Institucioni ka kryer shpenzime 335 mijë lekë, klasifikuar në llogarinë 606 transferta për shpenzime të menjëhershme për mbështetje financiare të punonjësve të institucionit për zbatimin e VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”, bazuar në shkresën e MFE nr. 24043/33 prot, datë 11.01.2023, miratuar nga MSHMS me shkresë nr. 396 prot, datë 24.01.2028, dhe SHSSH me shkresë nr. 928/1 prot, datë 30.01.2023.

D) PARASHIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE DYTËSORE.

Në PBA 2020-2022; PBA 2021-2023 deri në PBA 2022-2024 institucioni nuk ka parashikuar të ardhurat nga pensioni pleqërisë, në përputhje me VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 114, datë 31.1.2007 të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, në të cilën përcaktohet pagesa e të moshuarve rezident për 40% të vlerës së pensionit mujor.

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, bazuar në faktin e vitit paraardhës dhe pritshmërive të saj ka parashikuar të ardhura nga derdhja e pensioneve si me poshtë:

Parashikimi të ardhurave

Emërtimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
	vitit 2020	vitit 2021	vitit 2022
Te ardhura (40% pensioni)	N/A	N/A	3,241

Pas vendosjes dhe përfitimit të të moshuarve në institucionin rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror, ka detyrim ligjor të ndalë dhe të derdhë në buxhet 40 % të pensionit të klientit rezident, sipas kritereve të VKM Nr. 114, datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror” (Ndryshuar me VKM nr. 840, datë 3.12.2014; nr. 107, datë 15.2.2017), vlerë e cila llogaritet dhe arkëtohet nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë nga pensioni mujor i pensionistit, sipas të dhënave të zyrës së financës, bazuar në mandat arkëtim dhe shoqëruar me “Listën emërore të moshuarve”. Të ardhurat e mbledhura nga pensionet nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë për vitin 2020 janë në shumën 3,133 mijë lekë, për vitin 2021 janë në shumën 3,143 mijë lekë dhe për vitin 2022 janë në shumën 3,318 mijë lekë. Arkëtimet nga të ardhurat e pensioneve paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Të ardhurat e institucionit nga pensionet (40%) (në mijë lekë)

Viti	Emërtimi	Balanci	Të ardhurat progresive	Pjesa e institucionit	Rritje	Derdhur ne buxhet	Mbeten per tu trashëguar
					autorizuar		
2020	Te ardhura	3,133	3,133	0.00	0.00	3,133	0.00
2021	Te ardhura	3,143	3,143	0.00	0.00		0.00
2022	Te ardhura	3,310	3,318	0.00	0.00	3,318	0.00

(Burimi : SHM Tiranë, Rakordimi me Degën e Thesarit)

Derdhja bëhet në R. B. me “Faturë për arkëtim” me përfitues Dega e Thesarit Tiranë në llogarinë ekonomike me kod 7190990. Regjistrimi të ardhurave bëhet sipas faturës për arkëtim dhe sipas rendit kronologjik. Të ardhurat janë derdhur 100% në Degën e Thesarit Tiranë, janë regjistruar në ditarin e të ardhurave, rakorduar me degën e thesarit. Rakordimi me Degën e Thesarit është progresiv deri në dhjetor të vitit kalendarik..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë rregullat për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Neni 53 i këtij ligji ka shfuqizuar pjesërisht ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndërsa Neni 51 pika 1 ngarkon Këshillin e Ministrave që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 të këtij ligji.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 23 Strehimi i organizuar

3. Përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar u jepet një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Personat, që kanë dëshirë të përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike të strehimit të organizuar, kundrejt një tarife.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 51 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 29; 8, pika 5; 15, pika 5; 23, pika 3; 24, pika 5; 29, pika 5; 32, pika 2; 34, pika 4; 39, pikat 1 dhe 2; 42, pika 1; 43, pika 4; 46, pika 2; 47, pika 4; dhe 48, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, pika 3; dhe 34, pika 5, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk kanë dalë aktet nënligjore që rregullojnë shpenzimet personale dhe tarifat e shërbimit për personat që janë rezidentë në shtëpitë e të moshuarve, në mospërputhje me nenin 23 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në mungesë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, institucioni ka zbatuar aktet nënligjore në fuqi dhe çdo muaj ka llogaritur dhe derdhur në thesar të ardhurat e mbledhura nga pensionistet rezident ne masën 40% të pensionit mujor.

Pas vendosjes dhe përfitimit në institucionin rezidenciale publike institucionet rezidenciale publike për të moshuarit rezident që gëzojnë të ardhura pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, duhet të derdhin në buxhet 40 % të pensionit, sipas kriterëve të VKM Nr. 114, datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, ndryshuar me VKM nr. 840, datë 3.12.2014)

Aktet nënligjore në fuqi, që rregullojnë strehimin e organizuar janë VKM nr. 114, datë 31.1.2007 dhe VKM nr. 840, datë 3.12.2014 të cilat në vite kanë bërë ndryshime si paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Ishte	Behet
VKM Nr. 114 ³ , datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”	VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”

³ VKM nr.114, datë 31.1.2007 botuar në Fletoren Zyrtare nr.29/2007; VKM nr.840, datë 3.12.2014 botuar në Fletoren Zyrtare nr.190/2014.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Pika 2: Personat, që kanë të ardhura, si pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, kur vendosen dhe përfitojnë shërbime të perkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike, derdhin 50 për qind të pensionit.	1. Në pikën 2 fjalët "... 50% të pensionit ..." zëvendësohen me "... 40 për qind të pensionit ...".
Pika 3, gërma ç: Personave të moshuar, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në shtëpitë rezidenciale publike, 4,000 (katër mijë) lekë në muaj	2. Në shkronjën "ç", të pikës 3, fjalët "... në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... në masën 6,000 (gjashtë mijë) lekë në muaj ...".

Grupi auditimit përzgjedhi për verifikim llogaritjen dhe arkëtimin e tarifës 40% si dhe të shpenzimet personale të përfituara nga të moshuarit për vitin 2021.

Nga auditimi mbështetur në dokumentacionin e arkës, kartelës së të moshuarit për derdhjen në buxhet të pjesës takuese të pensionit, lista e pensionistëve për masën e pensionit e derdhur për çdo muaj, rezultoi se:

1. Pensionisti/ja z. S.T rezident në institucion nuk ka të ardhura nga pensioni ose të ardhura të tjera të konsideruara të tilla nga ligji. Në kushtet e mungesës së të ardhurave institucioni ka paguar dhe i moshuari ka përfituar të ardhura mujore në shumën 6,000 leke, në përputhje me VKM nr. 840, datë 3.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190/2014.

2. Pensionisti/ja znj. L.L. rezident në institucion përfiton të ardhura nga pensioni në masën 5,525 lekë në muaj. Institucioni nuk ka mbajtur pjesën takuese të detyrimit të derdhjes në buxhet të të ardhurave nga pensioni, pasi ka konsideruar se të ardhurat janë nën 6,000 lekë në muaj. Në këndvështrim të pikës 2 të VKM nr. 840, datë 3.12.2014 të moshuarës duhet ti mbahej 40% të pensionit mujor ose 2,210 lekë, dhe nga pensioni mujor i mbeten 3,315 lekë, e cila është nën kufirin 6,000 lekë të përfitimit të të ardhurave në rast se nuk do të kishte pension pleqërie.

3. Pensionisti/ja z. E.K. rezident në institucion përfiton të ardhura nga pensioni në masën 7,664 lekë në muaj. Institucioni ka mbajtur pjesën takuese të detyrimit të derdhjes në buxhet të të ardhurave nga pensioni në shumën 1,600 lekë ose thënë ndryshe diferencën e pensionit mbi 6,000 leke. Në këndvështrim të pikës 2 të VKM nr. 840, datë 3.12.2014 të moshuarës duhet ti mbahej 40% të pensionit mujor ose 3,066 lekë dhe nga pensioni mujor shuma e mbetur rezulton 4,598 lekë, e cila është nën kufirin 6,000 lekë të përfitimit të të ardhurave në rast se nuk do të kishte pension pleqërie.

4. Pensionisti/ja z. E.S. rezident në institucion përfiton të ardhura nga pensioni në masën 7,830 lekë në muaj. Institucioni ka mbajtur pjesën takuese të detyrimit të derdhjes në buxhet të të ardhurave nga pensioni në shumën 1,800 lekë, ose thënë ndryshe diferencën e pensionit mbi 6,000 leke. Në këndvështrim të pikës 2 të VKM nr. 840, datë 3.12.2014 të moshuarës duhet ti mbahej 40% të pensionit mujor ose 3,132 lekë, dhe shuma e mbetur mujore rezulton 4,698 ose nën kufirin 6,000 lekë të përfitimit të të ardhurave në rast se nuk do të kishte pension pleqërie.

5. Pas derdhjes së pjesës takuese të detyrimit të derdhjes në buxhet të të ardhurave nga pensioni, pjesa e mbetur e pensionit mujor për znj. D. M. rezulton 6,733 lekë/muaj, znj. F.T. rezulton 6,294 lekë/ muaj, z. A.D. rezulton 6,668 lekë/muaj, znj. S.L i mbeten 6,184 lekë/muaj.

Llogaritja dhe derdhja e tarifës së pensionit

Nr.	Emër	Mbiemër	Pension mujor	40%	Detyrimi për tu derdhur	Pjesa e mbetur	Pa të ardhura
1	S.	T.	-	0.40	-	-	6,000
2	L.	L.	5,525	0.40	2,210	3,315	
3	E.	K.	7,664	0.40	3,066	4,598	
4	E.	S.	7,830	0.40	3,132	4,698	
5	D.	M.	11,221	0.40	4,488	6,733	

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

6	F.	T.	10,490	0.40	4,196	6,294	
7	A.	D.	11,114	0.40	4,446	6,668	
8	S.	L.	10,307	0.40	4,123	6,184	

(Burimi: SHM Tiranë Punoi : KLSH)

Nga auditimi rezultoi se:

1. Mungon nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në mungesë daljes së akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, institucioni rezidencial për të moshuar ka zbatuar aktet nënligjore në fuqi duke llogaritur dhe derdhur çdo muaj në thesar të ardhurat e mbledhura nga pensionistet rezident ne masën 40% të pensionit mujor, sipas kriterëve të VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”

2. Nga auditimit rezultoi se të moshuarit L.L.; E.K; E.S të vendosur në institucionet rezidenciale publike, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor rezulton më pak se 6,000 lekë/muaj ose me pak se kuota 6,000 leke/muaj, që ata do të përfitonin në rast se të moshuarit nuk do të gëzonin pension pleqërie ose të ardhura të tjera sipas kriterëve VKM nr. 840, datë 3.12.2014. Ndërsa për të moshuarit D.M; F.T.;A.D.; S.L pjesa e mbetur e pensionit mujor rezultoi në kufijtë e kuotës 6,000 lekë/muaj ose pothuaj e barabartë me të njëjtën shumë që ata do të përfitonin në rast se nuk do të gëzonin pension pleqërie, duke zhvlerësuar punën dhe mundin e tyre në vite.

Sa më sipër rezulton se VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, për grupet, pagesat dhe përfitimet e personave të vendosur në institucionet rezidenciale publike paraqet paqartësi në pagesat e tarifës 40 % të pensionit mujor, pasi pjesa e mbetur e pensionit të pleqërisë ka rezultuar më pak se kuota 6,000 lekë/muaj përcaktuar si kufi minimal për shpenzime vetjake të nevojshme për tu përfituar nga të moshuarit pa të ardhura nga pensioni ose të ardhura të tjera personale sipas VKM nr. 840, datë 3.12.2014, duke cënuar parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, përcaktuar në Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 gërma “e”.

Ligjit Nr. 121/2016

Neni 4

e) *Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.*

Zbatimi i buxhetit për shpenzimet:

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor e progresiv për çdo muaj deri në dhjetor të vitit kalendarik. Një kopje e situacionet dërgohet çdo muaj në SHSSH. Regjistrimi shpenzimeve behet sipas urdhër pagesës dhe sipas rendit kronologjik.

Për vitet 2020-2021-2022, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore llogaria 600, llogaria 601 dhe llogaria 602, kemi këtë situatë:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore (ne mije leke)

N/Art	Emërtimi i Shpenzimeve	Plani 2020	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	Plani 2022	Fakti 2022
	Shpenzime gjithsej	29,460	29,095	27,880	27,643	28,165	28,430
600	Paga, Shpërblime e të tjera shpenzime personeli	13,225	12,930	12,030	11,823	12,435	12,366
601	Kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,235	2,173	2,050	2,025	2,080	2,080
602	Shpenzime Operative	14,000	13,992	13,800	13,795	13,650	13,649
606	Kompensime speciale të tjera	-	-	-	-	-	335



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore

(ne mije leke)

N/Art	Emërtimi i Shpenzimeve	Plani 2020	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	Plani 2022	Fakti 2022
	II. Shpenzime Total	29,460	29,095	27,880	27,643	28,165	28,430
600	Paga, Shpërblime e të tjera shpenzime personeli	13,225	12,930	12,030	11,823	12,435	10,102
601	Kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,235	2,173	2,050	2,025	2,080	2,080
60101	Kontributi për sigurime shoqërore		1,947	-	1,814	1,827	1,983
60111	Kontributi për sigurime shëndetësore		226	-	211	203	97
	Shpenzime Operative	14,000	13,992	13,800	13,795	13,650	13,649
6020	Materiale dhe Shërbime të përgjithshme	1,705	1,705	1,310	1,310	1,263	1,263
60201	Kancelari (Shërbim printimi dhe fotokopimi)	120	120	108	108	101	101
60202	Materiale për pastrim, disinfektim, ngrohje dhe ndriçim	1,248	1,248	966	966	924	924
60203	Materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës	119	119	119	119	120	120
60204	Materiale për funksionimin e paisjeve speciale	99	99	117	117	119	119
60209	Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme	119	119	-	-	-	-
6021	Materiale dhe Shërbime sociale	7,059	7,052	6,608	6,605	6,060	6,059
6021001	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	237	237	-	-	119	119
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekësore	534	534	642	642	624	624
6021004	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencent	5,063	5,063	5,374	5,374	4,761	4,761
6021008	Materiale për mbrojtjen e tokës, bimëve dhe kafshëve nga sëmundjet	112	112	63	63	-	-
6021011	Softe informatike me karaktere të përgjithshme	-	-	-	-	119	119
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	1,112	1,106	529	526	437	437
6022	Shërbime nga të tretët	2,910	2,910	3,815	3,815	3,801	3,801
6022001	Elektriciteti	2,314	2,314	2,109	2,109	2,195	2,195
6022002	Ujë	148	148	1,222	1,222	1,171	1,171
6022003	Shërbime telefonike	140	140	6	6	23	23
6022005	Shërbim për ngrohje dhe gatim	117	117	117	117	172	172
6022007	Shërbime bankare	1	0	1	1	1	1
6022009	Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	-	-	120	120	-	-
6022099	Shërbime të tjera berber	192	192	240	240	240	240
6023	Shpenzime transporti	1,635	1,635	1,122	1,122	1,201	1,200
60231	Karburant dhe vaj makine	396	396	264	264	-	-
60232	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri (Nafte kaldaja)	1,239	1,239	858	858	1,201	1,200
6025	Shpenzime për mirëmbajtjen të zakonshme	619	618	872	871	789	789
6025	Shpenzim për mirëmbajtjen e objekteve speciale	120	119	120	119	113	113
60252	Shpenzim për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	379	379	633	633	556	556
60258	Shpenzime mirëmbajtje ashensor	120	120	120	120	120	120
6027	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	72	72	-	-	-	-
60279	Shpenzime për kompensime të tjera të papaguara	72	72	-	-	-	-
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	-	-	72	72	72	72
60281	Shpenzime për kuota që rrjedhin nga detyrimet	-	-	72	72	72	72
6029	Shpenzime të tjera operative	-	-	-	-	464	464
6029003	Shpenzime gjyqësore	-	-	-	-	464	464
6061005	Kompensime speciale të tjera	-	-	-	-	335	335

(Burimi : SHM Tirane, situacion progresiv shpenzimesh)

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore shoqërohen me dokument justifikues si liste pagesa e firmosur nga NZ dhe NA dhe punonjësi Degës së Thesarit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë në shumën 14,446 mijë lekë dhe zënë rreth 50.81% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Shpenzimet operative shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, fature blerje, flete hyrje ne magazine, urdhër prokurimi, kontrate furnizimi, proces verbal, etj. Në strukture shpenzimet operative janë në shumën 13,649 mijë lekë dhe zënë 48.01% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

- Shpenzime për materiale dhe shërbime të përgjithshme janë në shumën 1,263 mijë lekë dhe zënë rreth 9.25% të shpenzimeve operative, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, flete hyrje ne magazine, etj

- Shpenzime për materiale dhe shërbime sociale janë realizuar ne shumën 6,605 mijë lekë dhe zënë rreth 48.39% të shpenzimeve operative, dhe këtu përfshihen shpenzimet për furnizim me ushqim, medikamente për të moshuarit, etj, mbështet ne dokumentacion vërtetues si: kontrata e shpallur fituese me OK, fature tatimore shitje, flete hyrje në magazine, etj.

- Shpenzime nga të trete janë në shumën 3,801 mijë lekë zënë rreth 27.85% të shpenzimeve korrente. Shpenzimet përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes se sigurisë shërbim pastrim dhe gjelbërim, shërbime te tjera ku përfshihen pagesat për të moshuarit rezidente qe nuk kanë të ardhura personale, etj. Shpenzimet bazohen ne urdhër shpenzim, fature shitje, urdhër prokurimi, kontrate shërbimi, etj

- Shpenzime transport janë në shumën 1,200 mijë lekë dhe zënë rreth 8.79% të shpenzimeve korrente, paraqesin shpenzime janë shpenzime për naftë për kaldajën e institucionit

- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme janë në shumën 789 mijë lekë dhe zënë rreth 5.78% të shpenzimeve korrente. Shpenzimet përfshijnë pagesa për shpenzime për mirëmbajtje ashensori dhe shpenzime për mirëmbajtje objekti.

- Shpenzime të lidhura me huamarrjen realizuar në shumën 72 mijë lekë, janë shpenzime për përfitim individual për një 1(një) të moshuar, pasi personi nuk ka asnjë burim të ardhurash personale.

- Te tjera shpenzime operative janë realizuar në shumën 464 mijë lekë dhe zënë rreth 3.40% të shpenzimeve korrente janë për pagesa për shpenzime gjyqësore per ekzekutim vendim gjykate nr. 3350 date 02.04.2013.

Transfertë për buxhete familjare dhe individët të paguara nga institucioni (llog 606), praqet pagesa për zbatimin e VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”, për shpenzime për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve për zbutjen e krizës, duke shtuar fondet për shpenzime operative në shumën 335 mijë lekë dhe zënë 1.18% të shpenzimeve operative

Titullari i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë ka raportuar pranë shërbimit Social Shtetëror mbi funksionimin e institucionit rezidencial, për vitin 2020 me shkresë nr. 60 prot, datë 02.02.2021 për vitin 2021 me shkresë nr. 99 prot, datë 28.01.2022 dhe për vitin 2022 me shkresë nr. 15 prot, datë 16.01.2023, konform Rregullores së Brendshme të organizimit dhe Funksionimit të Institucioneve Rezidenciale për të Moshuar, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH me shkresë nr. 2712/7 prot, datë 31.12.2015.

Konkluzion: Nga auditimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë për parashikimin dhe zbatimin e buxhetit u konstatua se MSHMS dhe Shërbimi Social Shtetëror në miratimin e PBA 2020 - 2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 nuk kanë vlerësuar kostot e projektit te investimeve për shpenzime kapitale për njësinë shpenzuese Shtëpia e të Moshuarve Tiranë për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total në shumën 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1,728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m2 me kosto 10,000 leke/m2 llogaritur me kosto investimi 3,020 mije lekë;blerje “frigoriferë ” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë leke,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për te moshuarit ne qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj” duke ndikuar në cilësinë e jetesës së të moshuarve në këtë institucion rezidencial.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

- 1.znj. R. X. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror.
- 2.znj. A. P. në cilësinë e NA të institucionit.
- 3.znj. E. T. në cilësinë e NZ të institucionit

Titulli i Gjetjes:	Mungese e daljes se akteve nënligjore në zbatim te Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
Situata	<p>1. Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 51 pika 1 ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 23, pika 3; nenit 46, pika 2 të këtij ligji për shpenzime personale, që ju jepen përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar. Neni 51 pika 3 ka ngarkuar ministrin përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë Udhëzim të Përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, në zbatim të 46, pika 3, të këtij ligji, për tarifën e shërbimeve publike të financuara nga buxheti i shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23.</p> <p>Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ne nenin 23 pika 4 ka përcaktuar se personat që përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike <u>kundrejt pagesës së një tarife të cilat sipas nenit 46 pika 3 kërkon nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministrit të Financave .</u></p> <p>Nga auditimi rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ne shkelje të afateve ligjore të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë plotësisht pagesat e tarifave e shërbimit dhe përfitimin e shpenzimeve personale për personat rezidentë në shtëpitë e të moshuarve, në mospërputhje me nenin 23 pika 3 dhe neni 23 pika 4 dhe neni 46 pika 3 gërma “a” të këtij ligji.</p> <p><u>Në mungesë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 dhe nenit 46 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, institucioni/et kanë zbatuar aktet nënligjore në fuqi duke llogaritur dhe derdhur çdo muaj në thesar të ardhurat e mbledhura nga të moshuarit rezident 40% të pensionit mujor sipas dispozitave te VKM nr. 840, datë 3.12.2014 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”.</u></p>
Kriteri:	Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 gërma “e” VKM nr. 840, datë 3.12.2014 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Ndikimi/Efekti:	Mungesa e daljes së Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Ministrit të Financave, ka ndikuar si në arkëtimet e tarifave të shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit ashtu dhe në te ardhurat personale për çdo të moshuar, për kontributet paguara nga përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 23.4 dhe 46.3.a,
Shkaku:	Mungesa e daljes së akteve nënligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat e duhura për plotësimin e kuadrit nënligjor të funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke hartuar dhe propozuar akte ligjore e nënligjore për zbatimin të nenit 23.3 dhe nenit 23.4 dhe nenit 46 pika 2 dhe të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.

Titulli i Gjetjes:	Mungese rregullash për t’u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte, nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në institucione rezidenciale publike
Situata	Nga auditimit rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në tre raste për të moshuarit e vendosur në institucionin rezidenciale publike, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor rezulton më pak se 6,000 lekë/muaj ose me pak se kuota 6,000 leke/muaj, që ata do të përfitonin sipas kriterëve VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Kreu V, paragrafi 68, germa “a” në rast se të moshuarit nuk do të gëzonin pension pleqërie. Ndërsa në katër raste pjesa e mbetur e pensionit mujor rezultoi në kufijtë e kuotës 6,000 lekë në muaj ose pothuajse e barabartë me të njëjtën shumë që ata do të përfitonin në rast se nuk do të gëzonin pension pleqërie.
Kriteri:	Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 germa “e”. VKM nr. 840, datë 3.12.2014/2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”.
Ndikimi/Efekti:	Pas mbajtjes dhe derdhjes në buxhet i tarifës 40% të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit të pleqërisë ose pensioni social rezulton me pak se 6000 lekë në muaj përcaktuar si minimum për shpërbllim personal mujor që përfiton i moshuari pa pension pleqërie ose të ardhura të tjera,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	sipas VKM nr. 840, datë 3.12.2014 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”.
Shkaku:	Mungesa e daljes së akteve nënligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Shërbimi Social Shtetëror të marrë masat e nevojshme duke ofruar sistem të unifikuar rregullash për t’u zbatuar në aplikimin e tarifave që paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror në qendrat e shërbimit rezidencial për të moshuar, deri në miratimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesave të nenit 51.1 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mos vlerësimi nga institucionet përgjegjëse në plan buxhetin e vitit 2020, 2021 dhe 2022 i kërkesave për shpenzime kapitale për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara</i>
Situata	Në dërgimin e plan buxhetit të vitit 2020, vitit 2021 dhe vitit 2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror në miratimin e PBA 2020 -2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 nuk kanë vlerësuar kostot e projektit të investimeve për shpenzime kapitale, duke ndikuar në cilësinë e jetesës së të moshuarve në institucionin rezidenciale të njësisë Shtëpina e të Moshuarve Tiranë për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total në shumën 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1,728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m ² me kosto 10,000 leke/m ² llogaritur me kosto investimi 3,020 mijë lekë; blerje “frigoriferë ” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë leke, në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”.
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme”, kreu 7.
Ndikimi/Efekti:	Mos miratimi i fondeve për investime në qendrën rezidenciale për ndikon në cilësinë e jetesës së të moshuarve në këtë institucionet rezidenciale, sipas Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”.
Shkaku:	Mos miratimi nga institucionet përgjegjëse i fondeve për investime në PBA 2020-2022; PBA 2021-2023; PBA 2022-2024 i shumës së fondeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	për investime të klasifikuara në llogarinë 231, pa vlerësuar shkallën e domosdoshmërisë së tyre.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Shërbimin Social Shtetëror në bashkëpunim me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, përpara dërgimit të projekt buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesave për zërin “Investime” në llogarinë 231, në përmbushje të Standardit 10 “ <i>Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj</i> ”, duke rritur cilësinë së jetesës së të moshuarve në këto institucione rezidenciale.

Drejtimi 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

- Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin;
- Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna;
- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave;

A. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura Organizative

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është institucion rezidencial publik dhe ofron shërbim 24 orë për të moshuar, funksionon në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara në legjislacionin për sistemin e mbrojtjes shoqërore dhe udhëzimeve përkatëse në zbatim të tij.

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është një institucion rezidencial kombëtar në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Ofrimi i shërbimeve rezidenciale bazohet në vlerësimin multidisiplinar të nevojave të tyre, duke siguruar punën në ekip të personelit për sigurinë dhe mbrojtjen e të moshuarve. Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është një institucion rezidencial kombëtar në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Organika dhe struktura e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë është përcaktuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 88, datë 25.10.2011, ndryshuar me urdhër nr. 101, datë 13.07.2015.


Shtëpia e të Moshuarve Tiranë funksionon në bazë të Ligjit Nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”; VKM Nr. 47, datë 22.1.2020 “*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore*”; VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 “*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore*”; VKM NR. 35, datë 19.1.2022 “*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore*”

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Shtëpia e të Moshuarve Tiranë bazuar në organigramën miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror*”, ndryshuar me Urdhër nr. 101, datë 13.07.2015, ka kryer funksionet e saj me 15 punonjës me kohë të plotë. Sipas kësaj strukture, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është organizuar mbi bazën e 2 sektorëve të varur direkt nga Drejtori i Institucionit, përkatësisht Sektori i Shërbimit Social dhe Sektori i Administratës. Edhe pas ndryshimeve në Urdhërin e Kryeministrit (të fundit me Urdhërin e KM nr. 101, datë 13.07.2015), numri total i punonjësve ka mbetur i pandryshuar për Shtëpia e të Moshuarve Tiranë. Organigrama e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë ka funksionuar si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË



Organigrama e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë

Në tabelën më poshtë paraqitet numri i punonjësve dhe pozicionet sipas organikës së miratuar:

Numri i punonjësve dhe pozicionet sipas organikës së miratuar

Nr. rend	Pozicioni	Kategoria	Struktura e miratuar
I	Drejtor institucioni	III-b	1
II	Sektori Shërbimit Social		9
	Përgjegjës Sektori (Punonjës social)	IV-a	1
	Specialist (Psikolog)	IV-b	1
	Kujdestar	VIII	7
III	Sektori Administratës		5
	Përgjegjës Sektori	IV-a	1
	Kuzhinier	VI	2
	Pastrues	I/II	2
	Punonjës me Kontratë të Përhershme		15

Nga auditimi dokumentacionit të listë pagesave të pagave, kohëshënuesit për kohën e punës të hartuara nga përgjegjëset e sektorëve dhe miratuar nga titulluari, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se Shtëpia e të Moshuarve Tiranë ka respektuar strukturën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”, ndryshuar me Urdhër nr. 101, datë 13.07.2015, si në total dhe pozicione pune.

Në zbatim të VKM nr. 47, datë 22.01.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore” dhe VKM nr. 1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 35, datë 19.1.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”, e ndryshuar.

VKM e sipërcituara kanë miratuar numrin e punonjësve me kontrate të përkohshme dhe Shërbimi Social Shtetëror me shkresa përkatëse ka emëruar në detyrë për punësim me kohë të pjesshme në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë për vitin 2020 për 8 punonjës, për vitin 2021 për 8 punonjës dhe për vitin 2022 për 9 punonjës për pozicione dhe kohe të pjesshme punësimi.

Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme sipas VKM

	Punonjësve me kontratë të përkohshme	2020	2021	2022
	Mjek (4 orë/ditë)	1	1	1
	Sanitar (4 orë/ditë)	1	1	1
	Kujdestar (4 orë/ditë)	5	5	3
	Kujdestar (6 orë/ditë)	0	0	2
	Ndihmëskuzhinier (4 orë/ditë)	1	1	0
	Ndihmëskuzhinier (6 orë/ditë)	0	0	2
	Totali	8	8	9

Në Nenin 52, pika 1të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet që brenda dy vitesh nga hyrja e këtij ligji të gjitha qendrat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale t'i transferohej njësisë të qeverisjes vendore. Nga auditimi rezultoi se institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë marrë masa për realizimin e transferimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë në vartësi njësisë së qeverisjes vendore. Si rrjedhojë institucioni rezidencial i vazhdon të funksionojë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 52, pika 1 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ligjit nr. 121/2016

Neni 52 Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.

Titulli i gjetjes	Mos transferimi i institucioneve rezidenciale për të moshuar në njësitë e qeverisjes vendore
Situata:	Institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e transferimit të institucioneve rezidenciale për të moshuar në njësitë e qeverisjes vendore. Për pasojë Shtëpia të Moshuarve Tiranë vazhdon të funksionojë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 52, pika 1 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
Kriteri:	<i>Ligjit nr. 121/2016, Neni 52 Dispozita kalimtare dhe të fundit Pika 1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.</i>
Ndikimi/Efekti:	Strehimi organizuar është shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor (neni 23 i ligjit 121/2016). Mos transferimi në njësitë e qeverisjes vendore ndikon në burimin e fondeve të financimit për shërbimet e kujdesit shoqëror nga institucionet publike (fonde buxhetore ose fonde të njësisë të qeverisjes vendore)
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin dhe përgjegjësinë e organit publik të ngarkuar me ligj për hartimin e dokumenteve dhe politikave të reformimit e modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 52, të marrë masat e nevojshme që të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale tu transferohen njësisë të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve.

B. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune. Zbatimi i vendimeve të gjykatave.

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen në Shërbimin Social Shtetëror, i cili është përgjegjës edhe për rekrutimin e stafit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Sektori i Administratës në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë mban një kopje të dosjeve të stafit.

Dosjet e personelit duhet të administrohen në përputhje me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” pika I.1, ku përcaktohet se:

VKM nr. 833, datë 28.10.2020

1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.

Sa i përket dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e të punësuarve, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Lidhja 1 ka përcaktuar se dosja e personelit duhet të përfshijë::

Dosja e të punësuarit sipas VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Lidhja 1

1. Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit,.
2. Fletë inventari i dosjes së të punësuarit
3. Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon:
 - a) fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë);
 - b) certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare;
 - c) dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - ç) listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - d) dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë.
 - dh) certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës;
 - e) dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja;
 - ë) akti i emërimit në pozicionin e punës;
 - f) akti i dhënies së masës disiplinore;
 - g) librezë e punës;
 - gj)raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë.
4. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016, dërguar për zbatim nga Shërbimi Social Shtetëror me shkresë nr. 1570 prot, datë 07.07.2016, përcakton rregullat e funksionimit të këtij institucioni rezidencial, sipas organikes se miratuar me VKM Nr. 101, datë 27.07.2015, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”.

Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, në paragrafin e detyrave të Drejtorit të institucionit, përcakton se Drejtori me urdhër të brendshëm cakton detyrat e çdo punonjësi dhe një kopje e përkrahimit të detyrave e firmosur nga punonjësi vihet ne dosjen personale (Pika 6) dhe vlerëson performancën e punonjësve një herë në vit (Pika 13).

Nga auditimi u konstatua se në dosjen e punonjësve mungonte “Përkrahimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, veprim në mospërputhje me Kontratën e Punës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Individuale sipas të cilës punëmarrësit ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6) dhe Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).

Rregullore e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016

Drejtori.

6.Me urdhër të brendshëm cakton detyrat e çdo punonjësi dhe një kopje të përshkrimit të detyrave e firmosur nga punonjësi vihet në dosjen personale

Kontratë Individuale e Punës (formati SHSSH)

Neni 6 Përshkrimi vendit të punës

Përshkrimi i vendit të punës dhe i detyrave të punëmarrësit bëhet sipas dispozitave të rregullores së brendshme të institucionit

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 15 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi. Nga auditimi nuk u konstatuar parregullsi në mbajtjen e dosjeve të personelit. Ato janë mbajtur konform Rregullores së Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Tirane dhe dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e të punësuarve, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Lidhja 1

Marrëdhëniet e Punës

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të SHFSH-së rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, VKM nr. 511, atë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Institucionit, e ndryshuar, Udhëzimet dhe Urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor që përmban dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet e punës në RSH.

Kontratat e punës

Grupi i auditimit ka përzgjedhur 15 Kontrata Individuale të Punës të punonjësve pjesë e strukturës së SHMT të lidhura ndërmjet punonjësve dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Nga auditimit u konstatua në shqyrtimin e elementëve që duhet të kontratës se Kontrata Individuale e Punës nuk përmbante *Kontratës Kolektive në Fuqi, në mospërputhje me Kodin e Punës neni 21 pika 3 gërma “j”*, sipas të cilës *kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive në fuqi.*

Emërimet

*Procedura e punësimit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në linjë me VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” dhe Udhëzimet/Urdhërat e Ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Punonjësit e institucionit rezidencial për të moshuar emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social sipas VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, e ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 13.1.2022, pika 5 dhe Rregullore e Brendshme, neni 3.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë emëruar gjithsej 10 punonjës, nga të cilët me kohë të plotë 2 kujdestarë dhe 8 punonjës me kohë të pjesshme në përputhje me VKM Nr. 47, datë 22.1.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar.

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë emëruar gjithsej 9 punonjës, nga të cilët me kohë të plotë 1 Përgjegjës Sektori Social dhe 8 punonjës me kohë të pjesshme në përputhje me VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

ndryshuar.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë emëruar gjithsej 11 punonjës, nga të cilët me kohë të plotë 1 Psikolog, 1 Kujdestar dhe 9 punonjës me kohë të pjesshme në përputhje me VKM Nr. 35, datë 19.1.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 42 përcakton se ministria përgjegjëse për çështjet sociale (sot MSHMS) krijon një program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur “Programi i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror”. Ky program funksionon si një sistem me cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që t’i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 42 të ligjit.

Këshilli i Ministrave me propozim të MSHMS në zbatim të ligjit nr. 121/2016, ka miratuar VKM nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”. Pika 3 e këtij vendimi përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Procesi i certifikimit ndahet në cikle 5-vjeçare, profesionistët e shërbimeve shoqërore duhet të marrin një numër minimal kreditesh çdo vit.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit të institucionit, u konstatua se personeli në SHM Tiranë (*punonjës social, psikolog*) nuk ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit, pasi nuk është ofruar asnjë i tillë. Nuk është realizuar zbatimit të procesit të certifikimit sipas ligjit nr. 121/2016, kjo për faktorë jashtë institucionit me pasojë në procesin e rekrutimit, i cili ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror.

Largimet

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 1 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Dorëheqje	1
Mosparaqitje në punë	0
Dalje në pension	0
Emërim i përkohshëm/transferim	0
Totali	1

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 1 punonjës, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Dorëheqje	1
Mosparaqitje në punë	0
Dalje në pension	0
Emërim i përkohshëm/transferim	0
Totali	1

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 5 punonjës, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
---------	------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Dorëheqje	4
Mosparaqitje në punë	0
Dalje në pension	0
Lirim/transferim	1
Totali	5

Vendimet gjyqësore

Sa i takon marrëdhënieve të punës nuk ka asnjë çështje gjyqësore në proces gjykimi apo vendime të formës së prerë në Gjykatën Administrative, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 – 31.12.2022.

C. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.

Marrëdhëniet e pagave

Administrata ka përlllogaritur saktë pagën e punonjësve të administratës në përputhje me kriteret e VKM nr. 187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, e ndryshuar.

Vlera e pagës së grupit për pozicionin e punës *drejtor dhe përgjegjës sektori*, mbështet në diplomën e arsimit universitar duke kategorizuar pagën baze sipas llojit të diplomës në grupin 1 vlera 14.000 lekë (lidhja nr. 2).

Shtesa për vjetërsi llogaritet 2% mbi pagën baze deri në 25 vite pune dhe shtesë pozicioni për kategorinë III-b 61.000 lekë/ muaj (titullari), për kategorinë IV-a shtesë pozicioni 46.000 lekë në muaj (përgjegjës sektori) dhe kategorinë IV-b (punonjës social) 38.000 lekë në muaj (lidhja nr. 2)

Administrata ka përlllogaritur saktë pagën e punonjësve mbështetës në përputhje me kriteret e VKM Nr.717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, të cilët nuk trajtohen në pagë me strukturën e pagave të nëpunësve të shërbimit civil, sipas kategorizimit të niveleve të pagave për klasë të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

Pagat e punonjësve mbështetës caktohen sipas lidhjeve nr. II duke klasifikuar sanitar në kategorinë I me pagë bazë 30.000 lekë/ muaj, kuzhinier në kategorinë VI me pagë bazë 35.400 lekë/muaj dhe kujdestar në kategorinë VIII me pagë bazë 35.400 lekë në muaj.

Punonjësve mbështetës u jepet shtesë për vjetërsi pune, në masën 1 për qind mbi pagën bazë për klasë, por jo më shumë se 25 % në përputhje me VKM 717/2009, pika 7 .

Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve, pagat e të cilëve caktohen, sipas lidhjeve nr. I e nr. u jepen shtesa mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, për kujdestar, kuzhinier klasifikuar në shkallën e dytë, në masën 4005 lekë në muaj dhe sanitar klasifikuar në shkallën e tretë, në masën lekë në muaj.

Grupi auditimit me zgjedhje auditoi listë pagesat e muajve Maj, Qershor, Korrik 2020; Janar, Shkurt, Mars 2021 dhe Tetor, Nëntor, Dhjetor 2022.

Pas auditimit të dokumentacionit (përmbledhëseve mujore të listë pagesave të punonjësve; borderotë e pagave), fondi i pagave jepet në tabelën e mëposhtme:

Pagat neto për punonjësit e Shtëpisë së të moshuarve Tirane (në lekë)

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Janar	800,416	840,074	786,850
Shkurt	792,723	826,437	861,489
Mars	954,662	838,196	864,571
Prill	981,549	833,814	881,116



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Maj	1,048,068	838,026	896,290
Qershor	918,190	829,315	872,956
Korrik	936,052	834,532	871,775
Gusht	960,425	825,393	868,535
Shtator	831,966	816,428	897,552
Tetor	832,425	808,499	910,754
Nëntor	873,104	767,433	920,316
Dhjetor	800,352	773,337	924,082
TOTALI	10,729,932	9,831,484	10,556,286

Në kushtet e pandemisë në vitin 2020, Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 531/4 prot, datë 14.05.2020, ka përcjellë shkresën e MFE nr. 6858/1 prot, datë 28.04.2020, më të cilën ka miratuar pagesën e punonjësve të izoluar në ambientet e institucionit Shërbimi Social Shtetëror, referuar në Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave” për punonjësit e institucioneve të përkujdesit social dhe VKM 511 datë 24.10.2022 “për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, pika 5. Gjatë vitit 2020 pagesa e orëve shtese të kryera jashtë kohës normale për punonjësit e institucionit rezidencial, nuk ka tejkaluar 200 ore punë, konform Kodit të Punës. Nga auditimi me zgjedhje i liste pagesave rezultoi se janë shoqëruar me listë prezencat në punë, të nënshkruara nga Përgjegjësja e Sektorit të Administratës, Përgjegjësja e Sektorit të Shërbimit Social si dhe Drejtoresha e institucionit.

Nga auditimi i listë pagesave nuk u konstatuan parregullsi në përllogaritjet dhe dhënien e pagave referuar bazës ligjore në fuqi.

Lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat është zbatuar drejt ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, nga auditimi i listë pagesave nuk u konstatuan parregullsi në llogaritjen dhe pagesën e sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale, referuar bazës ligjore në fuqi.

Shpërblimet

Shërbimi Social Shtetëror me shkresë nr. 928/1 prot, datë 30.01.2023 mbështetur në shkresën e MFE nr. 24043/33 prot, datë 11.01.2023, miratuar nga MSHMS me nr. 396 prot, datë 24.01.2023 ka transferuar fondet për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbatimin e krizës, sipas përcaktimeve të VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbatimin e impaktit të krizës”.

Shkresa e MFE nr. 24043/33 prot, datë 11.01.2023 ka detajuar fondet për mbështetje financiare të punonjësve për zbatimin e VKM 898/2022 duke shtuar fondet për Shtëpinë e të Moshuarve Tirane duke çelur fonde në degën e thesarit në llogarinë 606 në shumën 335.000 lekë.

Spektori administratës ka hartuar listat e përfituesve të mbështetjes financiare për punonjësit e institucionit në total 335.000 lekë, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbatimin e impaktit të krizës”.

Gjatë periudhës së audituar punonjësit e institucionit nuk kanë përfituruar shpërblime të tjera për rezultate në punë.

Realizmi i fondit të pagave.

Për vitin 2020 për shpenzime për paga dhe shpërblime nga buxheti i shtetit u alokuan 13.225 mijë lekë dhe u realizuan në shumën 12.930 mijë lekë ose në masën 97.78%. Për vitin 2021 u alokuan 12,030 mijë lekë dhe fondi i pagave u realizua 11,823 mijë lekë ose 98.25%. Në vitin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

buxhetor 2022 nga buxheti u alokuan 12.435 mijë lekë dhe fondi pagave u realizua 12,366 mijë lekë ose 99.45%, paraqitur në tabelën si më poshtë vijon:

Fodi pagave dhe realizimi (mijë lekë)

Viti	Art.	Emërtimi i Shpenzimeve	Plani Vjetor	Fakti Progresiv	Realizimi (%)
2020	600	Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli	13.225	12.930	97.78%
2021	600	Paga, Shpërblime e të tjera shpenzime personeli	12.030	11.823	98.25%
2022	600	Paga, Shpërblime e të tjera shpenzime personeli	12.435	12.366	99.45%

(Burimi: SHMTirane)

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

znj. A. P. në cilësinë e NA të institucionit.

znj. E. T. në cilesinë e NZ të institucionit

Titulli i gjetjes	Mangësi në dosjen personale të punonjësve të institucionit
Situata:	Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë se në dosjet e punonjësve mungonte “Përshkrimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, veprim në mospërputhje me Kontratën e Punës Individuale sipas të cilës punëmarrës ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6) dhe Rregulloren e Brendshme e Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).
Kriteri:	VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në dosjet e personelit, përmbajtja e të cilave përcaktohet me VKM.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Titulli i gjetjes	Mos aplikimi i sistemit të krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror
Situata:	Dosjet e personelit të institucionit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë nuk përmbanin trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit për pozicionin e punës punonjës social, psikolog, pasi për faktorë jashtë institucionit nuk është realizuar zbatimi procesit të certifikimit sipas dispozitave të nenit 42 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” me pasojë në procesin e rekrutimit, i cili ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të perkujdesit shoqëror.
Kriteri:	Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”.
Ndikimi/Efekti:	Procesi i rekrutimit ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, në zbatim të ligjit nr. 121/2016, dhe VKM nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”, pika 3 e këtij vendimi, i cilin përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Drejtimi 3: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në lekë dhe valutë.
- Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera në magazinë
- Invetarizimi i pronës shtetërore

A) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në lekë dhe valutë.

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tyre, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Dokumentacioni i pagesave të bankës;
- Dokumentacioni i pagesave të arkës;
- Ditarët dhe llogaritë përkatëse;
- Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të furnizimeve;
- Dokumentacioni justifikues për pagesat e kryera etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

Auditimi u ushtrua me zgjedhje, konkretisht u audituan urdhër shpenzimet (shpenzimet me anë të bankës), të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, të kryera për llogari të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 në total 241 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerën totale prej 29,094,800 lekë; për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 në total 235 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerën totale prej 27,643,384 lekë dhe për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në total 253 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerën totale prej 28,430,214 lekë, të cilat rezultuan në përgjithësi se janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga personat urdhërues dhe zbatues, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohet qartë objekti i shpenzimit, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikuese.

Veprimet financiare si arkëtime dhe pagesa nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, kryhen nëpërmjet 2 bankave të nivelit të dytë.

Nga kryerja e disa sondazheve për shumat e kaluara nga thesari në total për paga shpenzime operative dhe investimeme totalin e librit të bankës dhe arkës nuk rezultuan diferenca. Pagesat janë kryer kryesisht për paga, shpenzime të ndryshme operative, blerje medikamente, paga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

punonjësish, shpenzime për ushqime, shpenzime për mirëmbajtjedhe detyrime kontraktuale, etj. Dokumentacioni i bankës është i plotësuar dhe veprimet janë pasqyruar kronologjikisht. Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues.

Prokurimet me vlerë të vogël, audituar nga banka

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit, bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin e APP Nr.5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurësmevlerëtëvogëldhezhvillimin e sajmemjeteelektronike”, si dhe çdo akt juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit., u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

-Regjistri i realizimeve dhe parashikimeve të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020-31.12.2022;

-Dokumentacioni mbi kryerjen e procedurave të prokurimit;

-Përlllogaritja e fondit limit;

-Realizimi i parimeve të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua:

Në vijim, në formë tabelare pasqyrohet informacionmbi realizimin e procedurave të auditimit (në numër dhe vlerë), për periudhën 01.01.2020-31.12.2022 nga ana e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranëdhe praktikave të përzgjedhura për auditim.

Realizimi procedurave të auditimit 2020-2022 (në lekë)

Viti	Të realizuara		Përzgjedhur për auditim	
	Numër	Vlerë pa tvsh	Numër	Vlerë pa tvsh
2020	32	5,946,034	11	3,280,534
2021	34	5,281,030	10	3,887,700
2022	22	4,233,200	8	2,106,000

(Burimi: Shtëpia e të moshuarve Tiranë)

Disa prej problematikave të konstatuara në procedurat për prokurim me vlerë të vogël:

1. Në të gjitha praktikave të zgjedhura për auditim konstatohet:

Në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas Ftesës për Ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit, në kundërshtim me pikën 17, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, sipas së cilit: “*Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*”

2.Procedura e prokurimit “Shërbim Ashensori” viti 2020-2022:

Shtëpia e të moshuarve Tiranë ka në pronësi të saj një ashensor i cili shërben për ngjitjen në godinë nga të moshuarit dhe stafi. Lidhur me këtë ashensor për tre vitet 2020-2022 është kryer procedura e prokurimit me objekt “Shërbim Ashensori”, i cili ka patur për qëllim shërbim mirëmbajtje ashensori, vajtje dhe kontroll periodik, shërbim dhe riparim kur ka defekt.

Fondi limit për këtë procedurë është 100.000 lekë. KPVV me anë të procesverbalit të mbajtur në datë 20.01.2020 ka pasqyruar testimin e tregut lidhur me këtë shërbim dhe ka renditur tre ofertat e marra nga operatorët “SH.” sh.p.k., “M.” sh.p.k. dhe “G.” sh.p.k., si dhe ka përzgjedhur si ofertë fituese, ofertën me cmimin më të ulët të ofruar, përkatësisht nga shoqëria “G.” sh.p.k. Bashkëlidhur praktikës dokumentare të kësaj procedure gjenden të administruara tre oferta nga operatorë pjesërisht të ndryshëm nga ato të pasyruar në procesverbal, përkatësisht nga: “D.” sh.p.k., “I.” sh.p.k. dhe “G.” sh.p.k., edhe pse vlerat e ofruara nuk ndikojnë në përzgjedhjen e operatorit fitues.



Operatori i shpallur fitues “G.” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e shërbimit me nr. 23 prot., datë 24.01.2020 përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. G.H., i cili në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka patur tagër administratori, pasi referuar informacionit të përcjellë nga gjendja e regjistrimit të shoqërisë “G.” sh.p.k. afati i emërimit i ka përfunduar në datën 03.07.2019. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata nr. 32 prot., datë 25.01.2022, në të cilën operatori është përfaqësuar nga z. G.H., i cili sërish ka vepruar në kundërshtim me tagrin ligjor, pasi administrator i shoqërisë në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë z. E.H.

Në të tre procedurat konstatohet se si kriter kualifikues është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, i cili figuron i njëjtë për të tre procedurat nuk konstatohet i depozituar vërtetimi i OSHEE për procedurën e vitit 2020 dhe 2021, në kundërshtim me pikën 7, udhëzimi nr. 3, datë 8.01.2018 “*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”, i ndryshuar, sipas së cilës “*Në raste specifike, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, në varësi të llojit të objektit të prokurimit, mund të kërkojë plotësimin e një ose disa kritereve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues*”.

Konstatohet se:

-Ashensori i vendosur nuk është regjistruar pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut pavarësisht që është marrë në dorëzim dhe kryen funksion rregullisht në godinë, në kundërshtim me pikën 4, tëVKM-së nr.1056, datë 23.12.2015 “Për Miratimin e Rregullit teknik “Për Sigurinë e Ashensorëve në përdorim”, i ndryshuar sipas së cilit “*4. Aplikimi për regjistrim 4.1 Çdo ashensor i ri ose ekzistues regjistrohet pranë Strukturës Përgjegjëse, siç referohet në nenin 16 të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011*” “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar. *Personi përgjegjës që bën regjistrimin e një ashensori të ri duhet gjithashtu të bashkëngjisë në formatin e regjistrimit dhe një kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.*”

-Gjatë periudhës së auditimit 2020-2022, Autoriteti Kontraktor nuk ka ndërmarrë asnjë masë për kontraktimin e një organi të miratuar për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorit me qëllim kontrollin e funksionimit të përshtatshëm të karakteristikave të sigurisë të ashensorit dhe zbuluar çdo defekt që mund të shfaqet/ndodhë gjatë përdorimit ose keq-përdorimit të ashensorit, veprim në kundërshtim me shkronjën d), pika 5.5, sipas së cilit “*Mbas ekzaminimit të parë të plotë të ashensorit, personi përgjegjës siguron Ashensori u nënshtrohet inspektimeve periodike, ndërmjet ekzaminimeve të plota të njëpasnjëshme, nga një organ i miratuar në intervale kohore, si janë përcaktuar në pikën 7 të këtij Rregulli Teknik.*”, si dhe në kundërshtim me pikën 24, neni 3, Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, sipas së cilit “*Personi përgjegjës i produktit/instalimit të vënë në shërbim për të tretët apo për publikun është titullari i së drejtës së pronësisë mbi produktin/instalimin, personi që ka në gëzim të përkohshëm produktin/instalimin, nëse ky i fundit ka detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së produktit/instalimit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në bazë të një marrëveshje me pronarin apo një akti administrativ, punëdhënësi për produktin/instalimin e vendosur në vendin punës.*”

1. PROCEDURA E PROKURIMIT “BLERJE MEDIKAMENTE” VITI 2020-2022:

A. Planifikimi dhe realizimi për prokurime me vlerë të vogël

Planifikimi i blerjes së medikamenteve dhe vlerat përkatëse janë evidentuar në regjistrin e parashikimeve me fond të llogaritur dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik, miratuar nga APP. Evidenca me të dhëna për planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit të barnave përpërdorim nga të moshuarit, në shtëpinë e të moshuarve Tiranë, rezulton i më poshtë vijon:

Prokurime blerje medikamente



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHITËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Viti	Fondi planifikuar	Fondi realizuar	Realizuar (%)
2020	500,000	448,000	89,6
2021	550,000	535,000	97,3
2022	550,000	520,000	94,55

(Burimi: SHMT, Punoi: KLSH)

Nga auditimi rezulton se planifikimi për blerje medikamente është parashikuar për vitin 2020 500,000 lekë dhe është realizuar në shumën 448,000 lekë ose realizuar në masën 89,6 %. Për vitin 2021 është parashikuar në shumën 550,000 lekë dhe realizuar në shumën 535,000 lekë ose realizuar 97,3%. Për vitin 2022 blerja e medikamenteve është planifikuar në vlerën 550,000 lekë dhe realizuar në shumën 520,000 lekë ose realizuar 94,55 %.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se titullari i Institucionit, për periudhën objekt auditimi, ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për blerje medikamente, duke lëshuar Urdhër të Brendshëm.

Blerjet e medikamenteve për vitet 2020-2022, paraqiten si më poshtë vijon:

Blerje medikamente 2020-2022

Nr.	Urdhër i brendshëm	Nr. artikujve
1	Nr.2, datë 13.01.2020	122
2	Nr. 3, datë 13.01.2021	122
3	Nr.2, datë 12.01.2022	122

Në të treja procedurat konstatohet se përlllogaritja e fondit limit nuk është pasqyruar në proces verbal të përkatëse të mbajtura nga grupet e ngritura për këtë qëllim. Grupi i punës është shprehur në procesverbalin e mbajtur: "Grupi i punës për testimin e tregut është mbështetur tek libri I medikamenteve me cmimet përkatëse për secilin medikament", duke mos pasqyruar vlerën për secilin prej tyre dhe përlllogaritjen totale. Veprim në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimi 05/2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", sipas së cilit "Përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit nga titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të VKM 285/2021..."

B. Blerja e medikamenteve

Për vitin 2020

NA me Urdhër nr. 2, datë 05.01.2020 "Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla" ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. K.B (kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L. D. (anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2021.

Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y. J. dhe 3 kujdestaret znj. X. K., znj. Z.H. dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2020 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 që nuk rimburohen, që rimburohen dhe disa medikamente për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 13.01.2020, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Nga ana e mjekut dhe 3 kujdestarëve nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që përlllogaritjen e sasisë së medikamenteve të bazohen në një plan të posaçëm për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit, veprim në kundërshtim me pikën 6, detyrave të mjekut, rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016, sipas së cilës "Mjeku, harton planin për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit."



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Si dhe në kundërshtim me paragrafin 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime”.

Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 448,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 22 prot., datë 23.01.2021, me afat deri në 31.12.2020.

Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 2/2020, nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit në institucion dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “ Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë: d. Verifikimi i sasisë Brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarte, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë provame zgjedhje dhe, kur ka diferencë, verifikimi bëhet për të gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një. 47. Në cdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dh enjofton shitësin për ti tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastiit. (Brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin)”.

Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete – hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me flete – dalje.

Shpenzimet për blerje medikamente 2020

Nr.	Paguuar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë		
1	15	11.02.2020	15,710.6	2	31.01.2020	15,710.6	S. sh.p.k.	J.....U
2	16	11.02.2020	10,187	3	31.01.2020	10,187		
3	36	11.03.2020	14,082.43	7	29.02.2020	14,082.43		
4	37	11.03.2020	15,544.75	8	29.02.2020	15,544.75		
5	47	09.04.2020	39,836	9	31.03.2020	39,836		
6	48	09.04.2020	16,924.1	10	31.03.2020	16,924.1		
7	49	09.04.2020	4,218	11	31.03.2020	4,218		
8	61	13.05.2020	16,958.8	13	30.04.2020	16,958.8		
9	62	13.05.2020	4,400	14	30.04.2020	4,400		
10	63	13.05.2020	8,121	45	30.04.2020	8,121		
11	80	16.06.2020	12,087	16	31.05.2020	12,087		
12	81	16.06.2020	8,485.6	17	30.05.2020	8,485.6		
13	82	16.06.2020	2,421.2	18	30.05.2020	2,421.2		
14	100	09.07.2020	22,298	19	30.06.2020	22,298		
15	101	09.07.2020	12,415.4	20	30.06.2020	12,415.4		
16	102	09.07.2020	702	21	30.06.2020	702		
17	120	13.08.2020	22,019.4	20	31.07.2020	22,019.4		
18	121	13.08.2020	19,213	21	31.07.2020	19,213		
19	122	13.08.2020	9,211.6	22	31.07.2020	9,211.6		
20	131	08.09.2020	13,749.68	24	31.08.2020	13,749.68		
21	132	08.09.2020	13,520.4	25	31.08.2020	13,520.4		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

22	157	13.10.2020	21,428	29	30.09.2020	21,428		
23	158	13.10.2020	17,584	30	30.09.2020	17,584		
24	178	11.11.2020	10,897.9	34	30.09.2020	10,897.9		
25	179	11.11.2020	22,508.8	35	30.10.2020	22,508.8		
SHUMA								

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Për vitin 2021

NA me Urdhër nr. 2, datë 05.01.2021 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla” ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. K.B.(kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L.D.(anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2021.

Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y.Jdhe 3 kujdestaret znj. X.K., znj. Z.H.dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2021 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga tëmoshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 që nuk rimburohen, që rimburohen dhe disa medikamente për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.3, datë 13.01.2021, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Nga ana e mjekut dhe 3 kujdestarëve nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që për llogaritjen e sasisë së medikamenteve të bazohen në një plan të posaçëm për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit, veprim në kundërshtim me pikën 6, detyrave të mjekut, rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016, sipas së cilës “Mjeku, harton planin për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesi.”

Si dhe në kundërshtim me paragrafin 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime”.

Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 535,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 20 prot., datë 21.01.2021, me afat deri në 31.12.2021.

Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 2/2021, nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit në institucion dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë: d. Verifikimi I sasisë Brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarte, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë provame zgjedhje dhe, kur ka diferenca, verifikimi bëhet për të gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një. 47. Në cdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dh enjofton shitësin për ti tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit. (Brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin)”.

Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete – hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me Flete – dalje.

Shpenzimet për blerje medikamente 2021

Nr.	Paguat: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë		
1	22	22.02.2021	44,935	1/2021	15.02.2021	44,935	S. sh.p.k.	J.....U
2	36	24.03.2021	39,230	2/2021	18.03.2021	39,230		
3	48	08.04.2021	49,460	3/2021	30.03.2021	49,460		
4	64	10.05.2021	47,957	4/2021	01.05.2021	47,957		
5	84	08.06.2021	63,416	6/2021	31.05.2021	63,416		
6	107	08.07.2021	38,281	7/2021	01.06.2021	38,281		
7	119	09.08.2021	9,964	2/2021	27.07.2021	9,964		
8	120	09.08.2021	30,226	1/2021	27.07.2021	30,226		
9	139	13.09.2021	19,806	9/2021	30.08.2021	19,806		
10	140	13.09.2021	4,596	10/2021	30.08.2021	4,596		
11	154	07.10.2021	11,599	17/2021	30.09.2021	11,599		
12	155	7.10.2021	46,809	16/2021	30.09.2021	46,809		
13	185	11.11.2021	35,722	23/2021	30.10.2021	35,722		
14	186	11.11.2021	20,832	24/2021	30.10.2021	20,832		
15	212	09.12.2021	33,777	29/2021	27.11.2021	33,777		
16	213	09.12.2021	17,700	30/2021	27.11.2021	17,700		
17	233	29.12.2021	12,061	36/2021	24.12.2021	12,061		
18	234	29.12.2021	36,077	37/2021	24.12.2021	36,077		
SHUMA								

(Burimi: SHMT Punoi : KLSH)

Nga auditimi rezulton se:

Si kriter kualifikues në këtë procedurë është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, konstatohet mungesa e dorëzimit të dokumentacionit sipërcituar, veprim në kundërshtim me pikën 10, të ftesës për ofertë, sipas së cilës “*Mungesa e njërës nga dokumentete e mësipërme skualifikohet automatikisht.*”

Për vitin 2022

NA me Urdhër nr. 2, datë 05.01.2022 “*Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla*” ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. Arjet (kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L.D.(anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2021.

Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y.J dhe 3 kujdestaret znj. X.K., znj. Z.H. dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2022 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 që nuk rimburohen, që rimburohen dhe disa medikamente për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 12.01.2022, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Nga ana e mjekut dhe 3 kujdestarëve nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që për llogaritjen e sasisë së medikamenteve të bazohen në një plan të posaçëm për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit, veprim në kundërshtim me pikën 6, detyrave të mjekut, rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016, sipas së cilës “*Mjeku, harton planin për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit.*”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Si dhe në kundërshtim me paragrafin 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.”

Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 520,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 27 prot., datë 21.01.2022, me afat deri nëpërmbushjen e vlerës së kontratës.

Nga ana e komisionit të ngritur meUrdhër nr. 2/2022, nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit në institucion dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Veprime në kundërshtim meUdhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë: d. Verifikimi I sasisë Brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarte, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë provame zgjedhje dhe, kur ka diferencë, verifikimi bëhet për të gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një. 47. Në cdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dh enjofton shitësin për ti tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastiit. (Brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin)”.

Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete – hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me Flete – dalje.

Shpenzimet për blerje medikamente 2022

Nr.	Paguuar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT
	nr.	datë	Vlerë meTvsh	nr.	datë	Vlerë meTvsh		
1	19	10.02.2022	40,996	6/2022	31.01.2022	40,996	S. sh.p.k.	J.....U
2	20	09.02.2022	15,014	7/2022	31.01.2022	15,014		
3	30	15.03.2022	39,711	12/2022	26.02.2022	39,711		
4	31	15.03.2022	11,672	13/2022	26.02.2022	11,672		
5	53	11.04.2022	22,897	20/2022	29.03.2022	22,897		
6	54	11.04.2022	5,900	21/2022	29.03.2022	5,900		
7	72	11.05.2022	6,812	27/2022	29.04.2022	6,812		
8	73	11.05.2022	16,930	26/2022	29.04.2022	16,930		
9	100	13.06.2022	23,732	32/2022	30.05.2022	23,732		
10	101	13.06.2022	5,184	33/2022	30.05.2022	5,184		
11	111	06.07.2022	17,156	38/2022	25.06.2022	17,156		
12	112	06.07.2022	4,914	39/2022	25.06.2022	4,914		
13	138	22.08.2022	58,067	45/2022	29.07.2022	58,067		
14	139	22.08.2022	6,544	46/2022	29.07.2022	6,544		
15	153	12.09.2022	20,347	51/2022	29.08.2022	20,347		
16	154	12.09.2022	12,799	52/2022	29.08.2022	12,799		
17	172	11.10.2022	41,426	57/2022	28.09.2022	41,426		
18	173	11.10.2022	13,334	60/2022	28.09.2022	13,334		
19	197	10.11.2022	18,594	65/2022	28.10.2022	18,594		
20	198	10.11.2022	6,400	66/2022	28.10.2022	6,400		
21	216	07.12.2022	64,342	71/2022	28.11.2022	64,342		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

22	217	07.12.2022	23,630	72/2022	28.11.2022	23,630		
23	243	27.12.2022	51,718	77/2022	22.12.2022	51,718		
24	244	27.12.2022	8,780	78/2022	22.12.2022	8,780		
25	249	28.12.2022	53,052	79/2022	23.12.2022	53,052		
26	250	28.12.2022	34,031	80/2022	23.12.2022	34,031		
SHUMA			632,982			632,982		

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se për vitet 2020, 2021, 2022, respektivisht 25 (njëzetë e pesë) barna, e konvertuar në përqindje 20.5 (njëzetëpikëpesë) %, janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit, duke ndikuar në këtë mënyrë në trajtimin e barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbimin si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, veprim në kundërshtim me pikën 4, neni 36, Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Njëgjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston njëmënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Informacion i detajuar mbi llojin e medikamentit, të cilët janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv gjendet në tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Medikamenti	Nr.	Medikamenti
1	Aspirin 100mg	14	Lercanil 10 mg
2	Paracetamol 500mg	15	Fungus 150 mg
3	Salospir 100mg	16	Xarelto 20 mg
4	Depakine 500 Mg	17	Reglan 10 mg
5	Ulçezol 20mg	18	Dilvas 10mg
6	Azitromicine 500mg	19	Celefa 500mg
7	Analgina 2 MI	20	Alzancer 10 mg
8	Ciprinol 0.5ml	21	Heferol 350 mg
9	Amitriptiline 25mg	22	Vitamin C 10 mg
10	Vitamine B12 500mg	23	Spirolan 25 mg
11	Vitamine B6 25 Mlg	24	Nebiolol
12	Obradex	25	Luoderm
13	Aspirine Protek 100mg		

C. Bilanci material për gjendjen dhe sasinë e medikamenteve.

Për periudhën objekt auditimi 2020-2022, konstatohet se edhe pse janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhrat e titullarit nr. 146/1 prot., datë 11.09.2020 grup i përbërë nga K.B.(kryetare), X.K.dhe Burbuqe Kodra, për vitin 2021 shkresa nr. 128 prot., datë 15.11.2021 dhe për vitin 2022 shkresa nr. 109 prot grup i përbërë nga A.H.(kryetare) X.K.dhe B.K., datë 25.10.2022, nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare që nëpunësi zbatues i Institucionit të ketë ndërmarrë procedura për kryerjen e inventarizimit të medikamenteve, duke ndikuar në mungesën e vërtetimit të saktësisë, cilësisë së gjendjes fizike të medikamenteve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas së cilit “74. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë te pakten një here në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.



81. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistruara kontabel të aktiveve të njësisë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit me shkresën nr. 156 date 06.12.2023 protokolluar në KLSH me nr. 438/9 prot, date 07.12.2023 ka paraqitur observacion znj. E.T.përgjegjëse e Sektorit të Administratës, në cilësinë financiere dhe z. Y.J. në cilësinë mjekut të institucionit, referuar Projekt Raportit të Auditimit, shohim të arsyeshme të bëjmë me dije si më poshtë:

1- Drejtimi Nr.3 “Auditim mbi procedurat e prokurimit me vlere të vogël” faqe 39-40,
- Procedura e prokurimit “Shërbim Ashensori” viti 2020-2022. Në lidhje me OE i shpallur fitues “G.G.” shpk me administrator z G.H., për të tre vitet 2020,2021,2022 ka të njëjtin NIPT K.P dhe të njëjtin nr. llogarie Bankare 5..... pranë BKT me IBAN ALA, ka ndryshuar vetëm emrin e administratorit ku është z E.H.. Përsa i përket vërtetimit të OSHEE të kërkuar si kriter disponojmë kopje (dokumenti bashkëngjitur siç është dërguar tek Akt-konstatimet)

Qëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pse nuk ka ndryshuar llogaria bankare, nuk ndikojnë në detyrimin se kontrata duhet të nënshkruhet detyrimisht nga përfaqësuesi ligjor i OE. Lidhur me vërtetimin e OSHEE, kemi bashkëlidhur librezën e OSHEE e cila rezultoi e shlyer për detyrimet përkatëse, por në periudhën që është zhvilluar procedura nuk është paraqitur asnjë vërtetim sipas kërkesave në ftesën për ofertë.

Meqenëse dokumentacioni depozituar nga ana juaj, nuk justifikon veprimet e trajtuara në material, observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

- Aplikimi për regjistrim. Ashensori që disponon Shtëpia e të Moshuarve Tirane për të tria katet është certifikuar në vitin 2023 (bashkëngjitur dokumentin e certifikimit).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Dokumentacioni bashkëlidhur justifikon gjetjen edhe pse është kryer në vitin 2023, pra përgjatë periudhës audituese nuk ka qenë certifikuar. Në këto kushte observacioni merret parasysht dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit

- Procedura e prokurimit “Blerje medikamente” viti 2020-2022. Ju sqarojmë se të gjitha medikamentet që lëshon mjeku me recete janë të regjistruara në kartelat e përfituesve ,pastaj në momentin që tërhiqen medikamentet nga farmacia regjistrohen në bllokun e medikamenteve ku merret dhe firma e përfituesve sipas rastit. Në asnjë rast nuk kemi tërhequr medikamente pa parë datën prodhimit, datën e skadencës dhe vlerën nga komisioni i pritjes së mallit .Në institucionin tone kemi raste të ndryshme që për një ditë mund të kemi 5-6 receta të lëshuara nga mjeku i familjes sipas rastit. Në baze të farmakovigjilencës dhe fushës sime si mjek si dhe ecurisë së pacientëve që trajtoj prej 30-vjetëve, kam përdorur emrin tregtar në ndonjë rast të veçantë për cilësinë e medikamentit dhe rezultatet që ka dhënë tek pacientet. Ka patur mungesë të medikamentit me principin aktiv dhe pacienti nuk mund të rrije pa mjekim .

Qëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pse medikamentet regjistrohen në kartelë dhe në librin përkatës, nuk justifikohet mungesa e procesverbalit i cili tregon plotësimin e specifikimeve të vendosura. Përsa i përket procedurës së përdorur të emrit tregtar, absolutisht që shëndeti i pacientëve prevalon, por në çdo rast që konsiderohet e përshtatshme përdorimi i emrit tregtar si dhe detyrimisht duhet të mbahet një procesverbal mbi arsyet që ju çojnë drejt kësaj vendimmarrje.

Meqenëse dokumentacioni depozituar nga ana juaj, nuk justifikon veprimet e trajtuara në material, observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Titulli i gjetjes	Parregullsi në procedurat për prokurim me vlerë të vogël periudha 2020-2022 - SHMSH dhe SHMT
Situata	<p>1.Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha praktikat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në të dyja Institucionet:</p> <p>-Në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas ftesës për ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit.</p> <p>2.Problematikat e konstatuara lidhur me blerjen e medikamenteve:</p> <p>Në të treja procedurat e zhvilluara pranë SHMT për blerje medikamentesh, konstatohet se përllogaritja e fondit limit nuk është pasqyruar në proces verbalet përkatëse të mbajtura nga grupet e ngritura për këtë qëllim. Grupi i punës është shprehur në procesverbalin e mbajtur: <i>“Grupi i punës për testimin e tregut është mbështetur tek libri i medikamenteve me cmimet përkatëse për secilin medikament”</i>, duke mos pasqyruar vlerën për secilin prej tyre dhe përllogaritjen totale.</p> <p>- Në të dyja institucionet nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që për llogaritjen e sasisë së medikamenteve të bazohen në një plan të posaçëm për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit.</p> <p><u>Për SHMT:</u></p> <p><u>Viti 2020:</u> NA me Urdhër nr. 2/2020 <i>“Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla”</i> ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. K.B.(kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L.D.(anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2020. Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y.J dhe 3 kujdestaret znj. X.K, znj. Z.H.dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2020 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2/2020, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 448,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 22 prot., datë 23.01.2021, me afat deri në 31.12.2020.</p> <p><u>Viti 2021:</u> NA me Urdhër nr. 2/2021 <i>“Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla”</i> ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. K.B.(kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L.D.(anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2021. Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y.J dhe 3 kujdestaret znj. X.K, znj. Z.H.dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2021 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 që nuk rimburohen, që rimburohen dhe disa medikamente për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa</p>



është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.3, datë 13.01.2021, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 535,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 20 prot., datë 21.01.2021, me afat deri në 31.12.2021.

Viti 2022: NA me Urdhër nr. 2, datë 05.01.2022 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla” ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. A.H. (kryetare), Znj. X.K.(anëtare) dhe znj. L.D.(anëtare) dhe ka funksionuar për gjithë vitin 202. Procedura e blerjes fillon nga Mjeku i Institucionit z. Y.J dhe 3 kujdestaret znj. X. K., znj. Z.H.dhe znj. A.Q., të cilët me kërkesën e datës 06.01.2022 drejtuar drejtorit të Institucionit, kanë kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 që nuk rimburohen, që rimburohen dhe disa medikamente për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 12.01.2022, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 520,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 27 prot., datë 21.01.2022, me afat deri nëpërmbyshjen e vlerës së kontratës.

Për SHMSH: Për vitin 2020, konstatohet se kërkesa iniciuese datë 12.05.2020 është përgatitur nga mjekja e Institucionit zj. H.B.dhe zj. T.S. dhe z. S.B.. Për vitin 2021, konstatohet kërkesa iniciuese datë 16.07.2021 është përgatitur nga mjekja e Institucionit zj. H.B.dhe Përgjegjësia e sektorit social zj. M.R. dhe kujdestar z. S.B.. Për vitin 2022, konstatohet kërkesa iniciuese e përgatitur nga mjekja e Institucionit zj. H.B.dhe Përgjegjësia e sektorit social zj. M.R.. Në të treja procedurat nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që për llogaritjen e sasisë dhe llojit të medikamenteve të bazohen në një plan të posaçëm për plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit.

Për vitin 2020, për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “C. P.” sh.p.k., me ofertë 348,641 lekë (pa Tvsh);

Për vitin 2021, për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “D.M.” sh.p.k., me ofertë 259,880.30 lekë (pa Tvsh);

Për vitin 2022, për blerjen e mallit është kryer procedura në formë shkresore dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “D.M.” sh.p.k., me ofertën më të ulët 99,825.22 lekë (pa Tvsh).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>- Në të dyja institucionet janë konstatuar problematika me procedurën e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe verifikimin paraprak të tyre, përkatësisht:</p> <p>Për SHMT: Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 2/2020, 2/2021 dhe 2/2022 nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit në institucion dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete – hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me flete – dalje.</p> <p>Për SHMT: Në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se për vitet 2020, 2021, 2022, respektivisht 25 (njëzetë e pesë) barna, e konvertuar në përqindje 20.5 (njëzetëpikëpesë) %, janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit.</p> <p>- Gjatë auditimit në SHMT, për periudhën objekt auditimi 2020-2022, konstatohet se edhe pse janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhrat e titullarit nr. 146/1 prot., datë 11.09.2020 grup i përbërë nga K.B.(kryetare), X.K.dhe B.K., për vitin 2021 shkresa nr. 128 prot., datë 15.11.2021 dhe për vitin 2022 shkresa nr. 109 prot grup i përbërë nga A.H.(kryetare) X.K.dhe B.K., datë 25.10.2022, nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare që nëpunësi zbatues i Institucionit të ketë ndërmarrë procedura për kryerjen e inventarizimit të medikamenteve, duke ndikuar në mungesën e vërtetimit të saktësisë, cilësisë së gjendjes fizike të medikamenteve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre.</p>
Kriteri	<p>- Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 4;</p> <p>- Ligj nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 10, pika 1 dhe 2;</p> <p>-Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3, 7;</p> <p>- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 18, pika 36;</p> <p>- Urdhri i ministrit të shëndetësisë nr. 660 datë 20.09.2018 “Për miratimin e rregullores mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave”, neni 10, pika 1.</p> <p>- Rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016, pika 6.</p> <p>-Kërkimi me emër tregëtar dhe jo princip aktiv ndikon në trajtimin jo të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbimin, si përbën pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik;</p> <p>-Mungesa e një plani ndikon në mungesën e transparencës së sasisë së medikamenteve;</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>-Mosmbajtja e procesverbalit përkatës mbi afatin e skadencës dhe pullën e secilit medikament ndikon në kujdesin shëndetësor që ju ofrohet të moshuarve.</p> <p>Moskryerja e inventarizimit të medikamenteve ndikon në mungesën e vërtetimit të saktësisë, cilësisë së gjendjes fizike të medikamenteve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre.</p>
Shkaku	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	<p>Të dyja Institucionet, të marrin masa për hartimin e një plani të posaçëm vjetor me qëllim plotësimin e nevojave mjeksore për përfituesit dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor.</p> <p>-Komisionet e marrjes në dorëzim në cdo rast të mbajnë procesverbal në momentin e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe të pasqyrojnë qartë datën e skadencës dhe praninë e pullës.</p> <p>-Në çdo rast, që nuk është i arsyetuar nga mjeku i Institucionit arsyeja se përse kërkohet medikamenti me emër tregëtar, proceduar e prokurimit të kryhen me emër principi aktiv.</p> <p>-Komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit.</p> <p>Në Shtëpinë e të moshuarve Shkodër, Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurë të blerjeve të vogla në ftesën për ofertë të mosvendosi fondin limit të procedurës, si dhe medikamentet e rimbursueshme të mos prokurohen, por të ndiqet procedura për përfitimin e rimbursimit.</p> <p>Në Shtëpinë e të moshuarve Tiranë, Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në çdo rast në procesverbalet e mbajtura të pasqyrojë fondin limit.</p>

Titulli i gjetjes	Parregullsi në procedurat për prokurim me vlerë të vogël “Shërbim Ashensori” viti 2020 dhe 2021-SHMT
Situata	<p>Lidhur me procedurën “Shërbim Ashensori” viti 2020 dhe 2021 është konstatuar parregullësi si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Në të dy procedurat konstatohet se si kriter kualifikues është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, i cili figuron i njëjtë për të gjitha procedurat nuk konstatohet i depozituar vërtetimi i OSHEE për procedurën e vitit 2020 dhe 20212. Operatori i shpallur fitues “G.G.” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e shërbimit me nr. 23 prot., datë 24.01.2020 përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. G.H., i cili në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka patur tagër administratori, pasi referuar informacionit të përcjellë nga gjendja e regjistrimit të shoqërisë “G.” sh.p.k. afati i emërimit i ka përfunduar në datën 03.07.2019. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata nr. 32 prot., datë 25.01.2022, në të cilën operatori është përfaqësuar nga z. G.H., i cili sërish ka vepruar në kundërshtim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	tagrin ligjor, pasi administrator i shoqërisë në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë z. E.H..
Kriteri	-Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 7, 17.
Ndikimi/Efekti	-Mos përcjellja e dokumentacionit provues të OE të shpallur fitues sipas kërkesave të ligjit sjell mungesë transparence në kryerjen e procedurave dhe mundësi për abuzim. -Nënshkrimi i kontratës nga persona pa tagër ligjor sjell pavlevshmëri kontrate
Shkaku	E mesme
Rekomandimi	Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, të mos shpall OE fitues pa u siguruar se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK, si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik të veprojnë në përputhje me tagrin ligjor.

b) Inventarizimi Pronës Shtetërore.

Për Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.

Ne kuadrin e menaxhimit të aktiveve, njësia shpenzuese ka kryer inventarizimin e aktiveve të saj. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njesise, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrë të duhur dhe me efikasitet të tyre. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të Titullarit të njesise publike ose Nepunesit Autorizues të cdo niveli të njesise publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nepunesi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabel të aktiveve të njesise.

Për vitin 2020 NA, në zbatim të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, ka miruar Komisionin e Inventarizimit me Urdhër nr. 146/1 prot, datë 11.09.2020. Komisioni përbëhet nga znj. K.B.(Kryetar), X.K.(anëtar) dhe B.K. (anëtar), cili ka për detyrë:

Komisioni ka për detyrë të bëjë inventarizimin e gjendjes së aktiveve të qëndrueshme të trupezuara dhe garkulluese në magazine dhe në përdorim për llogari të datës 31.12.2022.

- Të merren masa të nevojshme për azhordinimin e veprimeve të kartelave të magazines që të organizohet puna për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm të inventarizimit.

- Të popozohet pranë komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit gjendja e aktiveve të qëndrueshme dhe të trupezuara.

- Të ndiqet në vazhdimësi kryerja e kësaj detyre, mbarimin brenda afatit dhe me cilësi si dhe të përgatitet materiali i nevojshëm së bashku me sektorin e financës për të raportuar rezultatet Komisioni Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve sipas dokumentit “Flete- Inventari date 30.12.2021” për llogaritë 327, llog 218 dhe llog 214, nga ku referuar gjendjes kontabel kanë kryer verifikimet fizike për secilin nga artikujt për secilin nga dhomat për katet përkatës. Me shkresën nr.175/1 datë 03.12.2020 titullari i institucionit ka ngritur urdhrin për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të materialve, grup i përbërë nga E.T.(Kryetare), J.P.(anëtar), Z.H.(anëtare) dhe G.M.(anëtar).

Komisioni ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit për llogarinë 214, 15 artikuj në vlerën 356,000 lekë, për llogarinë 218, 6 artikuj në vlerën 42,526 lekë si dhe për llog 327, 160 artikuj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

në vlerën 264,343 lekë.

Titullari i institucionit (NA) ka ngritur komisionin me urdhrin nr.180 datë 29.12.2020 për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit i cili është i përbërë nga L.D.(kryetare), L.I., K.Z., Z.A.dhe M.X., nga ku ka përcaktar se:

-Komisioni ka për detyrë asgjësimin e të gjitha mayërialeve të nxjerra jashtë përdorimit
-Komisioni ka për detyrë të bëjë asgjësimin e të gjitha materialeve të papërdorshme si thyrja, coptimi dhe groposja.

Komisioni ka asgjësuar për llogarinë 218, 6 artikuj në vlerën 42,526 lekë në nga ku është kryer dhe veprimi në kontabilitet, për llog 214 nga 15 artikuj për të cilin janë vlerësuar për tu nxjerrë jashahtë përdorimit në vlerën 356,000 lekë, janë asgjësuar 6 prej tyre në vlerën 117,354 lekë. Grupi i auditimit konstatoi se vlera e regjistruar në kontabilite është ajo e vlerësimit të kryer nga grupi i për vlerësimin dhe nxjerrjen jashë përdorimit dhe jo vlera e nxjerrë nga grupi i asgjësimit të aktiveve.

Për vitin 2021 NA, në zbatim të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, ka krijuar Komisionin e Inventarizimit me Urdhër nr. 128 prot, datë 15.11.2021. Komisioni përbehet nga znj. A.H.(Kryetar), X.K.(anëtar) dhe B.K. (anëtar), dhe ka funksionuar për periudhën 11.11.2021 deri 31.12.2021.

Komisioni ka për detyrë të bëjë inventarizimin e gjendjes së aktiveve të qëndrueshme të trupezuara dhe garkulluese në magazine dhe në përdorim për llogari të datës 31.12.2022.

- Të merren masat e nevojshme për azhordinimin e veprimeve të kartelave të magazines që të organizohet puna për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm të inventarizimit.
- Të popozohet pranë komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit gjendja e aktiveve të qëndrueshme dhe të trupezuara.
- Të ndiqet në vazhdimësi kryerja e kësaj detyre, mbarimin brënda afatit dhe me cilësi si dhe të përgatitet materiali i nevojshëm së bashku me sektorin e financës për të relatuar rezultatet Komisioni Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve sipas dokumentit “Flete- Inventari date 30.12.2021” për llogaritë 327, llog 218 dhe llog 214, nga ku referuar gjendjes kontabel kanë kryer verifikimet fizike për secilin nga artikujt për secilin nga dhomat për katet përkatës. Me shkresën nr.135 datë 06.12.2021 titullari i institucionit ka ngritur urdhrin për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve, grup i përbërë nga E.T.(Kryetare), J.P.(anëtar), Z.H.(anëtare) dhe G.M.(anëtar).

Komisioni ka vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit për llogarinë 214, 13 artikuj në vlerën 268,871 lekë, për llogarinë 218, 6 artikuj në vlerën 43,942 lekë si dhe për llog 327, 41 artikuj në vlerën 43,288 lekë. Grupi i auditimit konstatoi se nga pergjegjësi i finances është kryer heqja nga bilanci i këtyre aktiveve, edhe pse titullari nuk ka ngritur një komision për asgjësimin tyre si dhe nuk janë asgjësuar.

Për vitin 2022 NA, në zbatim të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, ka krijuar Komisionin e Inventarizimit me Urdhër nr. 109 prot, datë 25.10.2022. Komisioni përbehet nga znj. A.H.(Kryetar), X.K.(anëtar) dhe B.K. (anëtar).

Sipas urdhrin të Titullarit komisioni ka për detyrë të bëjë inventarizimin e gjendjes së aktiveve të qëndrueshme të trupezuara dhe garkulluese në magazine dhe në përdorim për llogari të datës 31.12.2022.

- Të merren masat e nevojshme për azhordinimin e veprimeve të kartelave të magazines që të organizohet puna për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm të inventarizimit.
- Të popozohet pranë komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit gjendja e aktiveve të qëndrueshme dhe të trupezuara.
- Të ndiqet në vazhdimësi kryerja e kësaj detyre, mbarimin brënda afatit dhe me cilësi si dhe të përgatitet materiali i nevojshëm së bashku me sektorin e financës për të relatuar rezultatet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Komisioni Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve sipas dokumentit “Flete- Inventari date 30.12.2022” për llogaritë 327, llog 218 dhe llog 214, nga ku referuar gjendjes kontabel kanë kryer verifikimet fizike për secilin nga artikujt për secilin nga dhomat për katet përkatës. Me shkresën nr.119 datë 01.12.2022 titullari i institucionit ka ngritur urdhrin për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve, grup i përbërë nga E.T.(Kryetare), J.P.(anëtar), Z.H.(anetare) dhe G.M.(anëtar).

Komisioni ka vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit për llogarinë 214, 13 artikuj në vlerën 320,286 lekë dhe për llog 327, 304 artikuj në vlerën 106,938 lekë.

Titullari i institucionit (NA) ka ngritur komisionin për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit i cili është i përbërë nga L.D.(kryetare), L.I., K.Z., Z.A.dhe L.J., nga ku ka përcaktar se:

- Komisioni ka për detyrë asgjësimin e të gjitha materialeve të nxjerra jashtë përdorimit
- Komisioni ka për detyrë të bëjë asgjësimin e të gjitha materialeve të papërdorshme si thyerja, coptimi dhe groposja.

Komisioni ka asgjësuar për llogarinë 214, 13 artikuj në vlerën 320,268 lekë nga ku është kryer dhe veprimi në kontabel i heqjes prej bilancit të aktiveve.

Nga auditimi për të tre vitet objekt auditimit (2020,2021,2022) rezulton se:

1.Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit për anëtarët e Komisionit të Inventarizimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 82.

82. Komisioni nuk duhet të jete me pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi sipas Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Per parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.

2. Për të tre vitet objekt auditimit, NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Inventarizimit, i cili rezulton të jetë i njëjtë për vitin 2020, 2021 dhe vitin 2022, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 84.

84. Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

3. Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventar për gjendjen në sasi dhe vlerë të farmacisë si dhe kuzhinës, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310“Mallra ushqimore” dhe llogarisë 327 “Inventar i imët”, i cili duhet të firmosur nga përgjegjësi material (magazineri dhe infermierja), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 83.

83. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.

4. Komisioni i inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal mbi të dhënat e inventarizimit, mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike, nuk ka përpiluar raport lidhur me inventarizimin, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 85 germa “a” dhe germa “c”.

85, germa “a”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a-Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e



te dhënave te inventarizimit ne proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjate periudhës se inventarizimit..

85, germa “c”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë te përpiloje një raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, per kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe per vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje per veprime te mëtejshme Nëpunësit Autorizues-

5. Komisioni i Vlerësimit nuk ka hartuar Proces Verbal të protokolluar i cili duhej të nënshkruhej nga grupi dhe përgjegjësi i material që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, duke mos përcaktuar nëse këto aktive duhet te dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbali nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar ne arkiv, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa “c”, 105.

Komisioni i inventarizimit nuk ka hartuar “Relacion mbi inventarizimin fizik ne njësinë shpenzuese”, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 106.

102. Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve te rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit te skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar te marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë te njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga te cilat qëndron ne arkiv.

104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

a. nëse është i nevojshëm apo jo per veprimtarinë e njësisë;

b. nëse nuk rezulton i nevojshëm per njësinë, a është ne gjendje te mire fizike dhe ka mundësi përdorimi te mëtejshëm ne njësi te tjera;

c. nëse duhet te nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.

105. Proces Verbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Proces verbali miratohet nga titullari i njësisë publike

106. Relacioni i vlerësimit përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit te vlerësimit

6. Komisioni Asgjësimit ka përpiluar Proces Verbalet (pa numër dhe datë) për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi ose ne ruajtje per asgjësim, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 109; 110.

109. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale te riciklueshëm, hiqen nga regjistri i aktiveve ne përdorim, bëhen hyrje ne magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

110. Proces Verbali për nxjerrjen jashtë përdorimi hartohet nga komisioni per nxjerrjen nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

përdorimi në tre kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtëpërdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit

Konkluzion:

- Urdhëri/at e NA “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit” (NA, kanë patur për detyrë kryerjen e inventarizimit për aktivet e njësisë shpenzuese, por nuk ka përcaktuar një datë të përfundimit të procesit të inventarizimit. Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion për NA, lidhur me përshkrimin gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në përdorim si dhe pjesa e e madhe e pergjegjësive të materialit nuk kanë firmosur në fletët e inventarit, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 85 germa “a” dhe germa “c”.
- Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verballi nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar në arkiv, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa “c”, 105.
- Komisionit të Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit për anëtarët e veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 82.
- NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit (vitit 2019 nuk ka Urdhër), por në përbërje të tij rezultojnë të njëjtët anëtarë me komisionin e inventarizimit të vitit paraardhës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 84.
- Komisioni Asgjësimit ka mbajtur Proces Verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 109; 110.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

4. Znj. A.P. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të institucionit.
5. Znj. E.T. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të institucionit
6. Grupi i inventarizimit znj. A.H. (Kryetar), X.K.(anëtar) dhe B.K. (anëtar)
7. Grupi i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit E.T.(Kryetare), J.P.(anëtar), Z.H.(anëtare) dhe G.M.(anëtar).
8. Grupi i asgjësimit, L.D.(kryetare), L.I., K.Z., Z.A.dhe L.J..

Titulli i Gjetjes:	Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të sakta.
Situata	<i>Për SHM Tiranë & Shkodër: Urdhri/at e NA “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit” kanë patur për detyrë kryerjen e inventarizimit për aktivet e njësisë shpenzuese, por nuk ka përcaktuar një datë të përfundimit të procesit të inventarizimit. Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion për NA, lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në përdorim, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe me kërkesat</i>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 85 germa “a” dhe germa “c”.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet te dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbali nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar ne arkiv, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa “c”, 105.</p> <p>NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, Kreun III, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30, sipas të cilit:</p> <p>Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit për anëtarët e veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 82.</p> <p>NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit, por në përbërje të tij rezultojnë të njëjtët anëtare me komisionin e inventarizimit të vitit paraardhës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 84.</p> <p>Komisioni asgjësimit ka mbajtur proces verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 109; 110.</p>
Kriteri:	<p><i>Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;</i></p> <p><i>- Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;</i></p> <p><i>-Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “ Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të asetëve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i institucionit të SHMSH & SHMT në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjësen e Sektorit të Administratës (Financiere) në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, në vazhdimësi të marrë masa që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të kërkojë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	zbatojë me përpikmëri procedurën e parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke eliminuar problematikën e hasur gjatë këtij auditimi të konstatimit të mungesës së urdhrimit për ngritje komisioni, mungese e deklarates së shmangies se konfliktit te interesit, mungesës së mbajtjes se proces verbalit, të shmangies së të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite resht, mungese e firmosjes nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesës se relacionit për titullarin, etj..
--	---

Titulli i Gjetjes:	Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të sakta për SHM Tiranë
Situata	Nga auditimit u konstatua se Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventar për gjendjen ne sasi dhe vlere të farmacisë si dhe kuzhinës, për të vërtetuar saktësinë, cilesinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 “Mallra ushqimore” dhe llogarisë 327 “Inventar i imët”, i cili duhe të firmosur nga përgjegjësi material (magazineri dhe infermierja), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 83.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; -Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “ Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nëpunësi zbatues të marrë masa ku në zbatim të urdhrimit të Titullarit, në rolin e përgjegjësit për monitorimin e procesit të inventarizimit të Aktiveve të Institucionit të kryej çdo fund vit, inventarin edhe të gjëndjesë sasiorë dhe cilësore të farmacisë së institucionit dhe kuzhinës.

Drejtimi 4: Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën 2019-2020-2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në Udhëzimin e MFE nr.08 datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare
- Auditimi i përllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve
- Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me katet ligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasyrat e tjera financiare.

Në zbatim të pikës nr.4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

- Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

5. Formati 5- Shënime shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve).
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

A. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar .

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr.25/2018, datë 26.6.2008 “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare”, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga realizuara nga Financierja e Institucionit, situacione këto të rakorduara me Degën e Thesarit.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2020 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën me shkresën nr. 35, datë 26.02.2021 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor”

- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 49, datë 23.02.2022 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor” duke respektuar afatet ligjore.

- për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 49, datë 23.02.2023 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

B. Auditimi i përlllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konformë rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 27,446,369 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 27,359,187 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 87,182 lekë

Totali ii + iii = 27,446,369 lekë

Për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 27,446,369 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 27,359,187 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 87,182 lekë

Totali ii + iii = 27,446,369 lekë

Për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 28,493,318 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 28,296,153 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 197,165 lekë

Totali ii + iii = 28,493,318 lekë

Për vitin 2020, llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2020 me 31.12.2021, përkatësisht 2,253,274 lekë – 2,424,454 lekë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2 “Performance financiare e institucionit” prej (171,180)lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ e pasqyruar dhe në kolonën nr.100 të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” (F1), përfaqëson vlerën e ndryshimit të gjendjes së inventarit në shumën prej -171,180 lekë.

Për vitin 2021, llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2020 me 31.12.2021, (përkatësisht 2,340,456 lekë – 2,253,274 lekë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2 “Performance financiare e institucionit” prej 87,182 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ e pasqyruar dhe në kolonën nr.100 të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” (F1), përfaqëson vlerën e ndryshimit të gjendjes së inventarit në shumën prej 1,760,177 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Për vitin 2022, llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2021 me 31.12.2022, përkatësisht 2,537,621 lekë – 2,340,456 lekë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2 “Performance financiare e institucionit” prej (197,165) lekë. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ e pasqyruar dhe në kolonën nr.100 të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” (F1), përfaqëson vlerën e ndryshimit të gjendjes së inventarit në shumën prej 197,165 lekë.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike. Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2020, 2021 dhe 2022 janë plotësuar si më poshtë:

-Për vitin 2020 Në llogarinë 72 “Grande Korrente të brendshme” në vlerën 29,530,281 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për NJQP(Qendrore) në vlerën 27,758,174 lekë, dhe (7206) Financim i Pritshëm nga buxheti në vlerën 1,772,107 lekë.

-Për vitin 2021 Në llogarinë 72 “Grande Korrente të brendshme” në vlerën 27,446,369 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për NJQP(Qendrore) në vlerën 25,871,279 lekë, lekë dhe (7206) Financim i Pritshëm nga buxheti në vlerën 1,575,060 lekë.

-Për vitin 2022 Në llogarinë 72 “Grande Korrente të brendshme” në vlerën 28,493,318 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për NJQP(Qendrore) në vlerën 26,918,228 lekë, dhe (7206) Financim i Pritshëm nga buxheti në vlerën 1,638,194 lekë.

Në këtë pasqyrë përfshihen SHPENZIMET gjatë vitit 2020,2021 dhe vitit 2022 përmbledhur në mënyrë tabelare si më poshtë vijon:

Llog	Pasqyra e Performancës Financiare	Viti			2022/2021
		2022	2021	2020	
B	SHPENZIMET	28.296.153	27.359.187	29.701.461	936.966
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	12.542.481	11.760.018	12.962.801	782.463
6001	Paga, personel I perhershëm	10.046.819	9.912.551	10.886.974	134.268
6002	Paga personel I Perkohshëm	2.317.739	1.847.467	2.075.827	470.272
6009	Shpenzime të tjera për personelin	177.923	0	0	177.923
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	2.105.784	2.017.674	2.177.049	88.110
6010	Kontributi I Sigurimeve Shogërore	2.005.929	1.807.592	1.950.788	198.337
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetësore	99.855	210.082	226.261	-110.227
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	13.510.053	13.668.677	14.390.431	-158.624
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1.263.056	1.042.492	267.656	220.564
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6.059.438	6.605.069	1.705.399	-545.631
6022	Shërbime nga të tjerë	3.662.341	3.956.014	7.051.697	-293.673
6023	Shpenzime transporti	1.200.358	1.121.662	3.040.977	78.696
6024	Shpenzime udhëtimi	0	0	1.634.834	0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	788.520	871.440	0	-82.920
6026	Shpenzime për qeramarrje	0	0	617.868	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	72.000	72.000	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	464.340	0	72.000	464.340

Burimi: Sektori i Finance & përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2022 shpenzimet e konstatuara janë në vlerën 28,296,153 lekë analizuar dhe krahasuar me vitin e mëparshëm 2021 kemi një shtesë në vlerën 936,966 lekë e cila i përket vetëm llog 600 dhe llog 601, referuar VKM nr.1151 datë 24.12.2021 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021 e cila u rrit nga 4 punonjës part time, shkoj në 8 punonjës part time, analizuar për çdo llog si më poshtë vijon:

Llogaria 600 “Paga e shpenzimeve personeli” për 12,542,481 lekë, në këtë zë janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2022, përgjatë muajve Janar 2022-Dhjetor 2022, nga ku



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

krahasuar me vitin 2021 kemi një shtesë në vlerën 782,463 e cila i përket ndryshimit të VKM së sipërcituar.

Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 2,105,784 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi nga ku krahasuar me vitin 2021 është rritur në vlerën 88,110 lekë prej ndryshit të VKM së sipërcituar.

Llog 602 “Blerje Mallra & Shërbime” paraqitet në vlerën 13,510,053 lekë e cila krahasuar me vitin 2021 ka një rënie në vlerën 158,624 lekë.

Llogaria 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” për 1,263,056 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje materilesh kancelari dhe zyre e cila krahasuar me vitin 2021 ka një shtesë në vlerën 220,564 lekë.

Llogaria 6021 “Materiale dhe shërbime special” për shumën 6,059,438 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje uniforma dhe veshje speciale në vlerën 118,740 lekë; ilaçe dhe pajisje mjekësore në vlerën 623,982 lekë; furnizim dhe shërbim me ushqim për mencent në vlerën 4,471,202 lekë dhe të tjera materiale në vlerën 555,514 lekë.

Llogaria 6022 “Shërbime nga të tretët” për shumën 3,662,438 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike, ujë, telefon. Llogaria 6023 “Shpenzime transporti” për shumën 1,200,358 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si karburant, sigurim i automjeteve e cila ka një rritje të vogël nga viti 2021 në vlerën 78,696 lekë.

Llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtjen e zakonshme” për shumën 788,520 lekë përfaqësojnë, mirëmbajtje ndërtimore në vlerën 555,600 lekë, mirëmbajtje e objekteve speciale në vlerën 113,400 lekë, mirëmbajtja e ashensorit 119,520 lekë.

Llogaria 6028 “Shpenzime të lidhura me huamarrje për hua në vlerën 72,000 lekë e cila është kuta vetjake e një prej azilantit i cili nuk merr pension mujor, dhe paguaet nga insitucioni.

C.Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit fincair vjetore rezulton se:

- Për vitin 2020 “Aktivet afatgjata” zënë 94% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 7% të totalit.
- Për vitin 2021 “Aktivet afatgjata” zënë 94% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 7% të totalit.
- Për vitin 2022 “Aktivet afatgjata” zënë 92% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 8% të totalit.

Aktivet qarkulluese per vitet 2020, 2021, 2022

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Llog	EMERTIMI	Viti			
		2022	2021	2020	2022/2021
	I.Aktivet Afat shkurtra	4.175.815	3.915.546	4.134.073	260.269
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	0	0	0	0
	2.Gjendje Inventari qarkullues	2.537.621	2.340.456	2.253.274	197.165
31	Materiale	1.230.024	1.180.485	1.080.897	49.539
32	Inventar i imet	785.348	513.424	1.172.377	271.924

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

35	Mallra	522.249	646.547		-124.298
	3.Llogari te Arketushme	1.638.194	1.575.090	1.772.107	63.104
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	1.638.194	1.575.090	1.772.107	63.104
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0	108.692	0
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme			108.692	0

Burimi: Sektori i Finance & përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera e pasqyruar në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” në Pasqyrëne Pozicionit Financiar në vlerën 0 lekë përputhet e përlllogaritur në “Pasqyrën e flukseve monetare (cash flow)” rreshti nr. 34 “Teprica e Likujditeteve ne fund të vitit ushtrimor”.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2022, rezulton në vlerën 2,537,621 lekë. Në krahasim me vitin 2021 është rritur në vlerën 197,165 lekë, nga rritja e zërit “Inventar i Imët” në vlerën 271,924 lekë, zëri “Materiale” në vlerën 49,539 lekë dhe nga zvogëlimi i zërit “Mallra” në vlerën 124,298 lekë.

Diferenca për vitin 2022 në vlerën 197,165 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 87,182 lekë përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.**Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 1,638,194 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka subjekti *Shtëpia e Të Moshuarve, Tiranë* ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat në vlerën 727,946 lekë, paga part time në vlerën 196,136lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 125,465 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 184,161 lekë si dhe vlera prej 352,028 lekë të shpenzimeve utilitare të dhjetorit (energji, uje, telefon) të cilat paguhen në janar 2023. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” kuadron me vlerën 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në vlerën **prej** 1,638,194 lekë. E njejtja edhe per vitin 2021 dhe vitin 2020, te cilat janë ne vlerën 1,575,090 lekë dhe 1,772,107 lekë

Aktivet afatgjata

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 74,350mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 503 milion dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 298 milion lekë, si dhe investimet në vlerën 20,831 milion lekë.

Llog	Emertimi	2022	2021	2020	2022/2021
	II.Aktivet Afat gjata		50.061.611	53.265.302	57.479.862
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0	0
21	2.Aktive Afatgjata materiale	50.061.611	53.265.302	57.479.862	-3.203.691
210	Toka, Troje, Terene	-	0	0	
212	Ndertesa e Konstruksione	48.363.461	50.908.906	53.588.322	-2.545.445
214	Instalime teknike, makineri e paisje	236.925	525.493	1.729.423	-288.568
215	Mjete Transporti	10.000	10.000	10.000	0
218	Inventar ekonomik	1.451.225	1.820.903	2.152.117	-369.678
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
	4.Investime	0	0	0	0

Burimi: Sektori i Finances & përpunuar nga grupi i auditimit

-Llog 210 “Toka, Troje, terene” në vlerën zero lekë për të tre vitet objekt auditimit.

Nga auditimi rezultoi se, për të tre vitet object auditimi, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës-truall në administrim të SHMT, më konkretisht në formatin nr. 1 “Pasqyra e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale”, llogaria 210 “Toka troje terren” është pasqyruar në mënyrë jo të saktë, në vlerën 0 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të referencës), SHMT duhet të përcaktojë çmimin përkatës.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 48,363,461 lekë, përbërë nga vlera e godinës së institucionit Shtëpia e të Moshuarve. Gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 nuk ka pësuar ndryshime, përveç amortizimit vjetor të llogaritur në vlerën prej 2,545,445 lekë.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 236,925 lekë, e cila krahasuar ka pësuar ndryshime në vlerën 320,283 lekë, si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe shtesa gjatë vitit pa pagesë jashtë sistemit në vlerën 57,990 lekë të cilat janë donacione të ardhura për vitin 2022.

Konstatim:

Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se Llogaria 214 “Inventar ekonomik”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 320,283 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 10,000 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të institucionit Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, e cila nuk ka ndryshime nga viti paraardhës në vlerën bruto, përveç amortizimit vjetor.

Konstatim:

Grupi i auditimi konstati se kjo makinë prej 7 vitesh nuk përdoret nga SHMT, si dhe nuk i kryhet asnjë shërbim, duke qënë se është jashtë funksioni, por komisioni i inventarizimit & vlerësimit nuk e ka nxjerre jashtë përdorimit, çka sjell mos pasqyrimin e saktë të kësaj llogarie.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 1 451,225 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën 369,678 lekë, e cila përfaqëson në vlerën 5,497 lekë pakësim gjatë vitit dhe në vlerën 364,181 amortizimi vjetor.

Konstatim:

Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 5,497 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” duhet të ishte e pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022 konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,638,194 lekë me një rritje nga viti 2021 në vlerën 63,104 lekë.

Llog	EMERTIMI	Viti			
		2022	2021	2020	2022/2021
	I.Pasivet Afat shkurtra	1.638.194	1.575.090	1.772.107	63.104
	1. Llogari te Pagushme	1.638.194	1.575.090	1.772.107	63.104
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	0	0	108.692	0
42	Detyrime ndaj personelit	1.049.547	881.611	943.195	167.936
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	52.458	44.248	45.994	8.210
435	Sigurime Shoqerore	165.058	141.881	148.400	23.177
436	Sigurime Shendetesore	19.103	16.496	17.235	2.607
467	Kreditore te ndryshem	352.028	450.454	349.627	-98.426
4341	Operacione me shtetin(detyrime		40.400	158.964	-40.400

Burimi: Sektori i Finances & përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 1,697,439 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2021, e njëjta edhe per vitet e tjera.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 52,458 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në Janar të vitit 2023, e njëjta edhe per vitet e tjera.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 165,058 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 19,103 të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023, e njëjta edhe per vitet e tjera.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 504,550 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën 233,561 lekë dhe të llogarisë 423 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në 270,989 lekë.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 352,028 lekë, përfaqëson detyrimet e prapambetura për shpenzimet e muajit dhjetor të cilat do të likuidohen në janar 2023, për të cilën është debituar llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Aktivneto/ fondet

Llog	EMERTIMI	Viti			
		2022	2021	2020	2022/2021
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	52,599,23	55,605,75	59,841,82	-
		2	8	8	3.006.526
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	52,599,23	55,605,75	59,841,82	-
		2	8	8	3.006.526
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	52,402,06	55,518,57	60,013,00	-
		7	6	8	3.116.509
12	Rezultatet e mbartura			-1,588,997	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	197,165	87,182	-171,180	110
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	57.180.84	57,237,42	61,613,93	-56,578
		8	6	5	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Fondi neto në vlerën 52,599,232 lekë përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 52,402,067lekë, nga rezultati i mbartur llogaria 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” në vlerën 0 lekë, dhe llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" në vlerën 197,165 lekë Vlera e paraqitur e llogarisë 101 “Fondi bazë” dhe e llogarisë 107 “Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim” nuk përputhen me vlerat e pasqyruara në “Pasqyrë e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto”, pasi vlera e pasqyruar në 107 është reflektuar në llogarinë 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore”, e cila ka përfshirë dhe ndryshimin e gjendjes materiale. Nga ana e subjektit është bërë njëpasqyrim jo i saktë i llogarive të fondit të konsoliduar, e cilat nuk ka efekt material në pasqyrën financiare. I njëjti fenomen për të tre vitet objekt auditimi.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit me shkresën nr. 156 date 06.12.2023 protokolluar ne KLSH me nr. 438/9 prot, date 07.12.2023 ka paraqitur observacion znj. E.T.përgjegjëse e Sektorit të Administratës, ne cilësinë financieres, referuar Projekt Raportit të Auditimit, shohim të arsyeshme të bëjmë me dije si më poshtë:

- Drejtimi Nr.4 “Auditim i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse faqe 66-67.

- Inventarizimi për vitin 2020-2022: Janë ngritur komisionet per inventarizim ,nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësim. Tek llog 214 e vitit 2020, tek asgjësimi i materialeve,nga komisioni i ngritur me urdhër nr.180 prot dt. 29/12/2020 është bere një lapsus ku është marre sasia dhe vlera e vitit 2019, por ne mbylljen e llogarisë vjetore është pasqyruar e sakte vlera e asgjësimit.(Dokumenti bashkëngjitur)

- Konstatimi ne faqen 73-75 te Projekt Raportit. Ne formatin 7/a dhe 7/b te pasqyrave financiare për vitin 2022, nxjerrja jashtë përdorimit tek llogaritë 214 dhe 218 ne bilancin kontabël është bërë me vlerën bruto. Mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të Udhëzimit nr.8 dt. 9/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe pasqyrat janë hedhur në sistem nga dega e thesarit të rakorduara.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :

Ne lidhje me sa është pretenduar, referuar dokumentacionit bashkëlidhur, nga ana juaj janë dorëzuar dy procesverbale asgjësimi, te cilat janë vetëm në sasi dhe jo ne vlerë, apo sipas formatit referuar udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, observacioni juaj nuk merret parasysh.

Titulli i Gjetjes:	Mos pasqyrim i sakte i llog.210 SHM Tiranë & Shkodër
Situata	Nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën zero lekë. Nga Institucioni disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion subjekti për periudhën objekt auditimit, por rezulton se nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në zyrat e kadastrës shtetërore dhe në hipotekë, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Sipërfaqja totale e tokës, që ka SHM Tiranë & SHM Shkodër në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet
Kriteri:	Pikën 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)” , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i llogarisë 210
Shkaku:	Mos zbatim i ligjit mbi inventarizimit dhe regjistrimin e pronës shtetërore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	<p>Nga SHM Tiranë & Shkodër të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.</p> <p>Nga SHM Tiranë & Shkodër të merren masa për përlogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarr veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.</p>

Titulli i gjetjes:	Mospasqyrimi i saktë në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” për aktivet e dala jashtë përdorimi. SHM Tiranë
Situata:	<p>Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 320,283 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” duhet të ishte pasqyruar vlera bruto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</p>
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.
Shkaku	Mos sqarimi nëse ulja e llogarisë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, si pasojë e nxjerrjes së disa aktiveve jashtë përdorimi, është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.
Titulli i gjetjes	Mospasqyrimi i saktë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” për aktivet e dala jashtë përdorimi. SHM Tiranë
Situata:	Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se llogaria 218 “Inventar ekonomik”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve, për vitin 2021 në vlerën 43,947 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën prej 5,497 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.- Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36.
Ndikimi/Efekti	<ul style="list-style-type: none">- Mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.- Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit për disa aktive në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për Llogaria 218 “Inventar ekonomik” e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.
Shkaku	<ul style="list-style-type: none">- Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve.- Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit për disa aktive në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	<ul style="list-style-type: none">- Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.- Të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Drejtimi 5: Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

a) Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

b) Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Grupi i audituesve të KLSH-se, për periudhën 01.01.2020 deri në periudhën 31.12.2022, për të realizuar objektin e auditimit, u fokusua në procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së kontratave të lidhura nga AK për blerje ushqimesh, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Per prokurimin publik”; Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021, si dhe çdo akti ligjor ne fuqi lidhur me procedurën e prokurimit me fonde buxhetore.

Për periudhën 01.01.2020 deri në periudhën 31.12.2022, AK ka lidhur kontrata per blerje ushqimesh, si më poshtë vijon:

Kontratat e lidhura nga AK per 2020-2022 per blerje ushqimesh

Viti	Furnitor	Kontrata	Fondi	Totali
			prokuruar (me TVSH)	Faturës (Me Tvsh)
1	N. shpk (Kolonjale) M.Kuader	Nr.135 date 13.08.2020-31.12.2020	600.606	590.591
2	D.P (Fruta Perime) M.Kuader	Nr.134 date 13.08.2020-31.12.2020	452.250	452.231
3	4 S shpk M.Kuader	Nr133 date 13.08.2020-31.12.2020	105.300	105.251
4	E.C.(ushqime te ndryshme) SHMT (negocim pa shpallje)	Nr.164 date 02.11.2020-31.12.2020	281.100	281.100
5	E.C.(ushqime te ndryshme) SHMT (negocim pa shpallje)	Nr.131 date 08.07.2020-26.10.2020	942.744	942.744
6	4 S shpk (Bylmet) M.Kuader	Nr.117 date 01.07.2020-31.12.2020	955.800	955.794
7	E.C.(ushqime te ndryshme) Marreveshje Kuader	Nr.273 date 01.01.2020-06.06.2020	1.925.286	1.925.285
2020	Totali		5,263,086	5.252.996
1	D.P 2007 (Fruta Perime) M.Kuader	Nr.04 date 05.01.2021-31.12.2021	816.300	816.252
2	K. (Buke)	Nr.86 date 05.07.2021-31.12.2021	163.200	163.200
3	S.T. (Mishi dhe nenproduketet) Marveshje kuader	Nr.87 date 05.07.2021-31.12.2021	462.300	462.288
4	M.C.(Veze) M.Kuader	Nr.17 date 5.01.2021-31.12.2021	195.120	195.144
5	N. (Kolonjale)(Marreveshje.Kuadër)	Nr.05 date 05.01.2021-31.12.2021	1.145.640	1.145.606
6	E.C.(ushqime te ndryshme) SHMT (Negocim pa shpallje)	Nr.21 date 21.01.2021-07.07.2021	1.357.470	1.357.470
7	D.D. (Bulmet dhe nenproduktet e tij)	Nr.72 date 02.06.2021-31.12.2021	904.128	904.127
8	N. (Peshke)	Nr.26 date 03.02.2021-31.12.2021	129.600	129.600
2021	Totali		5,173,758	5.173.687
1	D.P (Fruta Perime)	Nr.45 date 22.02.2022	830.643	431.243
2	M.C.(Fruta Perime)	Nr.103 date 07.10.2022-31.12.2022	350.934	230.220
3	M.C.(Veze)	Nr.23 date 18.01.2022-31.12.2022	195.120	195.120
4	D.D. (Bylmet)	Nr.30 date 21.01.2022-31.12.2022	2.083.680	2.083.556
5	N. shpk (Kolonjale)	Nr.52 date 11.03.2022-13.08.2022	1.284.054	504.199
6	M.C.(Kolonjale)	Nr.100 date 05.10.2022-31.12.2022	350.934	350.865
7	M.C. (Buke) blerje e vogel SHMT	Nr.28 date 21.01.2022	111,04	119.040
8	S. (Buke)	Nr.67 date 18.05.2022-31.12.2022	216.000	215.959
9	S. (Mishi)	Nr.22 date 18.01.2022-31.12.2022	1.001.400	1.001.400
10	N. (Peshke)	Nr.53 date 11.03.2022-31.12.2022	129.600	129.600



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

2022 | Totali

6.442.476 | 5.261.202

(Burimi: SHMT Punoi: Grupi i auditimit)

Pothuajse të gjitha kontratat e sipërcituara janë lidhur referar Marveshjen Kuader (4 vjecare), procedura të zhvilluara nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Referua tabelës së mësipërme për periudhën objekt auditimi (vitet 2020,2021,2022) AK ka lidhur gjithësej 25 kontrata ushqimit, të cilat në total janë prokuruar me fondin limit në vlerën 16,679,320 lekë dhe janë realizuar në vlerën 15,687,885 lekë me një mosrealizim në vlerën 991,435 lekë, me një përqindje realizmi 94%, nga ku të ndara sipas viteve si më poshtë vijon:
Për vitin 2020 AK ka lidhur gjithësej 7 kontrata ushqimesh të prokuruar në vlerën 5,263,086 lekë dhe të realizuar në vlerën 5,252,996 lekë me një realizim 99,8 %.

Për vitin 2021 AK ka lidhur gjithësej 8 kontrata ushqimi të prokuruar në vlerën 5,173,758 lekë dhe të realizuara në vlerën 5,173,687 lekë, me një përqindje realizimi 99 %.

Për vitin 2022 AK ka lidhur 10 kontrata ushqimi të prokuruar për vlerën 6,442,476 lekë dhe të realizuar në vlerën 5,261,202 lekë, me një përqindje realizimi 81%.

Grupi i auditimit referuar vlerës dhe riskut që shkaktojnë në shëndet produkte të caktuara ushqimore, përzgjedhi për shqyrtim si më poshtë vijon:

Viti	Të realizuara		Përzgjedhur për auditim	
	Numër	Vlerë pa tvsh (lekë)	Numër	vlerë pa tvsh (lekë)
2020	7	5,252,996	3	3,823,823
2021	8	5,173,687	5	3,976,760
2022	10	5,261,202	4	3,718,755

Nga auditimi procedurave per zbatimin e kontratave te lidhura nga AK dhe dokumentacionit të dosjes se prokurimit rezultoi si më poshtë vijon:

Zbatimi i kontratave për Vitin 2020

➤ 1.Autoriteti Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tirane” dhe Kontraktuesi “E.C.” në baze te procedurave të prokurimit për blerje ushqimesh, ka lidhur Kontratë Furnizimi Nr.273 prot, datë 31.12.2019, referuar autorizimit për lidhje kontrate nga Shërbimi social shtetëror me shkresën nr.1031/9 datë 07.06.2019 “Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara. Furnizimi i institucionit me ushqime do bëhet sipas listës se ushqimeve të prokuruar bashkëlidhur kësaj kontrate dhe cilësisë sipas specifikimeve të kërkuara nëdokumentet e tenderit.Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do te jete 1,925,286 leke (me TVSH).

Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit të saj, dhe përfundon ne datën e marrjes në dorëzim te gjithë mallit.

Grafiku i lëvrimit të mallit do të jetë: Per ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes se kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave te autoritetit kontraktor -Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë,etj sipas kërkesave te autoritetit kontrakto. Malli do te merret ne dorëzim, kundrejt faturës tatimore origjinale, me proces verbalimarrje ne dorëzim i mbajtur nga komisioni i ngritur per këtë qëllim.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat me 7 fatura tatimore, të cilat janë likuiduar nga AK në muajin pasardhës, nëpërmjet Degës së Thesarit, sipas dokument kontabël Urdhër-Shpenzimeve, duke paguar në total shumën 1,925,285 leke ose 100% e vlerës së prokuruar sipas Kontratës nr. 273, datë 31.12.2019. Transaksionet per pagesat e kryera janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Urdhër –shpenzim per kontratën nr. 273, datë 31.12.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat / Dt.fat	Vlera e likujduar me tvsh	Nr.Dt Flete Hyrje Magazine
1.	12/02/2020	18	F.T. nr.15.dt.31/01/20	102,257	F.h nr.5 dt.31/01/2020
2.	25/03/2020	39	F.T nr.37.dt.29/02/020	263,737	F.h nr.11 dt.29/02/2020
3.	09/04/2020	46	F.T.nr.51dt.31/03/2020	400,082	F. h nr.17.DT31/03/020
4.	13/05/2020	60	F.T nr 71 dt.30/04/200	317,700	F.h nr.19 dt.30/04/020
5.	10/06/2020	73	F.T nr 90dt.31/05/020	325,877	F.h nr.24 dt 31/05/020
6.	10/06/2020	74	F.T nr.89dt.31/05/2020	52,992	F.h nr 25 dt.31/05/020
7	24/06/2020	91	F.T .nr 10dt.6/06/2020	462,640	F.h nr 30 dt.06/06/2020
Totali				1,925,285	0

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Nga dokumentacioni, rezulton se NA me Urdhër nr. 2, date 01.01.2020 të NA, ka ngritur Komisionine Pranimit të Mallit, përberë nga K.B.(kryetare) me detyre funksionale përgjegjëse sociale; X.K.(anëtar) me detyre funksionale kujdestar/infermier dhe kuzhinieri turnit (anëtar). Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43. UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Në Proces Verbalet, nuk ka pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9)lidhur me:

-Produktet koloniale (sheqer, oriz, etj..) përtreguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masënbruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të jetë jo me pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nëse furnizimi është nëpërputhje me standardin shtetëror të përcaktuar ne DST.

- Pranimin e perimeve dhe zarzavateve (patate, qepe, domate, etj), pranimin e frutave (mollë, portokalle, mandarina, dardha, pjeshkë dhe kajsi) nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar.

- Pranimin e bulmetrave (qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët) për furnizimin me djathë, Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhine paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit,masën bruto/ neto, dhe origjinë prodhimit.

- Per furnizimin me **veze** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEENr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregimit për vezët.

- Per furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipaskërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

- Per furnizimin me mish viçi nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Nga dokumentacioni rezulton se për korrektësinë e cilesinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit nuk është respektuar pranimi mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 273, datë 31.12.2019 neni 4.

Kontrata e furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019

Neni 4: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3:

Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimin e institucionit me ushqime, ta kryej sipaslistës se nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1).

Per furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor), nuk ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Hyrja e mallit në magazine bëhet me flete-hyrje, referuar faturës tatimore (mujore) të lëshuar nga OE. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, është firmosur jo nga komisioni i pranimit por vetëm nga furnitori dhe nga kuzhinierja. Nga auditimi konstatohet se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal me Kontraktorin për sasinë e mallit të pranuar, furnizuar pjesë-pjesë, dhe dokumentacion të përkohshëm, nuk ka evidentuar dokumentacionin e përkohshëm për pranimin e mallit, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik.

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi .

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletë-hyrja ose fletë-dalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithësisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme

➤ 2. Autoritet Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “E.C.” shpk, në baze të procedurave të prokurimit negociim pa shpallje, ka lidhur Kontratë Furnizimit “Blerje Ushqimesh” me nr.131 prot, datë 08.07.2020. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKMnr.924, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese.. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 785,620 leke (pa TVSH) dhe 942,744 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit. Sigurimi i kontratës në vlerën 94,154 leke ose 10% te çmimit te kontratës është bere nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve “A. sha” me Formularin e Sigurimit nr. Serial 058966, date 03.07.2020, me afat deri zbatimin e plote te kontratës.

Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re më datë 01.09.2020. Grafiku i lëvrimit të mallit:

a-Per ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes se kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; b-Per ushqimet që prishen si qumësht , djathë ,etj sipas kërkesave te autoritetit kontraktor. Malli do te merret ne dorëzim, kundrejt faturës tatimore origjinale nga proces verbali i marrjes ne dorëzim i mbajtur nga komisioni i ngritur per këtë qëllim.

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 4 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar nga AK në muajin pasardhës, nëpërmjet Degës së Thesarit, sipas dokument kontabël Urdhër-Shpenzimeve, duke paguar në total shumën në shume 942,744 leke ose 100% e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër-Shpenzimeve per realizmin e kontratës nr.131 prot, datë 08.07.2020

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat / Dt.fat	Vlera e likuaduar me tvsh	Nr. Fletë hyrjeve
1.	13/08/2020	18	F.T. nr.120.dt.31/07/020	355,879	F.h nr.37 dt.31.07.2020
2.	14/09/2020	133	F.T nr.128.dt.31/08/020	259,626	F.h nr. 46 dt 31/08/2020
3.	12/10/2020	150	F.t.nr.135dt.30/09/2020	108,720	F.h nr. 54 dt 30/09/020
4.	12/11/2020	181	F.t nr 152dt.31/10/2020	218,519	F.h nr. 72 dt.31/10/2020
Totali				942,744	

(Burimi: SHMSH Punoi: KLSH)

Titullari i Insitucionit me urdhrin nr.2 datë 01.01.2020 ka ngritur grupin e punës për pritjen dhe magazinimin e ushqimeve, grup i përbërë nga K.B.me detyre përgjegjëse sociale, X.K.me detyre Kujdestare/Infermiere dhe L.D.me detyre kuzhinierë.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, duke qënë se institucionmi ka punuar me staf te reduktuar, komisioni nuk ka qënë prezet, duke bërë të pamundur mbajtjen e procesverbalit nga ana e tij. Malli është marrë në dorëzim nga kuzhinierja e cila ka fimosur ne lidhje me sasinë e dorëzuar nga OE si dhe marrë nga AK, por pa deklaruar ne lidhje me cilësin e mallit për sigurmin e ushqimit referuar kontrtaës së lidhur si dhe në kundërshtim me:

-VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipaspërcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

-Kontrata e furnizimit nr. 131, datë 08.07.2020

Neni 5: Cilësia e Mallit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi.

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimin e institucionit me ushqime, ta kryej sipas listës së nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1).

Per furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor), nuk ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Hyrja e mallit në magazine bëhet me flete-hyrje, referuar faturës tatimore (mujore) të lëshuar nga OE.

Nga auditimi konstatohet se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal me Kontraktorin për sasinë e mallit të pranuar, furnizuar pjese-pjese, dhe dokumentacion të përkohshëm, nuk ka evidentuar dokumentacionine përkohshëm për pranimin e mallit, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi .

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletë-hyrja ose fletë-dalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme

➤ 3.Midis Autoritet Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve, Tiranë dhe Kontraktuesi “4 S shpk” shpk është lidhur Kontrata e Furnizimit “Blerje Bulmet” nr.117 prot, datë 23.06.2020. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur ne Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.924, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në , i ndryshuar dhe procedure së përqendruar të prokurimit të zhvilluar nga ABP sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 21/15, datë 04.06.2020 me afat 24 muaj dhe Autorizimit SHSSH për lidhje kontrate me nr. 21/16 prot, date 08.06.2020.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 03.03.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do te jete 796,500 leke (pa TVSH) dhe 955,800 leke (me TVSH). Sigurimi i kontratës në vlerën 10% te çmimit te kontratës është bere nga “E.” me nr.serie 070351810030048.

Cilësia e mallit do te jete sipas specifikimeve tëkërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit datë 23.06.2020, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re per vitin 2020.Grafiku i lëvrimit të mallit: -Per ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes se kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; -Per



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

ushqimet që prishen si qumësht, djathë, etj..., dy here ne jave sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; - Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesika faturuar mallrat e sjella me anë të 7 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 955,794 leke ose 100% e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Urdhëri – Shpenzim per Kontratën nr.117 prot, datë 23.06.2020

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat / Dt.fat	Vlera e likujduar me tvsh	Nr. Dt. Fletë Hyrje
1.	13/08/2020	119	F.t. nr.651 dt.31/07/020	132,060	F.h nr.41 dt.31/07/020
2.	14/09/2020	135	F.t nr.656 dt.31/08/020	143,454	F.h nr 47 dt 31/08/020
3.	13/10/2020	155	F.t nr.807dt.30/09/2020	118,140	F.h nr.40 dt30.09.2020
4.	09/11/2020	173	F.t nr 819 dt.31/10/200	137,280	F.h nr 66 dt.31/10/020
5.	8/12/2020	204	F.t nr 832 dt.30/11/020	124,092	F.h nr 83 dt.30/11/2020
6.	24/12/2020	227	F.t nr.501 dt.23/12/2020	114,348	F.h nr 102 dt.23/12/2020
7.	28/12/2020	229	F.t.nr503 dt.24/12/2020	186,420	F.h nr.104 dt.24/12/020
	Totali			955,794	

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimi të Mallit, i përberë nga K.B.me detyrë përgjegjëse sociale, X.K.me detyrë kujdestare/infermiere dhe L.D.me detyrë kuzhinjere me Urdhërin nr. 2, date 01.01.2020, i cili do të funksionojë për vitin 2020. Nga auditimit u konstatua se komisioni nuk ka mbajtur proces verbal/e per pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Gjithashtu Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimi te Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Proces Verbal/et duhet të pasqyrojnë të dhëna mbi treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Pranimin e bulmetrave , për furnizimin me djathë Proces verbal/et nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë per çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë te freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit te produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit. Gjithshtu malli nuk është shoqëruar me raport analiza fiziko-kimike, mikrobiologjike bazuar legjislacionin në fuqi si dhe bazuar në urdhrin nr.654 datë 23.12.2016

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3 dhe Kontrata e furnizimit nr. 178, datë 10.06.2019.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

fuqi”.

Kontrata e furnizimit nr. 117, datë 23.06.2020

Neni 5: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimi zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar nga ku nuk pati diferenca.

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimi institucionit me ushqime, bëhet sipas listës se nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1).

Për furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor) nga OE, nuk ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikimit fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Në Proces Verbalet e Pranimit (pjesore), për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine është firmosur vetëm nga kuzhinierja e turnit dhe OE. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore të lëshuar. Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Per Arkivat” dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave.

Zbatimi kontratave per vitin 2021

➤ 1.Midis Autoritet Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “D.P” shpk, është lidhur Kontrata e Furnizimit “Blerje Fruta Perime” nr.4 prot, datë 05.01.2021. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur ne Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.924, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe procedure së përqendruar të prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 03.03.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do te jete 680,250 leke (pa tvsh) dhe 816,300 leke (me tvsh). Sigurimi i kontratës në vlerën 10% te çmimit te kontratës është bere me kompaninë “E.” me numër serial 07..... .

Cilësia e mallit do te jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit datë 05.01.2021, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re per vitin 2021.Grafiku i lëvrimit të malli:

-Fruta dhe perimet do të lëvrohen një herë në jave sipas kërkesave të AK

-Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 13 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve ne shumen 816,300 leke ose 100% e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzime per likuidimin e kontratës nr.4 prot, datë 05.01.2021

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat / Dt.fat	Vlera e likujduar me tvsh	Nr.Dt e fletë hyrjes
1.	09.02.2021	33	f.t.nr.14.dt.03/03/021	2,040	F.h nr 13 dt.03/03/2021
2.	07.04.2021	43	f.t nr.88.dt.31/03/021	36,756	F.h nr 21 dt.31/03/2021
3.	10.05.2021	65	f.t. nr 136.dt.29.04/021	44,388	F.h nr.26 dt.2904/021
4.	07.06.2021	81	f.t nr.197.dt.29/05/021	46,968	F.h nr 39.dt.29/05/2021
5.	08.07.2021	106	f.t nr 250.dt.30/06/021	73,056	F.h nr 53.dt.30/06/021
6.	09.08.2021	121	f .t. nr.301dt.30/07/021	69,228	F.h nr 63.dt.30/07/2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

7	14/09/2021	142	f.t.nr.346.dt.31/08/021	85,260	F.H nr 74 dt.31/08/2021
8	12/10/2021	157	f.t. nr.411.dt.6/10/021	61,788	F.H nr 86dt.6/10/2021`
9	12/11/2021	192	f.t.nr 433dt.29/10/021	58,476	F.h nr 90 dt.29/10/2021
10	09/12/2021	211	f.t.nr 481dt.30/11/2021	80,088	F.hnr 111 dt.30/11/2021
11	20/12/2021	226	f.t.nr 510dt.18/12/2021	34,908	F.h nr123.dt 18/12/2021
12	28/12/2021	230	f.t.nr 514 dt.21/12/021	223,296	F.h nr127 dt.21/12/2021
Totali				816,300	

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.B.me detyrë përgjegjëse sociale; L.D.me detyrë kujdestare/infermiere dhe X.K.me detyrë kushiniere kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2021, i cili do të funksionojë për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021, ka mbajtur proces verbal per pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur per ketë qellim, përmbajnë listën e përgjithshme te produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit te furnizuar per këtë hyrje.

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit te Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale.

Por Proces Verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Pranimin e perimeve dhe zarzavateve , pranimin e frutave, nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror te miratuar.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipaspërcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Kontrata e furnizimitkontratës nr.4 prot, datë 05.01.2021

Neni 5: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi.

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimi institucionit me ushqime, bëhet sipas listës se nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1). Komisioni i Pranimit të Mallit për furnizimet e kryera,për çdo dorëzim malli (pjesor), ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore të lëshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

➤ Autoritet Kontraktor Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “S.T” shpk, në baze të procedurave të prokurimit, kanë lidhur Kontratë e Furnizimit “*Blerje mishi dhe nënproduktet e tij*” nr.87 prot, datë 05.07.2021. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKMnr.924, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të njoftimit nga ABP për lidhje kontrate me shkresën nr.42/3 date 17.06.2021.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 03.03.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 385,250 leke (pa TVSH) dhe 462,300 leke (me TVSH). Sigurimi i kontratës 10% të çmimit të kontratës është bere nëpërmjet shoqërisës së sigurimeve “A.” me Formularin e sigurimit nr. Serial 89196323.

Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit dhe përfundon 31.12.2021.

Grafiku i lëvrimit të mallit:

✓ Për të gjithë llojin e mishit duhet të shoqërohet me fletë znalize

✓ Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 6 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 4621,288 leke ose 100% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon:

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat /Dt.fat	Vlera e likuiduar me tvsh	Nr.Dt Fletë hyrje
1.	09.09.2021	136	F.t nr.99 dt.31/08/021	56,100	F.h nr 69 dt.31/08/2021
2.	12.10.2021	160	F.t nr.150 dt.30/09/021	51,936	F.h nr 77 dt.30/9/2021
3.	09.11.2021	182	f.t nr.208 dt,29.10/2021	87,450	F.h nr. 95dt.29/10/2021
4.	07.12.2021	207	F.t nr 280 dt.30/11/021	109,602	F.h nr.108 dt.30/11/2021
5.	20.12.2021	220	F.t 327 dt.15/12/2021	59,250	F.h nr 117 dt.15/12/2021
6.	28.12.2021	229	f.t nr 332 DT.20/12/2021	97,950	F.h nr 126 dt.20/12/2021
Totali				462,288	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.B. me detyrë përgjegjëse sociale; L.D. me detyrë kujdestare/infermiere dhe X.K. me detyrë kushiniere kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2021, i cili do të funksionojë për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qëllim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Por Proces Verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Për furnizimin me mish dhe nënprodukte të tij nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishit nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik, nëni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet apo sasi të prokuruar.

➤ Midis Autoritet Kontraktor Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “E.K” shpk, është lidhur Kontrata e Furnizimit “*Blerje Ushqimesh të ndryshme, mish dhe nënproduktet e tij, Bulmet dhe nënpeoduktet e tij, buke gruri*” nr.21 prot, datë 21.01.2021 nëpërmjet procedurës së prokurimit negocim pa shpallje kryer nga SHMT. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Sigurimi i kontratës në 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve “A. sha” me Formularin e sigurimit nr. Serial 60837, date me afat deri zbatimin e plote të kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 19.01.2021 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 1,131,225 leke (pa TVSH) ose 1,357,470 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e e lidhjes së saj, deri më 21.06.2021. Grafiku i lëvrimit të mallit:- Ushqimet e prokuruar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; - Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 7 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 1,357,470 leke ose 100% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon

Urdhër-Shpenzimeve për pagesë Kontratës nr. 21 prot, datë 21.01.2021

Nr	Data e shlyerjes	Nr.Urdher shpenzimit	Nr fat /Dt.fat	Vlera e likujduar me tvsh	Nr.Dt Fletë Hyrje
1.	12.02.2021	19	F.t nr.380.dt.29/01/021	20,805	F.h nr 3 dt.29/01/2021
2.	09.03.2021	32	F.t nr.15 dt.26.02.021	183,769	F.h nr 10 dt 26/02/2021
3.	06.04.2021	40	F.t. nr.28.dt.31/03.021	274,265	F.h nr 22 dt.31/03/2021
4.	10.05.2021	63	F.t nr.38 dt29/04/021	286,846	F.h nr 27 dt.29/04/2021
5.	07.06.2021	82	F.t nr.43 dt.28/05/021	333,234	F.h nr 38 dt.28/05/2021
6.	06.07.2021	101	F.t nr.51 dt.30/06/021	133,253	F.h nr 52 dt.30/06/2021
7	27/07/2021	110	F.t nr.53.dt.07/07/021	125,268	F.h nr 54 dt.07/07/2021
Totali				1,357,470	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.B.me detyrë përgjegjëse sociale; L.D.me detyrë kujdestare/infermiere dhe X.K.me detyrë kushiniere kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2021, i cili do të funksionojë për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qëllim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”



43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punësuar me përgjegjësi materiale.

Nga auditimit rezulton se Proces Verbalet nuk përmbajnë të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Pranimin e bulmetrave, Proces verbali që pranon furnizimin me djathë nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinë prodhimit,

- Per furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Per furnizimin me mish nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.-

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë edhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij, bulmetin dhe nënproduktet e tij si dhe buken e grurit. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje të çmimit të prokuruar apo sasinë.

Zbatimi i kontratave për vitin 2022

➤ Midis Autoritetit Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “D.D. shpk” shpk, është lidhur Kontrata e Furnizimit “Blerje Bulmet dhe nënproduktet e tij” nr.30 prot, datë 21.01.2022. Hartimi i kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Mareveshje Kuader ku të gjitha kushtet janë të caktuara. Sigurimi i kontratës 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve “A. sha” me Formularin e sigurimit nr. Serial 060722, me afat deri zbatimin e plotë të kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 28.04.2021 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 1,736,400 leke (pa TVSH) ose 2,083,680 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e lidhjes së saj, dhe përfundon më 31.12.2022.- Grafiku i lëvrimit të mallit do të jetë: Per ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor -Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë, etj dy herë në javë sipas kërkesave të AK. Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 6 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 1,583,556 leke ose 76% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon

Urdhër-Shpenzimeve per pagesë Kontratës nr. 281/3 prot, datë 18.01.2021

Nr	Urdhër shërbimi	Vlera e Likuiduar me TVSH	Nr.F.T /data faturës	Nr.dt Fletë hyrjes
1	U.sh 21 dt.815/02/2022	58,632	nr.678.dt.3101.022	F.h nr 5 dt.31/01/2022
2	U sh nr.36 dt.16/03/2022	109,716	nr.1462dt.28.02.022	F.h nr 14 dt.28/02/2022
3	U sh 61. Dt. 15/04/2022	122,556	nr2344.dt31/03/022	F.h nr 29 dt.31/03/2022
4	U sh nr.78dt.12/05/2022	122,376	nr.3122dt29.04/022	F.h nr.36 dt.29/04/2022
5	U sh nr.97dt.13/06/2022	128,484	nr.3996 dt31/05/022	F.h nr 54 dt 31/05/2022
6	U sh nr.119dt.19/07/2022	33,752	nr.4836dt.30/06/022	F.h nr 63 dt.30/06/2023
7	U sh nr 135 dt.18/08/2022	138,144	nr.5694dt.29/07/022	F. h nr.72 dt.29/07/2022
8	U.sh Nr. 159.dt. 15/9/2022	139,860	nr.6661 dt.01/09/022	F.h nr 90 dt.01/09/2022
9	U.sh nr.180 dt.13/10/2022	135,552	nr.7495 dt.30/09/022	F.h nr 98 dt.30/09/2022
10	U.sh nr.203 dt.14/11/2022	116,460	nr.8398 dt.31/10/022	F.h nr 113 dt.31/10/2022
11	U.sh nr.222 dt.12/12/2022	123,744	nr.9263 dt.30/11/022	F.h nr 129 dt.30/11/2022
12	U sh nr 240 dt.23/12/2022	88,680	nr.9801 dt.20/12/022	F.h nr 139 dt.20/12/2022
13	U sh nr 248 dt.28/12/2022	165,600	nr.9910 dt23/12/2022	F.h nr 148 dt.23/12/2022
	Totali	1,583,556		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga A.H.(kryetare) me detyrë përgjegjëse sektori; L.D.(anëtar) me detyrë kujdestare dhe X.K. kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2022, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2022 deri 31.12.2022, ka mbajtur proces verbal per pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur per këtë qellim, duhet të përmbajnë listën e përgjithshme te produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit te furnizuar per këtë hyrje.

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit te Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të përgjegjës materiale.

Nga auditimit rezulton se Proces Verbalet nuk përmbajnë të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Pranimin e bulmetrave, Proces verbali që pranon furnizimin me djathë nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë te freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit te produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinë prodhimit.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

fuqi”.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimi zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për bylmetin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet dhe sasi të e prokuruar.

➤ Autoriteti Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “S.T.” shpk, ka lidhur Kontrat Furnizimit “Blerje mishi dhe neproduktet e tij” nr.22 prot, datë 18.01.2022. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në procedurë e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Sigurimi i kontratës 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve “A. sha” me Formularin e Sigurimit nr. Serial 061819, me afat deri zbatimin e plote të kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 03.03.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 834,500 leke (pa TVSH) dhe 1,001,400 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit, dhe për vitin buxhetor përfundon në 31.12.2022.

Grafiku i lëvrimit të mallit sipas Nenit 6 të kontratës:

-Për të gjitha llojet e mishit duhet të shoqërohet me fletë analize

-Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 13 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shume 1,001,400 leke ose 100% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër-Shpenzimeve për Kontratën nr. 113 prot, date 21.06.2021

Nr	Urdhër Shpenzimi	Shuma e likuiduar	Nr.F.T /data	Nr.Dt fletë hyrje Magazinë
	Blerje Mish S. shpk			
1	U.Sh nr.16 dt.09/02/2022	27,150	nr.f.40. dt.31/01/022	F.h nr. 4 dt.31/01/2022
2	U.sh nr.37 dt.16/03/2022	67,350	nr.f. 84. dt.28/02/022	F.h nr. 17 dt.28/02/2022
3	U sh nr.62 dt 15/04/2022	75,420	nr.f.143 dt.31/03/022	F.h nr. 28. dt 31/01/2022
4	U sh nr.82. dt.23/05/022	113,250	nr.f.195.dt.29/04/022	F.h nr.41 dt.29/04/2022
5	U sh .nr 95 dt.7/6/2022	42,648	nr.f.266.dt.31/05/022	F.h nr.53 dt.31/05/2022
6	U sh .nr 118 dt.19/7/2022	79,572	nr.f.348.dt.30/06/022	F h nr. 65 dt.30/6/2022
7	U sh nr 136 dt.18/8/2022	47,700	nr.f.427dt.29/07/022	F.h nr. 75 dt.29/07/2022
8	U sh nr. 161.dt.22/9/2022	67,290	nr.f.507.dt.31/08/022	F.h nr.86 dt.31/08 2022
9	U.sh nr. 176 dt.13/10/022	101,400	nr.f.561.dt.29/09/022	F.h nr. 94 dt.29/09/2022
10	U sh nr.202 dt.14/11/2022	72,966	Nrf.653 dt.31/10/022	F.h nr. 114 dt.31/10/2022
11	U.sh nr. 223dt.12/12/022	100,872	nr.f.736 dt.30/11/2022	F h nr. 127 dt.30/11/2022
12	U sh nr 239 dt.22/12/2022	62,250	nr.f.788.dt.20/12/022	F h nr. 138 dt.20/12/2022
13	U sh nr 245 dt.27/12/2022	143,532	nr.f.806.dt.23/12/022	F.h nr. 147 dt.23/12/2022
	Totali	1.001.400		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga A.H.(kryetare) me detyrë përgjegjëse sektori; L.D.(anëtar) me detyrë kujdestare dhe X.K. kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2022, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2022 deri 31.12.2022, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qëllim, duhet të përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Komisioni pranimit ka mbajtur proces verbal për pranimitin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qëllim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Proces Verbali/et e pranimit të mallit nga OE nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

-Furnizimin me mish nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum, sipas DST.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3.

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditim zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet dhe sasinë e prokuruar.

➤ Midis Autoritet Kontraktor “Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Kontraktuesi “N. shpk”, është lidhur Kontrata e Furnizimit “Blerje Ushqime Kolonjale” nr.52 prot, datë 11.03.2022. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Marrëveshje Kuadër ku të gjitha kushtet janë të caktuara. Sigurimi i kontratës 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve “A. sha” me Formularin e sigurimit nr. Serial 060823, me afat deri zbatimin e plote të kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 03.03.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete 1,070,045 (pa TVSH) ose 1,284,045 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e lidhjes së saj, dhe përfundon më 31.06.2022.- Grafiku i lëvrimit të mallit do të jetë:

-Ushqimet kolonjale do të lëvrohen 1 herë në javë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktuar.

- Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 6 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 504,199 leke ose 39% e vlerës së kontratës, si rezultat i mos pasjes nevojë për furnizim (rezultat i pasjes gjendje në magazinë) si më poshtë vijon:

Urdhër-Shpenzimeve për pagesën e Kontratës nr. 52 prot, datë 11.03.2022



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Nr	Emertimi	Shuma e likujduar	Nr.F.T /data	Nr.Date fletë hyrje
	Blerje Kolonjale N. shpk			
1	U.Sh nr.42 dt17/03/2022	1,200	nr.92.dt.28.02/022	F.H nr 19 dt.28/02/2022
2	U.Sh. nr.57.dft12/04/022	9,456	nr.174.dt.31/03/022	F.H nr 26 dt.31/03/2022
3	U.Sh. nr. 80 19/05/022	42,458	nr.268.dt.29/04/022	F.H nr 40 dt.29/04/2022
4	U.Sh nr.99.dt 13/6/2022	166,641	nr.347.dt.31/05/022	F.H nr 56 dt.31/05/2022
5	U.Sh nr.113.dt 19/7/2022	220,674	nr.445dt.30/06/022	F.H nr 66 dt.30/06/2022
6	U.Sh nr.134 dt.18/8/2022	63,770	nr. 536.dt30/07/022	F.H nr 78 dt.30/07/2022
	Totali	504,199		

(Burimi: SHMT Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga A.H.(kryetare) me detyre përgjegjëse sektori; L.D.(anëtar) me detyrë kujdestare dhe X.K. kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 2, date 05.01.2022, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2022 deri 31.12.2022, ka mbajtur proces verbal per pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur per këtë qellim, dueht të përmbajnë listën e përgjithshme te produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit te furnizuar per këtë hyrje.

Urdhëri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit te Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Nga auditimit rezulton se Proces Verbalet nuk përmbajnë të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) .

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipaspërcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi per auditimi zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për ushqimet kolonjale. Nga krahasimi çmimeve të mallit te furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet dhe sasinë e prokuruar.

Nga sa trajtuar më sipër për të tre vitet 2020,2021 dhe viti 2022 u konstatua se:

- Nëpunësi Autorizues për vitin 2021 me Urdhër nr. 2, date 05.01.2021, ka ngritur Komisionin e Pranimit të Mallit, përberë nga K.B.(kryetare) me detyre funksionale përgjegjëse sociale, L.D.(anëtar) me detyre funksionale kujdestare/infermiere, X.K.me detyre funksionale kuzhinierë, grup pune i njëjte me grupi e vitin 2020, ngritur me urdhrin e titullarit nr.2 datë01.01.2020 . Për vitin 2022 me Urdhrin nr.2 datë 05.01.2022 NA ka ngritur Komisionin e Pranimit të Mallit nga A.H.(kryetare) me detyre përgjegjëse sektori; L.D.(anëtar) me detyrë kujdestare dhe X.K. kuzhinieri turni. Nëpunësi Autorizues për ngritjen e Komisionit të Pranimit te Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në



Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43. “Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale”.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim, të tilla si:

Proces Verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

Produktet koloniale përtreguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masënbruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të jetë jo më pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nëse furnizimi është nëpërputhje me standardin shtetëror të përcaktuar në DST.

Pranimin e perimeve dhe zarzavateve, pranimin e frutave, nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar.

Pranimin e bulmetrave për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/neto, dhe origjinën prodhimit,

Për furnizimin me vezë nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEENr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

Për furnizimin me mish dhe nënprodukte të tij nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinarë me të cilën vërtetohet se mishin nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

- Sa më sipër në kundërshtim me nenin *Neni 5: Cilësia e Mallit* “Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi”.

Sa më sipër Autoriteti Kontraktor (ndjekësi i kontratës) nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

- Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar se për vitin 2020 asnjë nga OE nuk ka dorëzuar certifikatat e cilësisë/ kontrollit të produktit të noterizuara apo origjinale, për asnjë nga produktet ushqimore, duke riskuar kështu në mos sigurinë e cilësisë së produktit. Për vitin 2021 dhe 2022, vetëm disa prej Operatorëve Ekonomik kanë sjellte certifikata por jo në mënyrë rigorozë si dhe në zbatim të specifikimeve teknike të vendosura në Kontratë neni 5 si dhe pika b e nenit 6 të cdo kontratë të lidhur me OE për ushqimet e cila citon se “Cilësia e mallrave do të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, ku në to kerkohet që:

-Mishi dhe nënproduketet e tij te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me Certifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare.

-Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi, Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

-Bulmeti dhe nënproduktet e tij Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit fiziko-kimikë të mësipërm. Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara...” etj

- Nga auditimit i likudimeve të kryera nga sa sekorti i finances, referuar urdher shpenzimeve për te gjithë OE të cilët kanë funizuar me Ushqim SHMT, grupi i auditimit konstatoi se mungonin situacionet mujore të funizimeve me ushqim ne sasi dhe vlerë e të firmosur nga komisioni i marrjes ne dorezim të mallit si dhe OE si dhe proces-verbali i marrjes në dorezim, i cili shërben si dokument vërtetues në kundërshtim me pikën 54 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ”Menaxhimi i Aktiveve të NJSP” e cila citon se : ”Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjese për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve të kontrates si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit” Urdhër shpenzimet për likudimin e ushqimeve, përmbanin vetëm faturën tatimore të dorëzuar nga OE si dhe fletëhyrja në magazinë e firmosur vetëm nga magazinieri.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

- Znj. A.P.në cilesinë e NA të institucionit.

- Znj. E.T.në cilësinë e NZ të institucionit

- Znj. A.H. me detyre punonjëse sociale, në cilesinë e kryetares së Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhërtë NA per vitin 2022.

- Znj. K.B.me detyre punonjëse sociale, në cilesinë e kryetares së Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhërtë NA per vitin 2020,2021.

- Znj. L.D.me detyre punonjëse sociale per periudhën ne cilesinë e anëtares se Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA per vitin 2020,2021,2022.

- Znj. X.K.me detyre punonjëse sociale per periudhën ne cilesinë e anëtares se Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA per vitin 2020,2021,2022.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit me shkresën nr. 156 date 06.12.2023 protokolluar ne KLSH me nr. 438/9 prot, date 07.12.2023 ka paraqitur observacion znj. E.T.përgjegjëse e Sektorit të Administratës, ne cilësinë financieres, referuar Projekt Raportit të Auditimit, shohim të arsyeshme të bëjmë me dije si më poshtë:

Drejtim Nr. 5: Mbi zbatimin e kontratave për blerje ushqimesh në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë (faqe 77-99).

- Për te gjitha kontratat e lidhura me marrëveshje kuadër 2-vjeçare për vitin 2020 dhe 2021 janë te realizuara ne mase 99% ,ndersa per vitin 2022 tek kontrata Blerje Ushqime Koloniale, kemi mosrealizim për arsye te përfundimit te marrëveshjes kuadër 2-vjeçare ,dhe është lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik te shpallur fitues nga ABP. Ne asnjë raste ne Shtëpinë e te Moshuarve Tirane nuk ka parur mbivendosje kontrata ushqime .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

- Komisioni i pritjes se mallit/shërbimeve e punëve te ngritur sipas vitit 2020,2021,2022 ka pare dhe ka mbajtur proces –verbal dhe ne mënyrë te përgjithshme kane thënë se janë ne sasi dhe cilësi te mire por nuk është shkruar qe kane ardhur sipas specifikimeve teknike te përcaktuar ne dokumentet e tenderit

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :

- Ne lidhje me sa është pretenduar, subjekti ka shprehur dakortësinë për mos mbajtje nga ana e grupit te marrjes ne dorëzim të mallit në mënyrën e saktë.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi ne procedurën e mbajtjes së dokumentacionit lidhur me zbatimin e kontratave për SHMT & SHMSH
Situata	<p>Grupi i audituesve të KLSH-se, për periudhën 01.01.2020 deri në periudhën 31.12.2022, në lidhje me procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes se kontratave të lidhura nga AK për “Blerje ushqimesh”.</p> <p>Lidhur me zbatimin e kontratave për SHM Tiranë blerje ushqimesh, referuar kontratës nr. 131, datë 08.07.2020; kontratës nr.177, datë 01.07.2020, kontratës nr. nr.273, dt. 01.01.2020; kontratës nr.5, dt. 05.01.2021; kontratës nr.21, datë 21.01.2021; kontratës nr.30, dt. 21.01.2022, kontratës nr.52, dt. 11.03.2022 dhe kontratës nr.22, datë 18.01.2022 dhe për SHM Shkodër referuar kontratës nr. 265, datë 01.2.2020; kontratës nr.264, datë 01.12.2020, kontratës nr.210, dt. 02.10.2020; kontratës nr.211, dt.02.10.2020; kontratës nr.17, datë 08.01.2021; kontratës nr.18, dt. 08.01.2021, kontratës nr.16, dt. 08.01.2021, kontratës nr.14, dt. 08.01.2021; kontratës nr.15, dt.08.01.2021; kontratës nr.250, datë 03.02.2022; kontratës nr.36, dt. 26.01.2022, kontratës nr.34, dt. 26.01.2022, kontratës nr.247, dt. 26.09.2022, kontratës nr.32, dt. 26.01.2022 dhe kontratës nr.33, datë 26.01.2022 nga auditimi dokumentacionit në dosjes/ve të zbatimit të kontratave rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisionin e Pranimit të Mallit ngritur me te posaçëm të NA, nuk ka përcaktuar si pjesë e komisionit magazinierin e institucionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43. - Proces Verbal/et, e pranimit të mallit perimeve dhe zarzavateve (patate, qepe, domate, etj.), pranimitin e frutave (mollë, portokall, mandarina, dardha, pjeshkë dhe kajsi), nuk kanë evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nuk kanë fletë analizë ne rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësore sipas standardit shtetëror te miratuar. Proces Verbal/et, pranimit të produktit mish/ të përpunuar i mishit (sallam, proshuta, etj.) nuk përmban të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinare, e cila do të vërtetonte sigurinë e produktit dhe vërteton se produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të DST. - Proces Verbal/et, pranimit të bulmetrave (qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët) për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit;</p> <ul style="list-style-type: none">- Për furnizimin me veze nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët;- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit; <p>Sa më sipër, rezulton se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të nuk është respektuar pranimiti mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni</p> <p>Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 4.</p>
Kriteri:	Kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”; Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe çdo akti ligjor në fuqi.
Ndikimi/Efekti:	Gjatë zbatimit të kontratës, procesi verbal i pranimit të mallit, nuk është shprehur mbi respektimin e pranimiti mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni 4.
Shkaku:	Komisioni i pranimit të mallit nuk ka njohuri/ kualifikim të mjaftueshme lidhur me zbatimin e kriterëve të përgjithshme/ specifike të prokurimit
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	-Autoriteti Kontraktor. gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatë/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>bazuar ne përputhje me standardet shtetërorë të te cilësisë dhe kritereve te kualifikimit të OE.</p> <p>-Këto dokumente duhet te evidentohen ne proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjese e dosjes së zbatimit të kontrtatës. Proces verbali të hartohet ne tre kopje, njëra prej te cilave te behet pjese e dosjes.</p>
--	---

Titulli i Gjetjes:	Mungesë dokumentacioni në dokumentat bashkëlidhur urdhershpenszimeve, SHM Tiranë
Situata	Nga auditimit i likudimeve të kryera nga sa sekorti i finances, referuar urdher shpenzimeve për te gjithë OE të cilët kanë funizuar me Ushqim SHMT, grupi i auditimit konstatoi se mungonin situacionet mujore të funizimeve me ushqim ne sasi dhe vlerë e të firmosur nga komisioni i marrjes ne dorezim të mallit si dhe OE si dhe proces-verbali i marrjes në dorezim, i cili shërben si dokument vërtetues në kundërshtim me pikën 54 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Menaxhimi i Aktiveve të NJSP" e cila citon se : "Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat pergjegjese per financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit".... Urdhër shpenzimet për likudimin e ushqimeve, përmbanin vetëm faturën tatimore të dorëzuar nga OE si dhe fletëhyrja në magazinë e firmosur vetëm nga magazinieri.
Kriteri:	Kriteret ligjore të përcaktuara në Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe çdo akti ligjor ne fuqi. Kontratat e lidhura me OE.
Ndikimi/Efekti:	Mos dokumentim i shpenzimit te kryer
Shkaku:	Mos zbatim i udhëzimit nr.30 datë 2.12.2011
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme nga ku në vazhdimësi për të gjitha urdhërshpenzimet mbi likuidimin e OE për shërbimin e funizimit me ushqim, duhet ë bashkëlidhë situacionet mujore të funizimeve me ushqim ne sasi dhe vlerë e të firmosur nga komisioni i marrjes ne dorezim të mallit si dhe OE si dhe proces-verbali i marrjes në dorezim.

Drejtimi 6: PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT.

A. Nivelit të kuotave për shpenzimet ditore të ushqimeve

Legjislacioni shqiptar, ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH", ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Në kuptim të ligjit ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, duhet të bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale (ligji 121/2016, neni 27 pika 3).

Ligji per t'u bërë i zbatueshëm, kërkon nxjerrjen e akteve të reja dhe deri në daljen e tyre, do te vazhdojnë te mbeten ne fuqi aktet nënligjore që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim më këtë ligj.(ligji 121/2016, neni 52 pika 3).

Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH".

Neni 24 pika 6: Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Neni 26 pika 2. Në çdo rast, metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre do të bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave

Neni 27 pika 3. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 53 pika 3 : Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Neni 52: Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.

2. Dispozitat apo pjesët e dispozitave të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, shfuqizohen.

3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj..

MShMS lidhur me zbatimin e standardeve të shërbimeve social shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelit e përcaktimit të tarifave nuk ka nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve 26, pika 2; 27 pika 3; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Në zbatim të këtij ligji mbeten ne fuqi dhe për tu zbatuar akte nënligjore më të hershme dhe të dala në zbatim të ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i shfuqizuar.

Të tilla akte nënligjore janë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” në të cilën përcaktohen standardet për shërbimet rezidenciale për të moshuarit; Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit ne qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, që miraton standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për të moshuarit. Lidhur me ushqyerjen nga institucioni rezidencial Standardi 8 kërkon :

Standardi 8

...”Të moshuarit duhet të marrin një dietë të plotë e të balancuar, ushqim të gatuar mirë e të servirur në mënyrë tërheqëse në ambiente të kënaqshme, në një kohë të përshtatshme për ta. Institucioni duhet të sigurojë një dietë të shumëllojshme dhe me vlera ushqimore në përputhje me nevojat dhe kërkesat personale të klientëve....”

Zbatimi e standardeve të miratuara, aktualisht rregullohet nga Udhëzimi MShMS Nr. 2005/4, datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit ne qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, i cili bazohet në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i shfuqizuar) duke synuar ofrimin e shërbimeve cilësore në përputhje me standardet e miratuara dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së përfituesve

Masa e shumës për shpenzime personale dhe niveli kuotave të shpenzimeve për ushqime për përfituesit e shërbimit rezidencial e komunitar janë përcaktuar VKM nr.518, datë 04.09.2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitimin e tyre, dhe masën e shumës për shpenzime personale”, kreu V.

MShMS për periudhën objekt auditimi për zbatim të VKM 518/2018 ka nxjerrë Udhëzimin e nr.689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” i cili në pikën 1 ka përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360⁴ lekë për person.

Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 5566 prot, datë 26.05.2023 në mbështetje të Urdhërit nr. 2595/1 prot, date 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit te punës për hartimin e propozimeve lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, në mbështetje të pikës 3 të Udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” ka llogaritur dhe ndryshuar normat ushqimore për Shtëpitë e të Moshuarve dhe Qendrat Polivalente, dhe ka hartuar dhe dërguar relacion në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbi kuotën ditore per grup moshën e trete nga 360 lekë/ditë bëhet 430 lekë/ditë, të cilat nderi në këtë fazë të auditimit nuk janë reflektuar në Udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Niveli kuotave për shpenzimet ditore të ushqimeve kërkon indeksimin e vjetor sipas kërkesave të VKM nr.518/2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitim të tyre, dhe masën e shumës për shpenzime personale”, paragraf 68-71.

VKM nr.518, datë 04.09.2018

Paragrafi 68: Subjekteve përfituese të shërbimit rezidencial publik, sipas përcaktimit të këtij vendimi, u jepet, për shpenzime personale, një shumë parash, si më poshtë vijon:

Gërma a: personave të moshuar që nuk kanë të ardhura, që janë të vendosur në shërbimin rezidencial për të moshuarit, 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj;

Paragrafi 70: Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

Paragrafi 71: Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.

Në nivelin e kuotës financiare për shpenzimet ditore ushqimore përfshihen edhe kuzhinierët dhe ndihmës kuzhinierët, që punojnë në këto institucione. Niveli kuotës për kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

Udhëzimi MSHMS 689/2018

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është:

- Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360 lekë..

Zbatimi kuotës ushqimore të ushqyerjes së të moshuarve bazohet në procedurën dhe dokumentacionin si më poshtë vijon:

✓ Titullari i institucionit me urdhër (pa numër) datë 06.01.2021 ka ngritur komisionin e përcaktimit të menisë javore (grupi multidisiplinar, në përputhje me Rregulloren e Brendshme e SHMT nr. 1570, datë 07.07.2016 miratuar nga Ministria e MSHMS.

✓ Ushqyerja bazohet në menu-javore, hartuar nga komisioni për përcaktimin e menisë javore, për tre vakte ngrënie, i përberë nga 6 anëtarë (5+1), përkatësisht përgjegjësjë e sektorit social

⁴ Shkresa e SHSSH nr.5566 prot, date 26.05.2023 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi “Normat ushqimore për Shtëpinë e të Moshuarve dhe Qendrat Polivalente” se bashku me Relacionin nr. 5566/1 prot, datë 26.05.2023 të grupit të punës në zbatim të Urdhërit nr. 2595/1 prot, date 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit te punës për hartimin e propozimeve lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

znj. A.H., mjeku i institucionit z. Y.J., 2 (kuzhinier) përkatësisht znj. L.D.dhe znj. L.I., 1 kujdestare përkatësisht znj. X.K, dhe një i moshuar z. M.S., miratuar nga titullari i institucionit.

✓ Raportimi ditor i forcës ditore për përgatitjen e menuse, kryhet nga Përgjegjësjë e Sektorit Social.

✓ Kuzhinierja e turnit harton “Kërkesë per Furnizim” duke përcaktuar sasinë dhe artikujt ushqimor, sipas forcës ditore të raportuar duke përcaktuar artikujt ushqimore te nevojshëm per përgatitje e vakteve të ushqyerjes.

✓ “Kërkesë per Furnizim” shërben si dokument bazë për miratimin e listës përfundimtare për artikuj ushqimore për konsum. Lista e artikujve miratuar evidentohet në dokumentin “Nxjerrja e produkteve ushqimore” për përlllogaritje e vlerës ditore për konsum dhe firmoset nga Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës (financierja) dhe kuzhinierja e turnit.

✓ Artikujt ushqimore bëhen dalje nga magazina, shoqëruar me flete –dalje firmosur nga magazinieri dhe marrësi ne dorëzim (kuzhinieri).

✓ Çdo ditë ushqimi gatuar konsumohet në mención e institucionit.

Për verifikimin e zbatimit e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për të moshuarit që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, u përzgjedhën për auditim praktikat dokumentare të hartimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit si më poshtë vijon⁵:

Për vitin 2020, për auditim u përzgjedhën me zgjedhje, hartimi menysë, flet-daljet e magazinës për muajin Shkurt, Prill, Shtator dhe Tetor .

Per vitin 2021 për auditim u përzgjedh me zgjedhje raportimi ditor i të moshuarve, hartimi menysë, flet-daljet e magazinës u përzgjedh muajt janar, shkurt, gusht, shtator.

Për vitin 2022 për auditim u përzgjedhën me zgjedhje, hartimi menysë, flet-daljet e magazinës për muajin Mars, Prill, Maj, Tetor, Nëntor, Dhjetor dhe rezultoi si më poshtë:

Zbatimi nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve

Periudha	Te moshuar	Personel	Përfituesit total	Kuota e miratuar (te moshuar)	Kuota e miratuar (personel)	Nevojat per konsumi mujor (te moshuar)	Nevojat per konsumi mujor (personel)	Nevojat per konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Shkurt 2020	1,309	60	1,369	360	216	471,240	12,960	484,200	418,873	(65,327)
Prill 2020	1,186	90	1,276	360	216	426,960	19,440	446,400	406,333	(40,067)
Shtator 2020	1,332	75	1,407	360	216	479,520	16,200	495,720	432,646	(63,074)
Tetor 2020	1,326	62	1,388	360	216	477,360	13,392	490,752	440,412	(50,340)
										- 218,808
Janar 2021	1,177	68	1,245	360	216	423,720	14,688	438,408	448,582	10,174
Shkurt 2021	1,093	88	1,181	360	216	393,480	19,008	412,488	406,563	(5,925)
Gusht 2021	1,249	35	1,284	360	216	449,640	7,560	457,200	416,170	(41,030)
Shtator 2021	1,262	41	1,303	360	216	454,320	8,856	463,176	414,778	(48,398)
										-85,179
Mars 2022	1,257	49	1,306	360	216	452,520	10,584	463,104	443,490	(19,614)
Prill 2022	1,266	64	1,330	360	216	455,760	13,824	469,584	444,707	(24,877)
Maj 2022	1,297	72	1,369	360	216	466,920	15,552	482,472	428,505	(53,967)
Tetor 2022	1,349	67	1,416	360	216	485,640	14,472	500,112	479,545	(20,567)
Nëntor 2022	1,313	54	1,367	360	216	472,680	11,664	484,344	460,518	(23,826)
Dhjetor 2022	1,350	66	1,416	360	216	486,000	14,256	500,256	505,080	4,824
										-138,027

(Burimi: SHM Tiranë Punoi: KLSH)

Për vitin 2020 në muajt e përzgjedhur per auditim përkatësisht shkurt, prill, shtator, tetor si dhe përmbledhësen mujore te konsumit faktik të ushqyerjes së të moshuarve, rezultoi se ka mospërputhje midis nevojës per konsum dhe konsum faktik përkatësisht:

⁵ Në kuotën ushqimore janë përfshirë ushqime të blera me fonde buxhetore dhe të dhuruara nga donator.



- për muajin Shkurt 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -5.399 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -65,327 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Prill 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -6.239 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -40,067 lekë me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Shtator 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -4.726 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -47,234 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Tetor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -5.324 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -50,340 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

Per vitin 2021 për muajt e përzgjedhur për auditim përkatësisht janar, shkurt, gusht, shtator si dhe përmbledhësen mujore të konsumit faktik të ushqyerjes së të moshuarve, rezultoi se ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik përkatësisht:

- për muajin Janar 2021 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -7.867 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 10,174 lekë/muaj me shumë se nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Shkurt 2021 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -3.023 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -5.925 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Gusht 2021 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri - 13,088 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 41,030 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

- për muajin Shtator 2021 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri – 5.282 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 48,398 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsumi mujor sipas kuotës së miratuar.

Për vitin 2022 për muajt e përzgjedhur për auditim përkatësisht mars, prill, maj, tetor, nëntor, dhjetor tetor si dhe përmbledhësen mujore të konsumit faktik të ushqyerjes së të moshuarve, rezultoi se ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik përkatësisht:

-për muajin mars 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri – 8.036 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -19,614 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsum mujor sipas kuotës së miratuar;

- për muajin prill 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri – 4.282 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 24,877 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsum mujor sipas kuotës së miratuar;

- për muajin maj 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri – 9.135 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -53,967 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsum mujor sipas kuotës së miratuar;

- për muajin tetor 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri – 5.926 lekë/ditë ose mospërputhja mujore -20,567 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsum mujor sipas kuotës së miratuar;

- për muajin nëntor 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri –5.527 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 23,826 lekë/muaj me pak nga nevojat për konsum mujor sipas kuotës së miratuar;

- për muajin Dhjetor 2022 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë deri -3.522 lekë/ditë ose mospërputhja mujore 4,824 lekë me shumë se nevojat për konsumi mujor sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

kuotës së miratuar. Ne tejkalim e kuotës së muajit dhjetor ndikojnë festat e fund vitit për datën 25 dhjetor me tejkalim 8,187 lekë/ditë dhe datën 31 dhjetor me tejkalim 12,651 lekë/ditë.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Për të moshuarit e vendosur në Shtëpitë e të Moshuarve Tiranë, ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, si më poshtë vijon:

- Për 4 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2020 të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar 218,808 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.

- Për 4 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2021 të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar 85,179 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.

- Për 7 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022 të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar 138,027 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.

Kjo mospërputhje tregon se nga njësia shpenzuese nuk ka zbatuar plotësisht nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqyerjes në institucionet publike rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, veprim në mospërputhje me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit të MSHMS nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

2. Ligji 121/2016, nenin 24 pika 6 kërkon nga Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerrjen e udhëzimit për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve. MSHMS, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me zbatimin e standardeve të shërbimeve sociale shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelit e përcaktimit të tarifave në zbatim të neneve 26, pika 2; 27 pika 3; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji. Aktualisht në zbatim janë standardet e miratuara me VKM nr.821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale” .

Udhëzimi MSHMS Nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” ka përcaktuar kuotat e ushqimit ditor në vlerë lekë, për të moshuarit në shtëpitë e të moshuarve, në vlerë 360 lekë;

VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, në paragrafin 71, përcakton se niveli kuotave në institucionet publike rezidenciale duhet të indeksohen çdo vit, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.

VKM 518/2018, paragrafi 71

Nivelet e kuotave në institucionet publike rezidenciale duhet të indeksohen çdo vit, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”

Sipas INSTAT indeksi i çmimeve konsumit ka pësuar ndryshim në rritje, për nëngrupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” për vitin 2020, 2021 dhe 2022, rritje e pa reflektuar në nivelet e kuotave për të moshuarit në institucionet publike rezidenciale. Mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për të moshuarit është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, vlera në lekë e përcaktuar për kuotën ditore për të moshuarit nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore si në vitin 2020 edhe në vitin 2021 dhe vitin 2022 .

Ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit⁶

COICOP		2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
000000	Gjithsej	2,0	1,9	1,6	1,9	1,3	2,0	2,0	1,4	1,6	2,0	6,7

⁶<http://www.instat.gov.al/al/temat/%C3%A7mimet/indeksi-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit/#tab2>

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË**

01.	Ushqime dhe pije joalkolike	2,4	4,2	2,2	4,3	3,3	3,9	2,7	2,9	3,6	3,9	11,8
01.1.	Ushqime	2,3	4,3	2,4	4,5	3,5	4,1	2,8	3,1	3,9	4,2	12,3
01.1.1.	Bukë dhe drithra	0,9	1,0	-1,2	-0,1	-0,9	0,1	-0,2	0,0	1,8	3,2	15,8
01.1.2.	Mish	2,2	1,0	0,1	0,1	-1,0	0,6	0,9	0,4	1,5	1,6	9,1
01.1.3.	Peshk	1,3	1,4	0,0	1,1	1,8	4,5	2,3	2,2	3,4	1,8	8,9
01.1.4.	Qumësht, djathë dhe vezë	4,8	0,9	0,6	-1,5	0,9	3,3	0,9	2,6	2,0	2,9	17,4
01.1.5.	Vajra dhe yndyrna	0,6	-0,2	-5,8	-1,1	0,4	-2,3	1,8	-0,2	4,0	6,7	24,1
01.1.6.	Fruta	11,7	11,7	10,9	15,0	17,4	11,3	5,6	5,2	15,2	5,2	3,0
01.1.7.	Zarzavate përfshirë patatet	-2,6	21,3	12,4	17,0	11,0	11,5	12,9	11,3	5,3	6,5	11,4
01.1.8.	Sheqer, recel, mjaltë, çokollata, dhe ëmbëlsira.	-0,2	-4,5	-3,7	0,8	3,0	2,5	-0,9	0,7	3,2	2,6	13,2
01.1.9.	Ushqime të tjera	1,2	0,1	-1,2	2,6	1,0	1,4	1,5	0,0	1,2	2,7	7,1
01.2.	Pije joalkolike	2,6	2,5	-1,8	0,0	-0,3	0,4	-0,1	-0,4	0,1	1,0	5,1
01.2.1.	Kafe, çaj dhe kakao	4,7	7,2	-2,5	-1,4	0,1	1,2	-1,2	-0,6	0,3	1,1	5,9
01.2.2.	Ujë mineral, pije të buta dhe lëngje	1,6	-0,1	-1,4	0,9	-0,5	-0,1	0,7	-0,3	0,3	0,8	3,8

(Burimi: INSAT)

Sipas Indeksi të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga INSAT, rezulton se nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkolike” ka pësuar rritje te indeksit mesatar per vitin 2020 rritje në masën 3.6% ,në vitin 2021 rritje në masën 3.9% dhe për vitin 2022 në masën 11,8%.

Grupi auditimit përlloraritit koston ditore per person, bazuar në ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT.

Ne bazë të përlloraritjeve per vitin 2020 rezulton se për çdo të moshuar kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak në vlerën 12.96 lekë.

Ne bazë të përlloraritjeve per vitin 2021 rezulton se për çdo të moshuari është llogaritur më pak për vlerën 14.04 lekë.

Ne bazë të përlloraritjeve per vitin 2022 rezulton se për çdo të moshuari kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për vlerën 42,48 lekë.

Indeksi i kuotës ditore të ushqimit të moshuarve

Viti	Kosto ditore	Indeksi	Ndikimi indeksit	Kosto ditore e indeksuar
	lekë/person	%	lekë/person	
2020	360	0,036	12,96	372,96
2021	360	0,039	14,04	374,04
2022	360	0,118	42,48	402,48

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Nga auditimi konstatohet se indeksi i Çmimeve të Konsumit të publikuar nga INSAT, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkolike” ka pësuar rritje te indeksit mesatar për vitin 2020 rritje në masën 3.6%, në vitin 2021 rritje në masën 3.9% dhe për vitin 2022 një rritje në masën 11.8% . Kjo rritje nuk është reflektuar në koston ditore të ushqyerjes se të moshuarve, efektet financiare të së cilës ndikojnë drejtpërdrejt në cilesinë e jetës se të moshuarve rezident në SHMT, Tiranë.

Grupi auditimit llogariti efektet e indeksimit të koston së ushqyerjes se moshuarve dhe në bazë të përlloraritjeve rezultoi se:

❖ Kosto vjetore për vitin 2020 rezulton se për të moshuarit kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 106,005 lekë.

❖ Kosto vjetore për vitin 2021 rezulton se për të moshuarit kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 137,812 lekë.

❖ Kosto vjetore për vitin vitin 2022 rezulton se për të moshuarit kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 560,356 lekë.

❖ Per të tre vitet objekt auditimit (2020,2021,2021) kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak ne shumen 804,173 lekë.

Kosto vjetore e ushqyerjes per të moshuarit (në lekë)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Viti	Kosto mujore/ person	kosto mujore e indeksuar	Ndryshimet	kostot vjetore	kosto vjetore e indeksaur	Diferenca
2020	360,00	372,96	-12,96	5.339.211	5.445.216	-106.005
2021	360,00	374,04	-14,04	5.323.172	5.460.984	-137.812
2022	360,00	402,48	-42,48	5.315.852	5.876.208	-560.356
Totali	1.080,00	1.149,48	-69,48	15,978,235	16,782,408	-804.173

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Per standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” si dhe në zbatim të tij Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, që miraton standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për të moshuarit. Lidhur me mjediset e banimit nga institucioni rezidencial Standardi 10 kërkon :

Standardi 10 Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj

.... Standarde minimale të akomodimit në qendër janë: ”Dhoma gjumi me një sipërfaqe të përdorshme prej 12 m² për dhomat me dy shtretër dhe 18 m² për dhomat me tre vende. Dhomat duhet të jenë të rregullta, të lejojnë lëvizjen, manovrimin dhe rrotullimin e karrigeve me rrota dhe të pajisjeve të tjera për ecjen.

Banjo për çdo dhomë me dy vende, ose 1 në çdo dy dhoma me një vend, që të lejojnë hyrjen dhe lëvizjen me karrige me rrota; Sinjale për thirrjet e urgjencës, shërbimet higjienike për çdo shtrat; Vendosja e sistemeve të ngrohjes gjatë dimrit dhe të freskimit gjatë verës”....

Referuar standardeve të sipërpërmendura, grupi i auditimit referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik konkludoi se asnjë nga tre standardet e mësipërme nuk është respektuar, standarde të cilat ruajnë higjienën, si dhe janë kushte minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Dhomat e të moshuarve në total janë 23 dhoma nga të cilat 5 dhoma treshe, 12 dhoma dyshe dhe 6 dhoma njëshe ishin treshe ose dyshe. Grupi i auditimit konstatoi se nuk respektohet standardi i sipërpërmendur në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale por një banjë shfrytëzohet nga minimumi 3 vetë deri në 5 vetë. Gjithashtu, nga 23 dhoma, vetëm tre dhoma ishin të pajisura me konditioner për të siguruar ftohjen e ambientit, 20 dhomat e tjera jo. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin *Sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.*

Konkluzion:

1-Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për të moshuarit është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, në mospërputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, paragrafi 71. Grupi i auditimit llogariti efektet e indeksimit të koston së ushqyerjes së moshuarve dhe në bazë të përlllogaritjeve rezultoi se kosto vjetore për vitin 2020 për të moshuarit është llogaritur më pak për vlerën 106,005 lekë, kosto vjetore për vitin 2021 rezulton se për të moshuarit kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 137,812 lekë, kosto vjetore për vitin vitin 2022 është llogaritur më pak për vlerën 560,356 lekë.

2- Vlera në lekë e përcaktuara për kuotën ditore për të moshuarit nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore që duhet të konsumojnë të moshuarit, për shkak të mos respektimit të vlerës së kuotës ushqimore nga institucioni dhe mos indeksimit të kuotës ushqimore sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT. Për pasojë vlera e kuotës së ushqyerjes së moshuarve në



vitin 2020, vitin 2021 dhe vitin 2022, për muajt e përzgjedhur ka qenë në vlera me të ulëta se kuota e miratuar, përgjegjësi kjo e SHMT Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e MSHMS.

3- Organizimi të ushqyerit të moshuarve mbështetet vetëm në miratimin e kuotës ushqimore. Hartimi i menisë së ushqyerjes së moshuarve nuk ka përcaktuar një normë ushqyerje sipas kartelave mjekësore të secilit nga të moshuarve duke i ndarë në grupe, nuk ka të përcaktuar k/kaloritë duhura që duhet të marrë secili prej tyre, nuk përputhet me kërkesat e Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 27 pika 3 dhe 4-VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Per standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, standardit 8 “Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre” si dhe pika 8 e Udhëzimit të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” .

Standardi 8 Shtëpia Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre

..... Ushqyerja bëhet në përputhje me kërkesat dietike individuale dhe kërkesat ushqimore të moshës; Për klientë me kërkesa dietike të veçanta ka ushqim dietik.....

4- Titullari i institucionit me urdhër datë 06.01.2021 ka ngritur komisionin e përcaktimit të menisë javore përbërë nga 2 kuzhinierët, mjeku, kujdestari, përgjegjësi social i sektorit si dhe një i moshuar. Çdo javë grupi i punës ka hartuar meninë javore të cilën ja paraqet kuzhinierëve. Nga auditimi rezultoi se në përcaktimin e menisë janë vendosur vetëm preferencat e ushqimeve, por pa i konvertuar ato në kuota, për të ditur nëse plotësohej kuota prej 360 lekë/ditë e miratuar për konsumin ushqimor nga të moshuarit.

Gjithashtu nga grupi i auditimit u konstatua se planifikimi bëhet vetëm një dietë ushqimore edhe pse të moshuarit kanë diagnoza të ndryshme mjekësore. Mjeku i institucionit nuk ka përcaktuar menu specifike në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik sipas sëmundshmërisë të të moshuarit, në kundërshtim me pikën 8.1 të Udhëzimit Nr. 2005/4, datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” të Ministrisë së MSHMS (ish-Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)

8. Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre.

8.1 Ushqyerja duhet të bëhet në përputhje me kërkesat dietike individuale dhe kërkesat ushqimore të moshës në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1. znj. R.X..në cilesinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror.
2. znj. A.P.në cilesinë e NA të institucionit.
3. znj. E.T.në cilesinë e NZ të institucionit
4. z.Y.J. me detyrë mjekë institucioni në cilesinë mjekut të institucionit, pjesë e grupit multifunksional dhe personi ngarkuar me përgjegjësi për e përcaktimit të dietave specifike për meninë e ushqyerjes së të moshuarve.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit me shkresën nr. 156 date 06.12.2023 protokolluar në KLSH me nr. 438/9 prot, date 07.12.2023 ka paraqitur observacion znj. E.T.përgjegjëse e Sektorit të Administratës, në cilësinë financieres dhe z. Y.J. në cilësinë e mjekut të institucionit (Part/Time 4 ore/dite) për nivelin e kuotave për shpenzime ditore, trajtuar në drejtimin nr. 6 (faqe 102-105 te Projekt Raportit te Auditimit. Në pretendimet e ngritura në shkresën e sipër cituar arsyetohet se :

1-Ndikimi në mosrealizimin e kuotës për periudhën e audituar shkak janë: a) Çmimet e vendosura nga ABP me marrëveshje kuadër 2-vjeçare janë me të ulëta se çmimet e vendosura



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

INSTAT; b) Për periudhën e auditimit për faktin se kemi patur 9-raste donator, nga magazine është bere dalje vetëm 40% se kuotës ditore; c- Cilësia dhe sasia e ushqimit nuk është cenuar për asnjë moment, menuja përgatitet nga një grup i përberë nga gjashte persona dhe për çdo rast është respektuar cilësia dhe sasia

2-Ne baze te Udhëzimit nr.662 dt.6/12/2022 për vitin 2023 ka ndryshim te kuotës dhe te menuse ushqimore ku është e përcaktuar tre vakte dhe dy mesore.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë pretendimet e paraqitura nga znj. E.T.dhe mjeku z. Y.J., duke arsyetuar si me poshtë:

1-Realizimi i kuotës ditore të ushqyerjes së të moshuarve është detyrim ligjor sipas dispozitave të Udhëzimit nr.689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” i cili në pikën 1 ka përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve, në 360 lekë për person, e pa respektuar plotësisht në institucionin tuaj.

3- Ne argumentet e paraqitura ju parashtroni se keni patur edhe dhurime nga donatore (per 9 raste) për ushqyerjen e të moshuarve, për të cilat ju keni bere dalje nga magazina 40% të kuotës ditore, pasi pjesa tjetër ose 60% u mbulua nga donatore, për të cilën ju nuk dispononi asnjë dokumentacion vërtetues.

2- Respektimi i sasisë dhe cilësisë se përgatitjes se menuse duhet te respektohet jo vetëm në numrin e vakteve por dhe ne kuote ditore 360 leke/ dite për çdo person, e cila nuk rezultoi te jete respektuar nga ju ne çdo rast.

3- Udhëzimit nr.662 dt.6/12/2022 nuk shtrin efektet ne periudhën objekt auditimi.

Sa më sipër grupi i auditimit pretendimet e parashtruara nuk pranohen, si të pa mbështetura në prova dhe ligj.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mos respektimi kuotës ditore ushqimore për të moshuar 360lekë/ ditë për person</i>
Situata	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe pikës 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” ka nxjerrë Udhëzimin e nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, i cili në pikën 1 ka përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë në ditë për person, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve. Udhëzimi nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, si akt nënligjor për metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe nivelin e tyre, nuk është bërë me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, në kundërshtim më kërkesat e nenit 26 pika 2 të Ligjit nr. 121/2016, “Për



ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 5566 prot, datë 26.05.2023 në mbështetje të Urdhërit nr. 2595/1 prot, date 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit te punës për hartimin e propozimeve lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, në mbështetje të pikës 3 të Udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” ka llogaritur dhe ndryshuar normat ushqimore për Shtëpitë e të Moshuarve dhe Qendrat Polivalente dhe ka hartuar dhe dërguar relacion në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbi kuotën ditore per grup moshën e trete nga 360 lekë/ditë bëhet 430 lekë/ditë, të cilat nderi në këtë fazë të auditimit nuk janë reflektuar në Udhëzimin nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e përcaktimit te tarifave të shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kundërshtim me kërkesat e nenit neni 46 pika 3 germa “a”, dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Organizimi të ushqyerit të moshuarve mbështetet vetëm në miratimin e kuotës ushqimore. Hartimi i menusë së ushqyerjes së moshuarve nuk ka përcaktuar një normë ushqyerje sipas kartelave mjekësore të secilit nga të moshuarve duke i ndarë në grupe, nuk ka të përcaktuar k/kaloritë duhura që duhet të marrë secili prej tyre, nuk përputhet me kërkesat e Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 27 pika 3 dhe 4-VKM nr. 821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve te përkujdesit shoqëror, për të moshuarit ne qendrat rezidenciale”, standardit 8 “Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre” si dhe pika 8 e Udhëzimit të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” .

Planifikimi ushqyerjes bëhet vetëm një dietë ushqimore edhe pse te moshuarit kanë diagnoza të ndryshme mjekësore. Mjeku institucionit nuk ka përcaktuar menu specifike në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik sipas sëmundshmërisë të të moshuarit, në kundërshtim me pikën 8.1 të Udhëzimit Nr. 2005/4, datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit ne qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” të Ministrit të MSHMS (ish-Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)

2- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk nxjerrë akte nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 pika 6 dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ne mungesë të nxjerrjes së akteve nënligjore institucionet kanë zbatuar standardet e miratuara me VKM nr.821, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale” .</p> <p>3- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë., në kundërshtim me kërkesat e nenit neni 46 pika 3 germa “b”, dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>4- Në institucionet publike rezidenciale për të moshuar ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për të moshuarit.</p> <p>Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar më pak se kuota e miratuar 360 lekë/ për person në ditë, për vitin 2020 në total 218,808 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur, për vitin 2021 në total 85,179 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur për auditim dhe për vitin 2022 në total 138,027 lekë/muaj për 7 muajt e përzgjedhur për auditim</p> <p>Në institucionin publik rezidencial Shtëpia e të Moshuarve Shkodër rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës në 4 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2020 kanë konsumuar në total 95,090 lekë/muaj me shumë se kuota ushqimore, për 4 muajt e përzgjedhur për vitin 2021 kanë konsumuar -23,976 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore dhe për 5 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022 kanë konsumuar -36,335 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.</p> <p>Mos zbatimi i nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë për person nga Shtëpia e Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, është në papajuteshmëri me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.</p>
Kriteri:-	<p>Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”.</p> <p>VKM nr.821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”.</p> <p>Udhëzimi MSHMS nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, për nivelin e miratuar i kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve, sipas grup moshës së tyre.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mos respektimi shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve 360 lekë në ditë për person, rezultoi si në vlerë ditore dhe mujore, reflektohet në uljen e konsum ushqimor nga të moshuarit e vendosur në këto institucione publike rezidenciale.</p>
Shkaku:	<ol style="list-style-type: none">1. Mos nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 121/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.2. Mos respektimi i kuotës ushqimore për të moshuar miratuar nga Udhëzimin e nr.689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, pika 1 .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Rëndësia:	Mosrespektimi kuotës ditore për ushqim për të moshuar dhe mos indeksimi saj janë në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që kanë marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion.
Rekomandime:	<p>1- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të menjëhershme për miratimin e një ndryshimeve të nivelin e kuotës ushqimore në ndryshimet e Udhëzimit nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe miratimin e Manualit mbi propozimet e grupit të punës lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesjes shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, për miratimin e normative ushqimore dhe ushqyerjes së grup moshën e tretë sipas kërkesave të nenit 23.4, neni 46.2 dhe neni 51.3 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>2- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqëror për të moshuar, sipas kërkesave të nenit 24 pika 6 dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>3- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, sipas kërkesave të nenit 26 pika 3 të 51 pika 3 të Ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.</p> <p>4- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë., sipas kërkesave të nenit neni 46 pika 3 germa “b”, dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, të marrin masa për ndjekjen zbatimin e kuotës ushqimore ditore në fuqi të çdo përfituesi.</p>

Titulli Gjetjes:	i	<i>Mos indeksim i kuotës ditore ushqimore për të moshuar 360lekë/ ditë për person</i>
Situata		1- Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për të moshuarit është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, në mospërputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërorë komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, paragrafi 71. Grupi i auditimit llogariti efektet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

	<p>mosindeksimit të kostos së ushqyerjes së moshuarve dhe në bazë të përlllogaritjeve rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë efektet e mosindeksimit të kostos së ushqyerjes së moshuarve për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 106,005 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 137,812 lekë dhe për vitin 2022 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 560,356 lekë. Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 69,897 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 1,476,222 lekë, për vitin 2022 rezultoi kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 1,941,773 lekë.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”.</p> <p>VKM nr.821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”.</p> <p>VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.</p> <p>Udhëzimi MSHMS nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, për nivelin e miratuar i kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve, sipas grup moshës së tyre</p>
Ndikimi/Efekti:	<p><i>Mos respektimi shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve 360 lekë në ditë për person, rezultoi si në vlerë ditore dhe mujore, reflektohet në uljen e konsum ushqimor nga të moshuarit e vendosur në këto institucione publike rezidenciale.</i></p>
Shkak:	<p>1. Mos nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 121/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.</p> <p>2. Mos respektimi i kuotës ushqimore për të moshuar miratuar nga Udhëzimin e nr.689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, pika 1 .</p>
Rëndësia:	<p>Mosrespektimi kuotës ditore për ushqim për të moshuar dhe mos indeksimi saj janë në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që kanë marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion.</p>
Rekomandime:	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të parashikimit të fondeve buxhetore edhe si efekt i indeksimit vjetor të kuotave të shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve në përputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, duke siguruar jetese të qete dhe me dinjitet në të përditshmen e tyre.</p>



Titulli Gjetjes:	i	Mos Plotesim i Standardeve nga SHM Tiranë dhe Shkodër
Situata		<p>Lidhur me mjediset e banimit në institucionet rezidenciale, referuar_VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” si dhe në zbatim të tij Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, nga grupi i auditimit u kryen verifikimi në zbatim të Standardit nr.10 i cili citon se “Standardi 10 Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj.</p> <p>... Standarde minimale të akomodimit në qendër janë: ”Dhoma gjumi me një sipërfaqe të përdorshme prej 12 m² për dhomat me dy shtretër dhe 18 m² për dhomat me tre vende. Dhomat duhet të jenë të rregullta, të lejojnë lëvizjen, manovrimin dhe rrotullimin e karrigeve me rrota dhe të pajisjeve të tjera për ecjen.</p> <p>Banjo për çdo dhomë me dy vende, ose 1 në çdo dy dhoma me një vend, që të lejojnë hyrjen dhe lëvizjen me karrige me rrota; Sinjale për thirrjet e urgjencës, shërbimet higjienike për çdo shtrat; Vendosja e sistemeve të ngrohjes gjatë dimrit dhe të freskimit gjatë verës”.... nga ku u konstatua se:</p> <p>Për SHMT: grupi i auditimit referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik konkludoi se asnjë nga tre standardet e mësipërme nuk është respektuar, standarde të cilat ruajnë higjienën, si dhe janë kushte minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Dhomat e të moshuarve në total janë 23 dhoma nga të cilat 5 dhoma treshe, 12 dhoma dyshe dhe 6 dhoma njëshe ishin treshe ose dyshe. Grupi i auditimit konstatoi se nuk respektohet standardi i sipërpërmendur në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale por një banjë shfrytëzohesh nga minimumi 3 vetë deri në 5 vetë. Gjithashtu, nga 23 dhoma, vetëm tre dhoma ishte të pajisura me kondicioner për të siguruar ftohjen e ambientit, 20 dhomat e tjera jo. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin <i>Sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.</i></p> <p>Për SHMSH: Referuar standardeve të sipërpërmendura, grupi i auditimit referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik konkludoi se asnjë nga tre standardet e mësipërme nuk është respektuar, standarde të cilat ruajnë higjienën, si dhe janë kushte minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Dhomat e të moshuarve në total janë 41 dhoma nga të cilat 14 dhoma njëshe, 25 dhoma dyshe dhe 2 dhoma katërshe. Grupi i auditimit konstatoi se nuk respektohet standardi i sipërpërmendur në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale por një banjë shfrytëzohesh nga minimumi 5 vetë deri në 20 vetë. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin <i>Sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.</i></p>
Kriteri:		referuar_VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” si dhe në zbatim të tij Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Ndikimi/Efekti:	Mos plotësim i kushteve për të moshuarit.
Shkaku:	Mos zbatim i standardit nr.10 “Standardi 10 Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandime:	Të dyja institucionet, SHMT & SHMSH të marrin masa ku të plotësojnë nevojat minimale të kujdesit personal për të moshuarit rezident si dhe të sigurojnë vendosjen e sinjaleve për thirrje urgjence në për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat në mënyrë që shërbimi ndaj tyre të jetë sa më efikas, eficient dhe i sigurt.

Në përfundim të auditimit rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 51 pika 1, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 23, pika 3; nenit 46, pika 2 të këtij ligji për shpenzime personale, që ju jepen përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar. Neni 51 pika 3 ka ngarkuar Ministrin përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë Udhëzim të Përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, në zbatim të 46, pika 3, të këtij ligji, për tarifën e shërbimeve publike të financuara nga buxheti i shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në nenin 23 pika 4 ka përcaktuar se personat që përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike kundrejt pagesës së një tarife të cilat sipas nenit 46 pika 3 kërkon nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministrit të Financave .

Nga auditimi rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në shkelje të afateve ligjore të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë plotësisht pagesat e tarifave e shërbimit dhe përfitimin e shpenzimeve personale për personat rezidentë në shtëpitë e të moshuarve, në mospërputhje me nenin 23 pika 3 dhe neni 23 pika 4 dhe neni 46 pika 3 germa “a” të këtij ligji.

Në mungesë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 23, pika 3 dhe nenit 46 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, institucioni/et kanë zbatuar aktet nënligjore në fuqi duke llogaritur, ndaluar dhe derdhur çdo muaj në thesar të ardhurat e mbledhura nga të moshuarit rezident 40% të pensionit mujor sipas dispozitave të VKM nr. 840, datë 3.12.2014 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, e cila për disa të moshuar ka rezultuar edhe me pak se minimumi i shpenzimeve personale 6,000 lekë në muaj që disa prej tyre përfitojnë sipas kriterëve të VKM 518/2018. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masat e duhura për plotësimin e kuadrit nënligjor për



funksionimin më të mirë të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke hartuar dhe propozuar akte ligjore e nënligjore për zbatimin të nenit 23.3 dhe nenit 23.4 dhe nenit 46 pika 2 dhe të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, për përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 23, të Ligjit nr. 121/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe pikës 71, të kreut V, të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” ka nxjerrë Udhëzimin nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, i cili në pikën 1 ka përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë në ditë për person, për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve. Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, si akt nënligjor për metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe nivelin e tyre, nuk është bërë me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministrit të Financave, në kundërshtim më kërkesat e nenit 26 pika 2 të Ligjit nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 5566 prot, datë 26.05.2023 në mbështetje të Urdhërit nr. 2595/1 prot, date 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e propozimeve lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesjes shoqërore” sipas projekt studimit “Si të ushqehemi në Moshën e Tretë”, në mbështetje të pikës 3 të Udhëzimit nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” ka llogaritur dhe ndryshuar normat ushqimore për Shtëpitë e të Moshuarve dhe Qendrat Polivalente dhe ka hartuar dhe dërguar relacion në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbi kuotën ditore për grup moshën e trete nga 360 lekë/ditë bëhet 430 lekë/ditë, ndryshime të cilat deri në këtë fazë të auditimit nuk janë amenduar në Udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” dhe zbatohen në ushqyerjen e të moshuarve në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër dhe Tiranë.

Hartimi i menisë së ushqyerjes së të moshuarve nuk ka përcaktuar një normë ushqyerje duke i ndarë në grupe sipas kartelave mjekësore të secilit të moshuar nuk ka të përcaktuar k/kaloritë e duhura që duhet të marrë secili prej tyre, nuk përputhet me kërkesat e Ligjit nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 27 pika 3 dhe 4-VKM nr. 821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, standardit 8 “Vaktet e ngrënies dhe orari i tyre” si dhe pika 8 e Udhëzimit të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” .

Planifikimi ushqyerjes bëhet vetëm një dietë ushqimore edhe pse të moshuarit kanë diagnoza të ndryshme mjekësore. Mjeku i institucionit nuk ka përcaktuar menu specifike në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik sipas sëmundshmërisë të të moshuarit, në kundërshtim me pikën 8.1 të Udhëzimit Nr. 2005/4, datë 04.12.2009 “Për



zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore” të Ministrisë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 2.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të nivelit të kuotës ushqimore referuar Udhëzimit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “*Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 2.2: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe miratimin e Manualit mbi propozimet e grupit të punës lidhur me menutë ditore të përfituesve në institucionet publike rezidenciale komunitare të përkujdesit shoqërore” sipas projekt studimit “*Si të ushqehemi në Moshën e Tretë*”, për miratimin e normative ushqimore dhe ushqyerjes së grup moshës së tretë sipas kërkesave të nenit 23.4, neni 46.2 dhe neni 51.3 të Ligjit nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka nxjerrë akte nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit për kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nuk ka nxjerrë akte nënligjore lidhur me mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 pika 6, neni 46 pika 3 germa “a”, dhe 51 pika 3 të Ligjit Nr. 121/2016 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*”. Në mungesë të nxjerrjes së akteve nënligjore institucionet kanë zbatuar standardet e miratuara me VKM nr.821, datë 6.12.2006 “*Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale*”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 3.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e standardeve për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqërore për të moshuar, për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre, për nxjerrjen e akteve nënligjore mbi mekanizmat e financimit për dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASAT ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për të moshuarit është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që marrin të moshuarit përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, në mospërputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “*Për shërbimet e kujdesit*



shoqërore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, paragrafi 71. Grupi i auditimit llogariti efektet e mosindeksimit të kostos së ushqyerjes së moshuarve dhe në bazë të përlllogaritjeve rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë efektet e mosindeksimit të kostos së ushqyerjes së moshuarve për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 106,005 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 137,812 lekë dhe për vitin 2022 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 560,356 lekë.

Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër për vitin 2020 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 69,897 lekë, për vitin 2021 kosto vjetore është llogaritur më pak për vlerën 1,476,222 lekë, për vitin 2022 rezultoi kosto vjetore për ushqim është llogaritur më pak për vlerën 1,941,773 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa të parashikimit të fondeve buxhetore edhe si efekt i indeksimit vjetor të kuotave të shpenzimeve personale dhe shpenzimeve ditore të ushqyerjes së të moshuarve në përputhje me VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, duke siguruar jetese të qete dhe me dinjitet në të përditshmen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në tre raste për të moshuarit e vendosur në institucionin rezidenciale publike, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor rezulton më pak se kuota 6,000 lekë/muaj, që ata do të përfitonin sipas kriterëve të VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Kreu V, paragrafi 68, germa “a” në rast se të moshuarit nuk do të gëzonin pension pleqërie. Ndërsa në katër raste pjesa e mbetur e pensionit mujor rezultoi në kufijtë e kuotës 6,000 lekë në muaj ose pothuajse e barabartë me të njëjtën shumë që ata do të përfitonin në rast se nuk do të gëzonin pension pleqërie.

Nga auditimi rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, në 16 raste për të moshuarit e vendosur në këtë institucion rezidenciale publik, pas derdhjes në buxhet të pjesës takuese të pensionit të pleqërisë, pjesa e mbetur e pensionit mujor rezulton më pak se 6,000 lekë/muaj që përfitojnë 16 të moshuar të tjerë si kuotë për shpenzimet personale, sipas kriterëve të VKM nr. 518, datë 04.09.2018, duke cenuar parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, përcaktuar në nenin 4 germa e të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Nga auditimi rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, për të moshuarit e vendosur në këtë qendër rezidenciale në katër raste institucioni ka llogaritur, mbajtur dhe derdhur në buxhet **tarifën 40% mbi pensionin social që ata kanë përfituar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**, pasi ata nuk zotërojnë asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, nuk kanë të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që sigurohen nga pensioni social. Ndalesa dhe derdhja në buxhet e tarifës 40 % të shumës mujore e pensionit social, bie ndesh me pikën 2 të VKM Nr. 898, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të perkujdesit shoqëror”, pasi kjo dispozitë nuk parashikon ndalese dhe derdhje në buxhet të të ardhurave të përfituara nga pensioni social që të moshuarit përfitojnë për të përballuar nivelin



minimal të jetesës. sipas nenit 5/1 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 2.1: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masat e nevojshme duke ofruar sistem të unifikuar rregullash për t’u zbatuar në aplikimin e tarifave që paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror në qendrat e shërbimit rezidencial për të moshuar, deri në miratimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas kërkesave të nenit 51.1 të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në dërgimin e plan buxhetit të vitit 2020, vitit 2021 dhe vitit 2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror në miratimin e PBA 2020 -2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 e projektit nuk kanë vlerësuar kostot e investimeve për shpenzime kapitale, duke ndikuar në cilësinë e jetesës së të moshuarve të njëjësive shpenzuesen në këtë institucionet rezidenciale:

- Shtëpia e të Moshuarve Tiranë për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara në total në shumën 5,078 mijë lekë për blerje “kondicionerë” për dhomat e të moshuarve për 24 copë vlerësuar me kosto 72,000 lekë/copë me kosto investimi 1,728 mijë lekë; blerje “grila për dritare” për 302 m2 me kosto 10,000 leke/m2 llogaritur me kosto investimi 3,020 mije lekë; blerje “frigoriferë ” për dhomat e të moshuarve për 20 copë me kosto 16,500 lekë/copë me kosto projekt investimi 330 mijë leke, në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për te moshuarit ne qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”.

-Shtëpia e të Moshuarve Shkodër për blerjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara, kërkuar në total 1,080 mijë lekë, për blerje sobe gatimi industriale me gaz 1 copë, lavatrice industriale me tharëse 1copë, tharëse industriale 1 copë dhe televizorë 10 copë, në mospërputhje me VKM Nr. 821 date 06.12 .2006 “Për standardet e shërbimeve te përkujdesit shoqëror, për të moshuarit ne qendrat rezidenciale”, Standard 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 63-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 53-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 3.1: Shërbimin Social Shtetëror në bashkëpunim me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, para dërgimit të projekt buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesave për zërin “Investime” në llogarinë 231, në përmbushje të Standardit 10 “Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj”, me qëllim rritjen e cilësisë së cilësinë së jetesës së të moshuarve në këto institucione rezidenciale.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e transferimit të institucioneve rezidenciale për të moshuar në njësitë e qeverisjes vendore brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 121/2016. Për pasojë Shtëpia të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër vazhdojnë të funksionojë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, në papajtueshmëri me kërkesat e nenit 52, pika 1 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).



Rekomandimi 4.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin dhe përgjegjësinë e organit publik të ngarkuar me ligj për hartimin e dokumenteve dhe politikave të reformimit e modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe si institucion përgjegjës për organizimin dhe administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të marrë masat e nevojshme që të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale tu transferohet njësisive të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në dosjet e punonjësve mungonte “Përshkrimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, veprim në kundërshtim me Kontratën e Punës Individuale sipas të cilës punëmarrës ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6) dhe Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nr. 1570, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).

Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër rezultoi se në dosjet e punonjësve mungonin: - “Përshkrimi i detyrave të punonjësve” sipas pozicionit të punës, në kundërshtim me Kontratën e Punës Individuale sipas të cilës punëmarrësit ka detyrim të përmbushë detyrat e tij në përputhje me kërkesat e vendit të punës (neni 6), dhe Rregulloren e Brendshme e Organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër nr. 1568, datë 07.07.2016, detyrat e Drejtorit (pika 6).

Në dosjet e personelit mungon “Libreza Shëndetësore”, e rinovuar, e punonjësve të institucionit për vitin 2023, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, neni 17, germa “ç”, sipas të cilit kërkohet mbikëqyrje shëndetësore e personave që shërbejnë në institucione të përkujdesjes sociale, duke paraqitur në institucion “Librezë shëndetësore” e cila duhet të depozitohet në institucion dhe duhet të rinovohet pas përfundimit të afatit (1 vit) të përcaktuar në këtë dokument shëndetësor. Me përjashtim të rezultateve të vitit 2022, në dosjen e personelit mungon vlerësimi individual i rezultateve në punë, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër nr. 1565, datë 07.07.2016, neni 17. (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 5.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Dosjet e personelit të institucionit, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër nuk përmbanin trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit për pozicionin e punës punonjës social, psikolog, pasi për faktorë jashtë institucionit nuk është realizuar procesi i certifikimit sipas dispozitave të nenit 42 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” me pasojë në procesin e rekrutimit, i cili ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror. (Trajtuar më hollësisht në faqet 68-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 67-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 6.1: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, i cilin përfshin



si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Lidhur me procedurën e prokurimit “*Blerje mish dhe nënprodukte të tij për vitin 2022*” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se referuar kontratës nr. 147 prot., datë 29.09.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, si dhe bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi produktet e mishit dhe nënprodukteve të tij duhet të shpërndareshin afërsisht për 12 herë (3 muaj*4 javë), por në fakt shpërndarja është kryer për të gjithë sasinë 3 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në muaj dhe jo një herë në javë.

Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “*Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit*”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: “*...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore*”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit, përpara marrjes në dorëzim të tij, të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqëruar të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si certifikatë veterinarë dhe raport analize, në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim mallra pa u siguruar nëse ato janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinarë, standardet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, raport analizat, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjetin me të cilën produktet shpërndahen, certifikatën për të verifikuar cilësinë e I-rë të mallit, si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprime në kundërshtim me kërkesat specifike të ftesës për ofertë, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Gjithashtu, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 të kontratës nr. 147 prot., datë 29.09.2022 “*Blerje Mish dhe nënprodukte të tij*”.

-Lidhur me procedurën e prokurimit “*Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij*” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatua se me anë të kërkesës datë 20.09.2022, grupi i punës i është drejtuar sektorit të financës me qëllim vijimin e procedurave të prokurimit për blerjen e bulmetit sipas sasive të specifikuara në kërkesë nga ku është konstatuar *mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt*.

Referuar kontratës nr. 250 prot., datë 03.10.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, pikës 1, neni 10, si dhe bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi produktet e bulmetit dhe nënprodukteve të tij duhet të shpërndareshin afërsisht për 30 herë (90 ditë/3), por në fakt shpërndarja është kryer për të gjithë sasinë 3 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në 30 ditë dhe jo një herë në 3 ditë. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “*Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit*”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet



vetëm: “...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqëruar të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: certifikatë cilësie, certifikatë analize fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe raport analize, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar mbi të dhëna mbi certifikatat e cilësisë, certifikatë analize fiziko-kimike, mikrobiologjike, standardet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të Ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 të kontratës nr. 250 prot., datë 03.10.2022 “Blerje Bulmet dhe nënprodukte të tij”.

-Lidhur me procedurën e prokurimit “Blerje ushqime koloniale” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatua:

Me anë të kërkesës grupi i punës i është drejtuar sektorit të financës me qëllim vijimin e procedurave të prokurimit për blerjen e ushqimeve koloniale sipas sasive të specifikuar në kërkesë nga ku është konstatuar *mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt*. Produktet e prokuruar janë marrë në dorëzim të gjitha njëkohësisht më datë 04.10.2022 nga grupi i marrjes në dorëzim. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim, si dhe verifikimin që i është kryer mallit përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: “...të furnizuara sipas standardeve dhe cilësisë së kërkuar”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqëruar të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: raport analize fiziko-kimike, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, sipas së cilës “Raport analiza fiziko-kimike duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar”, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, mallrat pranohen pa u konstatuar mbi të dhëna mbi certifikatat e cilësisë, certifikatë analize fiziko-kimike, standardet e ambalazhimit të produkteve, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e prodhimit, skadencën, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të Ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Lidhur me procedurën e prokurimit “Blerje gruri për vitin 2022” në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, u konstatua: Me anë të kërkesës grupi i punës i është drejtuar sektorit të financës me qëllim vijimin e procedurave të prokurimit për blerjen e mishit dhe nënproduktet e tij sipas sasive të specifikuar në kërkesë nga ku është konstatuar *mos mbajtja e një procesverbali argumentues me qëllim analizimin e sasisë së kërkuar për secilin produkt*. Furnizimi i mallit konstatohet se është kryer në një ditë të vetme, përkatësisht data 21.02.2022. Procedura e 2-të është kryer në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “M.C.” sh.p.k, me ofertë 630,000 lekë (pa Tvsh) dhe 756,000 lekë (me TVSH), i cili ka lidhur kontratën nr. 77 prot., datë 25.02.2022 me afat deri në datën 31.12.2022. Referuar kontratës nr. 77 prot., datë 25.02.2022 të nënshkruar nga palët, pikës 2, neni 6, pikës 1, neni 10 “Autoriteti



kontraktor duhet të njoftojë furnizuesin 1 ditë para datës së furnizimit të mallit duke paraqitur një listë për artikujt që kërkon”, si dhe bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjet e artikujve në magazinë, konstatohet se furnizimi nuk është kryer sipas kushteve të kontratës. Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin 1 ditë para dorëzimit të mallit, si dhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit. Për periudhën që kontrata ka qenë në fuqi buka duhet të shpërndahej afërsisht për 308 herë (308 ditë), por në fakt shpërndarja është kryer për të gjithë sasinë 10 herë përgjatë gjithë periudhës, pra mesatarisht furnizimi kryhet një herë në 30 ditë dhe jo çdo ditë.

Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit”, nuk konstatohen gjurmë dokumentare/auditimi lidhur me përshkrimin e detajuar të mallit që merret në dorëzim si dhe verifikimin që i është kryer atij përpara marrjes në dorëzim. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nga grupi përkatës citohet vetëm: “...pasi u kontrolluan në sasi dhe cilësi u bënë hyrje në magazinën ushqimore”. Gjithashtu në asnjë rast nuk konstatohet që grupi i marrjes në dorëzim të furnizimit përpara marrjes në dorëzim të sigurohet për kontrollin e dokumentacionit shoqërues të produkteve të vendosura si kritere në ftesën për ofertë të tilla si: fletë analizë dhe certifikatë cilësie, veprim në kundërshtim me parashikimet në ftesën për ofertë, duke marrë produkte në dorëzim pa u siguruar nëse janë apo jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. Si rrjedhojë, malli pranohet pa u konstatuar mbi të dhëna mbi cilësinë, standardet e ambalazhimit, treguesit fiziko-kimik, të dhëna mbi datën e prodhimit, kushte të veçanta të mbajtjes, automjeti me të cilën produktet shpërndahen si dhe të dhëna të tjera të ngjashme, të cilat do të vërtetonin sigurinë e produktit dhe nëse produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të Ftesës për ofertë, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, si dhe në kundërshtim me pikën 3, neni 10 kontrata “Blerje bukë gruri” nr. 77 prot., datë 25.02.2022.

Nga auditimi në të gjitha praktikat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në të dyja institucionet është konstatuar se në dosjen e prokurimit administrohen dokumentet e kërkuara sipas Ftesës për Ofertë nga ana e OE, por ato nuk rezultojnë të dorëzuara sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e Protokollit, në kundërshtim me pikën 17, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 113-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 7.1: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit,.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 7.2: Komisioni i marrjes në dorëzim pranë Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër në çdo rast përpara marrjes në dorëzim të mallit të verifikojë plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura në ftesën për ofertë duke e pasqyruar në një procesverbal të posaçëm dhe furnizimi të bëhet në çdo rast në përputhje me grafikun e lëvrimin.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Lidhur me procedurën e prokurimit “Shërbim Ashensori” viti 2020-2022, në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, u konstatua se: Shtëpia e të moshuarve Tiranë ka në pronësi të saj një ashensor i cili shërben për ngjitjen në godinë nga të moshuarit dhe stafi. Lidhur me këtë ashensor për tre vitet 2020-2022 është kryer procedura e prokurimit me objekt



“Shërbim Ashensori”, i cili ka patur për qëllim shërbim mirëmbajtje ashensori, vajtje dhe kontroll periodik, shërbim dhe riparim kur ka defekt. Operatori i shpallur fitues “G.G.” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e shërbimit me nr. 23 prot., datë 24.01.2020 përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. G.H, i cili në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka patur tagër administratori, pasi referuar informacionit të përcjellë nga gjendja e regjistrimit të shoqërisë “G.G.” sh.p.k. afati i emërimit i ka përfunduar në datën 03.07.2019. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata nr. 32 prot., datë 25.01.2022, në të cilën operatori është përfaqësuar nga z. G.H, i cili sërish ka vepruar në kundërshtim me tagrin ligjor, pasi administrator i shoqërisë në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë z. E.H. Në të tre procedurat konstatohet se si kriter kualifikues është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, i cili figuron i njëjtë për të tre procedurat nuk konstatohet i depozituar vërtetimi i OSHEE për procedurën e vitit 2020 dhe 2021, në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimi nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 8.1: Komisioni i blerjeve me vlera të vogla pranë Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, të marrë masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, të mos shpall OE fitues pa u siguruar se i gjithë dokumentacioni i kërkuar është depozituar dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK, si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik të veprojnë në përputhje me tagrin ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në të gjitha praktikat e zgjedhura për auditim në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, në të dyja institucionet është konstatuar se:

- Në procedurën e prokurimit të blerjeve së medikamenteve në të dyja institucionet nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentare për llogaritjen e sasisë së medikamenteve, sipas së cilës mjeku, harton planin për plotësimin e nevojave mjekësore për përfituesit, veprim në kundërshtim me pikën 6, detyrave të mjekut, rregullore e brendshme e organizimit dhe e funksionimit të shtëpisë së të moshuarve, Tiranë me nr. 1570 prot., datë 7.7.2016,

Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë:

Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, me kërkesën e datës 06.01.2022 drejtuar drejtorit të Institucionit, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 122 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej tyre për përdorim nga të moshuarit. Referuar kësaj shkrese, pjesë e listës së medikamenteve janë sipas recetave R3 për mjekim akute sipas rastit dhe për COVID -19. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 12.01.2022, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Për blerjen e mallit është kryer procedura në sistemin e prokurimit elektronik dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” sh.p.k, me ofertën më të ulët 520,000 lekë (pa Tvsh). Në vijim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 27 prot., datë 21.01.2022, me afat deri në përmbushjen e vlerës së kontratës. Për vitin 2022, për blerjen e mallit është kryer procedura në formë shkresore dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “D.M.” sh.p.k., me ofertën më të ulët 99,825.22 lekë (pa Tvsh).

Në procedurën e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe verifikimin paraprak të tyre, në të dyja institucionet janë konstatuar problematika, përkatësisht:

Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë: Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 2/2020, 2/2021 dhe 2/2022 nuk konstatohet gjurmë auditimi/dokumentare që pas sjelljes së medikamenteve në ambient ti marrin në dorëzim, duke verifikuar në çdo rast që të gjitha medikamentet të jenë me afat skadence jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit në institucion



dhe çdo medikament të ketë pullën me datën e prodhimit dhe datën e skadencës dhe çmimet respektive, duke ndikuar në këtë mënyrë në sigurinë e medikamenteve që të moshuarit konstatojnë. Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete – hyrje, nënshkruhet vetëm nga magazinieri i Institucionit dhe dalje me Flete – dalje.

Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër: Lidhur me procedurën e blerjeve të medikamenteve për vitin 2020, ngritur me Urdhër nr. 4/3-2020, konstatohet se më datë 01.06.2020 komisioni ka marrë në dorëzim medikamentet 40 prej medikamenteve, të cilat përbëjnë 57 % të sasisë së medikamenteve të bëra hyrje më datën 01.06.2020 (datë në të cilën medikamentet janë bërë hyrje në magazinën e SHMSH), janë me datë skadence më pak se 2 (dy) vjet. Nga ana e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 21 prot., datë 28.01.2021, konstatohet se më datë 02.09.2021 janë marrë në dorëzim medikamentet, pasi është bërë kontrolli në sasi dhe cilësi të tyre. Në procesverbalin e mbajtur nuk konstatohet që komisioni i marrjes në dorëzim të jetë shprehur mbi skadencën e mallit dhe plotësimin e kriterit të vendosur në ftesën për ofertë. Gjithashtu, komisioni i ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2022, konstatohet se më datë 02.09.2022 ka marrë në dorëzim medikamentet, pasi bëri kontrollin në sasi dhe cilësi të tyre dhe nuk është shprehur lidhur me afatin e skadencës së tyre.

Në të dyja institucionet janë konstatuar problematika me procedurën e blerjes së medikamenteve, të cilat janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit, duke ndikuar në këtë mënyrë në trajtimin e barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbimin si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, veprim në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 10, të Ligjit nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se respektivisht 25 barna në përqindje 20.5 % për vitet 2020, 2021, 2022 janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit.

Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në ftesën për ofertë të procedurave të blerjes së medikamenteve konstatohet se për vitet 2020, 2021, 2022, respektivisht 22 barna, 25 barna dhe 14 barna, në përqindje 26.5 %, 28.4 % dhe 14 % janë kërkuar me emër tregtar dhe jo me emër të principit aktiv të barit. Veprime në kundërshtim me pikën 4, neni 36, Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër*).

Rekomandimi 9.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, të marrin masa për:

- Hartimin e një plani të posaçëm vjetor me qëllim plotësimin e nevojave mjekësore për përfituesit dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor.
- Komisionet e marrjes në dorëzim në çdo rast të mbajnë procesverbal në momentin e marrjes në dorëzim të medikamenteve dhe të pasqyrojnë qartë datën e skadencës dhe praninë e pullës.
- Komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masa që në procedurat për prokurim me vlerë të vogël, dokumentacioni i kërkuar sipas ftesës për ofertë të pranohet vetëm nëse dorëzohet nga OE sipas formës së kërkuar nga ligji, në zyrën e protokollit.
- Në çdo rast, që nuk është i arsyetuar nga mjeku i Institucionit arsyeja se përse kërkohet medikamenti me emër tregtar, procedurat e prokurimit të kryhen me emër principit aktiv.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër është konstatuar se në ftesën për ofertë për vitin 2020 dhe 2021 është vendosur fondi limit i procedurës së prokurimit, i cili si rrjedhojë është bërë publik për operatorët duke ndikuar në ofertën reale bazuar në të dhënat teknike sasiore që prokurohen, veprim në kundërshtim me shkronjën “b”, pika 3, udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë



të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Gjatë auditimit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se për vitin 2020 janë prokuruar dhe janë marrë në dorëzim gjithsej 83 (tetëdhjetetë) medikamente të ndryshme, për vitin 2021 gjithsej 88 (tetëdhjetetë) dhe për vitin 2022 gjithsej 48 (dyzetetë). Është konstatuar se një pjesë e medikamenteve të prokuruar dhe të marra në dorëzim, referuar listës II të barnave në Farmacitë e rrjetit të hapur për vitin 2020 miratuar me VKM nr. 101, datë 27.02.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 218, datë 20.4.2018, të këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe masës së mbulimit të çmimit të tyre” dhe vitit 2021 dhe 2022 miratuar me VKM nr. 489, datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga fondit i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre” janë barna të rimbursueshme. Përkatësisht në numër dhe përqindje barnat e rimbursueshme të prokuruar kanë qenë: për vitin 2020, 29 barna nga 83 në përqindje 35 %; për vitin 2021, 29 barna nga 88 në përqindje 33 % dhe për vitin 2022, 17 barna nga 48 në përqindje 35.4%. Edhe pse medikamentet sipërcituar janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme (pjesërisht apo të plotë), pjesë e paketës së përfitimit nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, mjekja e institucionit si dhe personeli ndihmës sipas rastit për të tre vitet në kërkesat iniciuese kanë kërkuar blerjen e tyre duke përjashtuar në këtë mënyrë mundësinë e pajisjes me to me anë të rimbursimit. Veprime në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 10 të Ligjit nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi në SHMSH është konstatuar se dalja nga magazina dokumentohet me fletëdalje me destinacion për përdorim për mjekën dhe kujdestaren e Institucionit. Në të gjitha fletëdaljet konstatohet se data nuk plotësohet e saktë, por vendoset periudha mujore duke mos përcaktuar saktësisht datën e daljes së mallit, gjithashtu për vitin 2020 për të gjitha fletëdaljet konstatohet se nuk kanë nr. Rendor, veprime në kundërshtim me pikën 36, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 10.1: Në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, Komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në procedurë të blerjeve të vogla në ftesën për ofertë të mos vendosë fondin limit të procedurës.

Për medikamentet e rimbursueshme të ndiqet procedura për përfitimin e rimbursimit, si dhe të gjitha fletëdaljet të plotësohen saktë me të gjithë informacionin e kërkuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në të tre procedurat e zhvilluara pranë Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë për blerje medikamentesh, konstatohet se përlllogaritja e fondit limit nuk është pasqyruar në proces verbalët përkatëse të mbajtura nga grupet e ngritura për këtë qëllim. Grupi i punës është shprehur në procesverbalin e mbajtur: “Grupi i punës për testimin e tregut është mbështetur tek libri i medikamenteve me çmimet përkatëse për secilin medikament”, duke mos pasqyruar vlerën për secilin prej tyre dhe përlllogaritjen totale, veprim në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimin nr. 05/2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Nga auditimi në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë u konstatua se si kriter kualifikues në këtë procedurë është vendosur ndër të tjera paraqitja e vërtetimit nga OSHEE. Nga ana e operatorit ekonomik, konstatohet mungesa e dorëzimit të dokumentacionit sipërcituar, në kundërshtim me pikën 7, Udhëzimit nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Gjatë auditimit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, për periudhën objekt auditimi 2020-2022,



konstatohet se edhe pse janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhrat e titullarit nr. 146/1 prot., datë 11.09.2020, për vitin 2021 shkresa nr. 128 prot., datë 15.11.2021 dhe për vitin 2022 shkresa nr. 109., datë 25.10.2022, nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare që nëpunësi zbatues i institucionit të ketë ndërmarrë procedura për kryerjen e inventarizimit të medikamenteve, duke ndikuar në mungesën e vërtetimit të saktësisë, cilësisë së gjendjes fizike të medikamenteve në një kohë, veprime në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë*).

Rekomandimi 11.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, komisioni i blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që:

- Në çdo rast përlllogaritja e fondit limit të pasqyrohet me procesverbal të veçantë se si është përlllogaritur ai.
- Të mos shpallë fitues operatorë ekonomik bë mungesë të plotësimit të dokumentacionit ligjorë të kërkuar nga AK.
- Në çdo rast të kryhet inventarizimi i medikamenteve.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën zero lekë. Nga institucioni disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion subjekti për periudhën objekt auditimit, por rezulton se nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Sipërfaqja totale e tokës, që ka Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër*).

Rekomandimi 12.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit në ASHK.

Rekomandimi 12.2: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës dhe më pas Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të ndërmarrë veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 320,283 lekë, vlerë për të cilën nuk u dhanë sqarime nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, i ndryshuar, si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 13.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëjë sistemimin dhe pasqyrimin e saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” konstatohet se Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve, për vitin 2021 në vlerën 43,947 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën prej 5,497 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve, veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë).

Rekomandimi 14.1: Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin (2023).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 14.2: Nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në pasqyrimin e bilancit për vitin 2023.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër nga auditimi u konstatua se Urdhëri/at e NA “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit nuk kanë përcaktuar një datë të përfundimit të procesit të inventarizimit.

15.1 Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion për NA, lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në përdorim, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 85 germa “a” dhe germa “c”.

15.2 Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbal nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar në arkivë, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa “c”, 105.

15.3 Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit për anëtarët e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafin 82.

15.4 NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Inventarizimit, por në përbërje të tij rezultojnë të njëjtët anëtarë me komisionin e inventarizimit të vitit paraardhës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin



e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 84.

15.5 Komisioni Asgjësimit ka mbajtur Proces Verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 109; 110. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 15.1: Titullari i institucionit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me përgjegjësen e Sektorit të Administratës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, në vazhdimësi të marrë masa që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të kërkojë dhe zbatojë me përpikmëri procedurën e parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke eliminuar problematiken e hasur gjatë këtij auditimi të konstatimit të mungesës së urdhrat për ngritje komisioni, mungese e deklaratës së shmangies se konfliktit te interesit, mungesës së mbajtjes se proces verbalit, të shmangies së të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite resht, mungesë firmosje nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesës se relacionit për titullarin, etj..

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Shtëpisë e të Moshuarve Shkodër u konstatua se Komisioni Inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal për fiksimin e numrit rendor të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, i cili duhet mbajtur me përgjegjësin e materialit dhe komisionit. Në asnjë nga fletët e inventarit për asnjë nga vitet objekt auditimi, përgjegjësit e materialeve as nuk janë identifikuar si dhe nuk kanë firmosur në fletët e inventarizimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafin 83.

16.1 Titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës për nxjerrjen jashtë përdorimit i përbërë nga tre anëtarë dhe jo me 5 anëtarë, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100.

16.2 Nga auditimi i Regjistrat të Aktiveve, grupi i auditimit konstatoi se kishte mangësi në të dhënat specifike që duhet të këtë një regjistër aktivesh, si për shembull vendosja e përgjegjësit të materialit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 30. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 77-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 16.1: Nëpunësi zbatues për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrat të aktiveve duke përcaktuar edhe personat përgjegjës të materialeve. Grupi i inventarizimit duhet të kryej inventarizimin e aktiveve të cilat janë në ngarkim të personave përgjegjës, në prani të tyre si dhe të hartojë proces-verbalin përkatës. Titullari i institucionit të marrë masa që grupi punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të përbëhet nga 5 anëtarë.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë u konstatua se Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventar për gjendjen ne sasi dhe vlere të farmacisë si dhe kuzhinës, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë



310 “Mallra ushqimore” dhe llogarisë 327 “Inventar i imët”, i cili duhej të firmosur nga përgjegjësi material (magazineri dhe infermierja), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, paragrafin 83. (Trajtuar më hollësisht në faqet 77-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë).

Rekomandimi 17.1: Nëpunësi zbatues të marrë masa ku në zbatim të urdhrat të Titullarit, në rolin e përgjegjësit për monitorimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit të kryej çdo fund viti, inventarin edhe të gjendjes sasiore dhe cilësore të artikujve të institucionit si dhe kuzhinës.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Grupi i audituesve të KLSH-s, në procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së kontratave të lidhura me AK për “blerje ushqimesh”, lidhur me zbatimin e kontratave për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, referuar kontratës nr. 131, datë 08.07.2020; kontratës nr.177, datë 01.07.2020, kontratës nr. nr.273, dt. 01.01.2020; kontratës nr.5, dt. 05.01.2021; kontratës nr.21, datë 21.01.2021; kontratës nr.30, dt. 21.01.2022, kontratës nr.52, dt. 11.03.2022 dhe kontratës nr.22, datë 18.01.2022 dhe për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër referuar kontratës nr. 265, datë 01.2.2020; kontratës nr.264, datë 01.12.2020, kontratës nr.210, dt. 02.10.2020; kontratës nr.211, dt.02.10.2020; kontratës nr.17, datë 08.01.2021; kontratës nr.18, dt. 08.01.2021, kontratës nr.16, dt. 08.01.2021, kontratës nr.14, dt. 08.01.2021; kontratës nr.15, dt.08.01.2021; kontratës nr.250, datë 03.02.2022; kontratës nr.36, dt. 26.01.2022, kontratës nr.34, dt. 26.01.2022, kontratës nr.247, dt. 26.09.2022, kontratës nr.32, dt. 26.01.2022 dhe kontratës nr.33, datë 26.01.2022 nga auditimi dokumentacionit të dosjes/ve të zbatimit të kontratave rezultoi se:

- Komisioni i Pranimit të Mallit ngritur me urdhër të posaçëm të NA, nuk ka përcaktuar si pjesë e komisionit magazinierin e institucionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik”, neni 43.

- Proces Verbal/et, e pranimit të mallit perimeve dhe zarzavateve nuk kanë evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së parë, nuk kanë fletë analizë në rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësor sipas standardit shtetëror të miratuar. Proces Verbal/et, pranimit të produktit mish/ të përpunuar i mishit (sallam, proshuta, etj.) nuk përmbanin të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinare, e cila do të vërtetonte sigurinë e produktit dhe vërteton se produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të DST.

- Proces Verbal/et, pranimit të bulmetrave për furnizimin me djathë nuk kanë të evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit;

- Për furnizimin me vezë nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët;

- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Sa më sipër, rezulton se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të nuk është respektuar standardi i pranimit të mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuara në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni

Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 77 pika 4. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).*

Rekomandimi 18.1: Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatës/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kriteret e kualifikimit të OE. Këto dokumente duhet të evidentohen në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së zbatimit të kontratës. Proces verbalin të hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave të bëhet pjesë e dosjes.

Në vijimësi.

19. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se në asnjë nga kontratat e lidhura për furnizimin me ushqim të të moshuarve nga OE “M.C.” dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër nuk është respektuar pika 2/a e nenit 6 të kontratës ku e cila ka të bëjë me “Grafikun e lëvrimit të mallit”, ku OE duhet të furnizojë me ushqim 1 deri në 2 herë në javë sipas kërkesave të OE, me ushqimet e ndryshme në bazë të grafikut të lëvrimit, por referuar fletë hyrjeve të magazinës, të gjitha furnizimet janë bërë një herë në muaj, duke rrishtuar kështu cilësinë e ushqimeve prej kohës së gjatë të mbajtur në magazinë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 113-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).*

Rekomandimi 19.1. Nëpunës zbatues i Shtëpia e të Moshuarve Shkodër si përgjegjës për ndjekjen e kontratës, të marrin masa të menjëhershme, ku në zbatim të pikës 2/b të nenit 6 të të gjitha kontratave të lidhura me OE “M.C.”, ky i fundit të kryej furnizimet e ushqimeve sipas grafikut të lëvrimit, për të siguruar cilësinë e tyre si dhe të paraqesin në proces verbalin pjesore për të lënë gjurmë për sasinë, cilësinë dhe shpërndarjen e furnizimit.

Në vijimësi..

20. Gjetje nga auditimi: Në institucionet publike rezidenciale për të moshuar ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për të moshuarit.

Në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës kanë konsumuar më pak se kuota e miratuar 360 lekë/ për person në ditë, për vitin 2020 në total 218,808 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur, për vitin 2021 në total 85,179 lekë/muaj për 4 muajt e përzgjedhur për auditim dhe për vitin 2022 në total 138,027 lekë/muaj për 7 muajt e përzgjedhur për auditim.

Në institucionin publik rezidencial *Shtëpia e të Moshuarve Shkodër* rezultoi se të moshuarit dhe personeli mbështetës në muajin shkurt dhe nëntor përzgjedhur për auditim për vitin 2020 kanë konsumuar në total 13,257 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore, për 4 muajt e



përzgjedhur për vitin 2021 kanë konsumuar -23,976 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore dhe për 5 muajt e përzgjedhur për auditim për vitin 2022 kanë konsumuar -36,335 lekë/muaj me pak se kuota ushqimore.

Mos zbatimi i nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve 360 lekë për person nga Shtëpia e Moshuarve Tiranë dhe Shkodër është në papajtueshmëri me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 20.1: Përgjegjësja e Sektorit të Administratës në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen zbatimin e kuotës ushqimore ditore në fuqi të çdo përfituesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave dokumentare të hartimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit, për muajt e përzgjedhur në *Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër* grupi i auditimit konstatoi se në shumicën e fletëdaljeve (70% e tyre) ishin me korrigjime të shumta të vlerave, sasive apo totalit përfundimtar, nuk janë administruar kopjet e fletë daljeve në blloqet e administruara nga magazina, rrethana mbi të cilat grupi i auditimit nuk mund krijë siguri të arsyeshme për të dalë një rezultat të saktë, veprime ne kundërshtim me nenin 6 dhe nenin 9.3 të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Standardin Kombëtar I Kontabilitetit NR. 15, Paragrafi 58. (Trajtuar më hollësisht në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 21.1: Nëpunësi Zbatues në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër ne cilësinë e personit përgjegjës që kontrollon të gjitha veprimet që bëhen në magazinë, në lidhje me hyrjet dhe daljet nga magazina të marri të masa të menjëhershme që flete daljet e magazinës të plotësohet konformë ligjit dhe elementeve të dokumentacionit duke mos lejuar shënime dhe korrigjime mbi dokument.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Lidhur me mjediset e banimit në institucionet rezidenciale, referuar VKM nr.821 datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale” si dhe në zbatim të tij Udhëzimi i ish-Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe shanseve të Barabarta” Nr.2005/4 datë 04.12.2009 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuarit në qendrat rezidenciale dhe qendrat ditore”, nga grupi i auditimit u krye verifikimi i zbatimit të Standardit nr.10 i cili ka përcaktuar *standardin minimal të akomodimit në qendër për dhoma gjumi me një sipërfaqe të përdorshme prej 12 m² për dhomat me dy shtretër dhe 18 m² për dhomat me tre vende. Dhomat duhet të jenë të rregullta, të lejojnë lëvizjen, manovrimin dhe rrotullimin e karrigeve me rrota dhe të pajisjeve të tjera për ecjen. Standardi nr. 10 ka përcaktuar vendosjen e tualeteve për çdo dhomë me dy vende, ose 1 tualet në çdo dy dhoma me një vend, që lejojnë hyrjen dhe lëvizjen me karrige me rrota; sinjale për thirrjet e urgjencës, shërbimet higjienike për çdo shtrat; vendosja e sistemeve të ngrohjes gjatë dimrit dhe të freskimit gjatë verës”....* Nga verifikimi i zbatimit të Standardit nr.10 për:

-*Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë*, referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik, grupi i auditimit konkludoi se nuk është respektuar asnjë nga tre standardet e mësipërme, si standarde të cilat ruajnë higjienën dhe janë standarde minimale për plotësimin e



nevojave të të moshuarve. Dhomat e të moshuarve në total janë 23 dhoma nga të cilat 5 dhoma treshe, 12 dhoma dyshe dhe 6 dhoma njëshe ishin treshe ose dyshe. Grupi i auditimit konstatoi se nuk respektohet standardi në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale, por një banjë shfrytëzohej nga minimumi 3 vetë deri në 5 vetë. Gjithashtu, nga 23 dhoma, për të siguruar freskimin e ambientit vetëm tre dhoma ishin të pajisura me kondicionerë ndërsa 20 dhomat e tjera jo. *Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat.*

-Për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, referuar standardeve të sipërpërmendura, referuar dokumentacionit për hapësirat e dhomave si dhe verifikimit fizik, grupi i auditimit konkludoi se nga institucioni nuk është respektuar asnjë nga tre standardet e miratuara, standarde të cilat ruajnë higjienën si dhe janë kushte minimale për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Në këtë institucion për të moshuarit në total janë dhoma 41 dhoma nga të cilat 14 dhoma njëshe, 25 dhoma dyshe dhe 2 dhoma katërshe. Grupi i auditimit konstatoi se nga institucioni nuk është respektuar Standardi nr. 10 në lidhje me vendosjen e tualeteve për nevoja personale, pasi një tualet shfrytëzohej nga minimumi 5 vetë deri në 20 vetë. Grupi i auditimit gjithashtu konstatoi se mungonin sinjalet për thirrjet e urgjencë për të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat. (Trajtuar më hollësisht në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër).

Rekomandimi 22.1: Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër të marrin masa për të plotësuar nevojat minimale të kujdesit personal për të moshuarit rezident si dhe të sigurojnë vendosjen e sinjaleve për thirrje urgjencë në të gjitha shërbimet higjienike si dhe për çdo krevat në mënyrë që shërbimi ndaj tyre të jetë sa më efikas, eficient dhe i sigurtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se referuar pesë loteve të Marrëveshjes Kuadër fituar nga OE “M.C.” (ku të gjitha kushtet janë të paracaktuara), Titullari i Institucioni në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues nuk ka respektuar lidhjen e kontratës *më afat 24 muaj*, nëpërmjet minikontratave, por i ka lidhur ato për një periudhë më të shkurtër pa pasur asnjë arsye në lidhje me konsumimin e tyre në një kohë më të shkurtër, duke lidhur kështu kontrata të tjera po me të njëjtët operator për periudhën e mbetur, duke rezultuar në mbivendosje kontratash.

Loti 5 Furnizim me “Veze” kontrata e lidhur për lidhur për 23 muaj (1 muaj mangët)

Loti 2 Furnizim me “Bulmet dhe nënprodukte e tij” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët)

Loti 3 Furnizim me “Mish dhe nënprodukte e tij” lidhur për 21 muaj (3 muaj mangët)

Loti 7 Furnizim me “Fruta Perime” lidhur për 20 muaj (4 muaj mangët)

Loti 4 Furnizim me “Ushqime Koloniale” lidhur për 23 (1 muaj mangët)

1.1 Nga auditimi u konstatua se titullari i institucionit për të mbuluar muajt e kontratave të ezauruara përpara afatit, ka prokuruar blerjen e produkteve ushqimore për periudhën që këto produkte ushqimore kanë qenë të mbuluara nga po i njëjti OE, për të cilin Shtëpia e të Moshuarve Shkodër ka lidhur Marrëveshjen Kuadër 24 mujore të kryer nga ish-Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në vlerën totale 1,891,176 lekë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duke shkaktuar mbivendosje të kontratave si dhe efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit për kontratat si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

- Kontrata nr.250 prot., datë 03.10.2022 me OE “M.C.” per furnizim me bulmet dhe nënprodukte e tij, në vlerën total prej 949,440 lekë.
 - Me urdhër shpenzimit nr.177 datë 28.12.2022 miratuar nga titullari dhe NZ i institucionit është kryer likuidimi i faturës në vlerën 15,312 lekë për OE “M.C.” per furnizim me veze.
 - Kontrata nr. 247 prot., datë 26.09.2022 me vlerë 464,064 lekë, lidhur me OE “M.C.” sh.p.k, furnizim me mish dhe nënprodukte e tij
- Me urdhër shpenzimit nr.135 datë 07.10.2022 miratuar nga titullari dhe NZ në vlerën 462,360 lekë, nga OE “N.” shpk furnizim me fruta perime. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 108-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Tiranë dhe në faqet 132-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Shkodër*).

Rekomandimi 1.1: Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje prokurimet e kryera nga Institucioni për mbivendosjen e kontratave për shërbimin “*Furnizim me ushqim*” në vlerën totale 1,891,176 lekë, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare për Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Rekomandimi 1.2: Titullari i institucioni në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa të menjëhershme për të respektuar të gjitha kushtet e parashkuara në Marrëveshjen Kuadër, ku një prej tyre është edhe afati i zbatimit të kontratës, për të shmangur mbivendosjet e kontratave, apo prokurimet e pajustificuara dhe argumentuara të zhvilluara nga AK për të shmangur shpenzimet pa efikasitet, eficientë dhe efektivitet për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI III - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinionëve të aplikuar nga KLSH.

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).



Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësi ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
 - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
 - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

Opinion i modifikuar. Opinioni i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI IV -QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1,5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë prapen e materialitetit prej 1,5%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602, 606 dhe me llogarinë 231 u vlerësuan me 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2020	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	12,930,165	0.70	19
Sigurime Shoqërore (601)	2,172,601	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	13,992,034	0.70	21
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	0	0.70	0

Nisur nga rezultatet sa më sipër, grupi i auditimit mori në shqyrtim 120 raste për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 22 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 102 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 150 çështje të llogarive 602, 605, dhe 606 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione

Në lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2021	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	11,823,348	0.70	18
Sigurime Shoqërore (601)	2,024,932	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	13,795,106	0.70	22
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	0	0.70	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

Nisur nga rezultatet sa më sipër, grupi i auditimit mori në shqyrtim 150 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 21 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 102 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 170 çështje të llogarive 602, 605, dhe 606 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Në lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2021	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	12,336,335	0.70	19
Sigurime Shoqërore (601)	2,080,000	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	13,648,879	0.70	21
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	335,000	0.70	1

Nisur nga rezultatet sa më sipër, grupi i auditimit mori në shqyrtim 150 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 22 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 180 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 215 çështje të llogarive 602, 605, dhe 606 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Shtëpia e te Moshuarve Tirane

(Në mijë lekë)

Nr	EMERTIMI	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		Fakti	Audituar	Fakti	Audituar	Fakti	Audituar
1	Pagat (600)	10.730	19,35%	9.831	33,96%	10.556	26,10%
2	Sig Shoqërore	2.173	19,35%	2.025	19,35%	2.080	19,35%

Grupi i auditimit me zgjedhje auditoi listë pagesat e muajve Maj, Qershor, Korrik 2020; Janar, Shkurt, Mars 2021 dhe Tetor, Nëntor, Dhjetor 2022. Në listë pagesat e zgjedhura u audituan numri i punonjësve të paguar me kohë të plotë dhe kontratë të përkohshme, paga sipas funksionit, shtesat e veçanta, prezenca, vjetërsia, llogaritja e ndalesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

2. Mbulimi me auditim i shpenzimeve të realizuara nga institucioni, veprimet me bankën. (llogaria 602, 605, 606)

Dokumentacioni i audituar i shpenzimeve të bankës është përzgjedhur bazuar në vlerën më të lartë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT I USHTRUAR NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE TIRANË

(Në lekë)

Periudha SHM Tiranë	Transaksione në numër			Transaksione në vlerë (në lekë)		
	Kryer	Audituar	Përqindje	Likuiduar	Audituar	Përqindje
01.01.2020-31.12.2020	241	170	70%	29,094,800	21,876,500	75%
01.01.2021-31.12.2021	235	183	77%	27,643,384	24,840,165	89%
01.01.2022-31.12.2022	253	213	91%	28,430,214	25,430,200	89%
SHUMA	729	566		85,168,398	72,146,865	

3. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye duke patur parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlera e procedurave të realizuara;
- Lakimi në median e shkruar;

Viti SHMT	Parashikuar		Realizuar		% ndaj parashikimit	Audituar		% ndaj realizimit
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë		Numër	Vlerë	
Janar -dhjetor 2020	32	5,946,034	32	5,946,034	100%	11	3,280,534	55%
Janar -dhjetor 2021	34	5,281,030	34	5,281,030	100%	10	3,887,700	74%
Janar -dhjetor 2022	22	2,423,320	22	2,423,320	100%	8	2,106,000	87%

- Risku që shoqëron procedura të caktuara nisur nga niveli i gjetjeve në auditimet e tjera, etj..:

V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

a. Akt Konstatime:

1. Akt Konstatimi nr.1, datë 22.09.2023
2. Akt Konstatimi nr.2, datë 22.09.2023
3. Akt Konstatimi nr.3, datë 22.09.2023
4. Akt Konstatimi nr.4, datë 22.09.2023
5. Akt Konstatimi nr.5, datë 22.09.2023
6. Akt Konstatimi nr.6, datë 22.09.2023
7. Akt Konstatimi nr.7, datë 22.09.2023